

PËRMBAJTJA



3 Kosova anëtare e FMN-së



8 Intervistë me dr. Salih Ahmetin



17 Emrat më të preferuar Altin...



18 Çka është rugovizmi...



35 Pse dhe si të lexohet?

Lajme	2
Demir Reshiti: Kosova anëtare e FMN-së	3-4
Muhamed J. Kajolli: Humbje kohe.....	5-6
Ben Veliu: Ethet e testit të maturës	6
Sead Ujkani: Dështimi i radhës: Trusti i pensioneve! ..	7
Intervistë me dr. Salih Ahmetin	8-9
Abdurrahim Maxhuni: Dhjetë vjet pas!.....	9
Avni Avdiu: Me NATO-n apo me Rusinë?!.....	10-11
Florije Ademi: Rindërtimet në "Kroin e Vitakut" ngjallin shpresat për kthim.....	11-12
Fatos Shala: Shifra alarmante të vetëvrasjes në Kosovë	13
Sabri Halili: Drejtësia në Kosovë e mbarsur me refleksione të së kaluarës.....	14-15
Mevlude Zejnullahu: Pret një muaj dhe i shpenzon për një orë	16
Florentina Lata: Emrat më të preferuar Altin dhe Erza	17
Dr. Fadil Maloku: Çka është rugovizmi dhe a ekziston ai si i tillë sot?	18-19
Reflektime ndërkombëtare për Kosovën	20-21
Muhamed J. Kajolli: Çlirimi i Lindjes së Mesme dhe Persisë	22-24
Racizëm në emër të neutralitetit.....	25-26
Emine A. Vezaj: Në Canakkalen e rezistencës.....	26-27
Ekrem Avdullahu: Kullerizmi	28-29
Mimoza Sinani: Kur'ani si letërsi sublime	29-30
Osman D. Gashi: Kontribut shkencor për shtetin e ri...31	
Armend Atashi: Fakulteti i Filologjisë e ka harruar traditën e aktiviteteve kulturore	32
Flamur Maloku: Krahasimi në këngët e dashurisë ..33-34	
Esat Vatovci: Lajme kulturore	34
Hekuran Avdyli: Monografi për studentët e gazetarisë ..	35
Jeton Isufi: Pse dhe si të lexohet?	35-36
Poezi	37
Bernard Tahirbegolli: Si ta ofrojmë ndihmën e parë në mënyrë të drejtë?	38
Alban Bilalli: Shkëlqimi dhe rënia e Arie Haanit	39
Fjalëkryqi	40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,
KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti IV / Nr. 30
19 maj - 19 qershor 2009
Botues
Zëri Ynë
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Redjtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com
Redaktor përgjegjës
Demir RESHITI
demireshiti@hotmail.com

Redaktor i kulturës
Flamur MALOKU
flamurmalko@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore
Mimoza SINANI

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,
përballë teatrit Dodona,
Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të majit!

Prishtinë

5 maj 2009

PTK dhe Qeveria e Kosovës, shtrijnë fijen optike në tërë Kosovën

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, kanë nënshkruar më 5 maj 2009 një marrëveshje mirëkuptimi, për projektin “Fiber to School”, që nënkupton informatizimin dhe kompjuterizimin e të gjitha shkollave të vendit, brenda më pak se një viti.

Marrëveshja e nënshkruar nga kryeshefi ekzekutiv i PTK-së, Shyqyri Haxha dhe kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, në emër të qeverisë së Kosovës, parashikon një investimi madhor, me një vlerë 80 milionë euro.

Nga ky projekt do të përfitojnë mbi 1080 shkolla në tërë territorin e Kosovës, të cilat do të pajisen me internet.

Sipas kryeshefit ekzekutiv të PTK-së, ky është projekti më i madh i investuar në Kosovë, që pritet të fillojë të zbatohet që nga muaji i ardhshëm.



Prishtinë

6 maj 2009

“Bursa e punësimit - Kosova 2009” punëson 580 persona

Ka përfunduar projekti “Bursa e punësimit, Kosova 2009”, që u mbajt me 4 dhe 5 maj në Prishtinë nën përkujdesjen e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Përmes projektit “Bursa e punësimit, Kosova 2009”, e organizuar nën përkujdesjen e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, bizneset kosovare tashmë kanë pranuar në punë gjithsej 578 qytetarë.

“Ne gjatë këtyre dy ditëve kemi pasur rreth 3 mijë vizitorë, 2 mijë e 280 aplikacione të profileve të ndryshme. Prej tyre janë përzgjedhur 578 të punësuar, prej të cilëve 78 kanë filluar punën menjëherë sot, kurse 500 të tjerë do të punësohen gjatë vitit” - ka sqaruar Agim Shahini, nga Aleanca Kosovare e Bizneseve.

Nju Jork

9 maj 2009

Kosova - anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar

Fondi Monetar Ndërkombëtar i ka ofruar Kosovës të bëhet anëtarja e 186-të e këtij institucioni.

Këshilli Ekzekutiv i Fondit Monetar Ndërkombëtar ka verifikuar votimin e këshillit të guvernatorëve që Kosovës t'i ofrohet anëtarësimi. Kosova bëhet (edhe zyrtarisht) anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar në çastin kur përfaqësuesi i saj i autorizuar në Uashington nënshkruan dispozitat e marrëveshjes.

Nga 138 shtete sa kanë marrë pjesë në votimin për pranimin ose jo të Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar, 96 sosh kanë votuar në favor të Kosovës, dhjetë kundër, kurse 32 kanë abstenuar.



Kosova anëtare e FMN-së

Pranimi i Kosovës i jep asaj të drejtën për të marrë kredi prej miliona dollarësh të mbështetura nga ky institucion financiar. Kuota fillestare e propozuar nga Bordi për Kosovën është rreth 88.6 milion dollarë. Secilit nga të 185 vendet anëtare që ka Fondi i caktohet një kuotë e cila bazohet kryesisht në peshën që zë çdo vend në ekonominë botërore.



Demir RESHITI

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), më 8 maj, i ka ofruar zyrtarisht Kosovës anëtarësimin. Bordi Ekzekutiv i FMN-së ka certifikuar votën e guvernatorëve për pranimin e Kosovës, gjë që do t'i jepte asaj drejtën për të marrë kredi prej miliona dollarësh të mbështetura nga ky institucion financiar.

Nga 138 shtetet që kanë marrë pjesë në votimin për pranimin ose jo të Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar, 96 sosh kanë votuar në favor të Kosovës, dhjetë votuan kundër, kurse 32 abstenuan kanë njoftuar burime nga FMN-ja.

Në një deklaratë, Bordi Ekzekutiv i FMN-së ka njoftuar se Kosova do të bëhet anëtarja e 186-të e Fondit Monetar Ndërkombëtar, kur përfaqësuesit e saj të nënshkruajnë marrëveshjen në Uashington, ku ndodhen zyrat qendrore të FMN-së.

Kosova tash duhet të përm-bushë kriteret formale dhe parlamenti duhet të miratojë ligjin për anëtarësimin e vendit në Fondin Monetar. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në muajin qershor kur pritet që të përfundojë edhe procesi i anëtarësim-it në bankën Botërore.

Pranimi i Kosovës i jep asaj të drejtën

për të marrë kredi prej miliona dollarësh të mbështetura nga ky institucion financiar. Kuota fillestare e propozuar nga Bordi për Kosovën është rreth 88.6 milion dollarë. Secilit nga të 185 vendet anëtare që ka Fondi i caktohet një kuotë e cila bazohet kryesisht në peshën që zë çdo vend në ekonominë botërore.

Serbia dhe Rusia e kanë kundërshtuar në mënyrë aktive kërkesën e Kosovës për anëtarësim në FMN dhe sipas gazetës The Wall Street Journal, pranimi i saj u shoqërua me debate.

Kosova e ka bërë kërkesën e anëtarësim-it në FMN vitin e kaluar, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë.

Dobitë e Kosovës nga anëtarësimi

Fondi Monetar Ndërkombëtar shihet si mundësia më e pranueshme për zgjidhjen e problemeve financiare për vendet anëtare. Sidomos në rastet e krizave. Përveç huave për reduktim të varfërisë dhe përmirësim-it të bilancit të pagesave të vendeve në zhvillim, ky fond, së fundi, është ngarkuar edhe me financim të zbrazëtirave buxhetore për vendet e goditura nga kriza ekonomike botërore.

Në takimin e fundit të G20-s, FMN-ja ka ngritur rezervat e saj buxhetore

nga 250 në 750 miliardë

euro, ashtu që të ketë

kapacitet për të

përmbyshur

kërkesat e

vendeve, qe-

veritë e

të cilave

nuk kanë

mundësi që

të përballen vetë me

krizën dhe

me pasojat

e saj.

Vendet

me të ardhura

të ulëta mund

të huazojnë para nga

FMN-ja me norma kon-

Reagimet...

Anëtarësimin e Kosovës në FMN e kanë përshëndetur shumë vende evropiane dhe ambasada të huaja në Kosovë. E para që e ka përshëndetur anëtarësimin e Kosovës në FMN ishte Ambasada e Shteteve të Bashkuara.

Përfaqësuesit politikë dhe ekspertët e ekonomisë në Kosovë, vlerësojnë se anëtarësimi në Fondin Monetar ndërkombëtar do të ushtrojë ndikim jo vetëm në rimëkëmbjen ekonomike të vendit, por edhe në proceset politike.

Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Ahmet Shala, ka theksuar se Kosova tashmë është e gatshme t'i marrë përsipër obligimet e saj dhe të procedojë me hapa të mëtejshme për nënshkrimin formal të anëtarësim-it në FMN.

sensuale të interesit përmes programit "Poverty Reduction and Growth Facility", që u mundëson atyre ngarkesa më të ulëta të interesit, nëse kanë strategji për reduktimin e varfërisë.


Gjithashtu, përmes "Exogenous Shocks Facility", ofrohet asistencë juridike dhe financiare për shtetet, ekonomia e të cilave shkon drejt kolapsit, si në raste të konflikteve, fatkeqësive natyrore, apo krizave në vendet fqinje.

Anëtarësimi i Kosovës në këtë institucion të rëndësishëm financiar ndërkombëtar pritet të ndikojë në rimëkëmbjen ekonomike të vendit, i cili edhe më tej përballlet me shkallë të lartë të papunësisë dhe rrjedhimisht edhe të varfërisë.

Me anëtarësimin e Kosovës në FMN rilind shpresa për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, me shkallë të tolerueshme të papunësisë dhe normë të përballueshme të inflacionit.

Përparësitë e anëtarësim-it janë në dy rrafshje: në rrafshin ekonomik dhe në atë politik. Në aspektin ekonomik, përparë-





sia është se Fondi Monetar Ndërkombëtar për vendet anëtare ofron ndihma dhe qasje në fonde, siç është fondi special për krizën financiare globale, si dhe jep këshilla dhe harton analiza të cilat përdoren nga investitorët e jashtëm d.m.th merren si shumë të besueshme. Në rrafshin politik, përparësia është sepse një prej tre kushteve kryesore që të jesh anëtar i fondit duhet të jesh shtet, prandaj është një njohje indirekte nga një institucion i njohur.

Kosova nuk do të gëzojë privilegj si vendet që i kanë të zhvilluara politikat e tyre financiare, kur kërkohet financimi nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Procedurat e huadhënies për vendet me të ardhura të ulëta dallojnë nga ato të bankave për zhvillim, pasi që FMN-ja nuk financon projekte specifike.

Përgjegjësia thelbësore e FMN-së është dhënia e kredive për vendet anëtare që ballafaqohen me probleme në bilancin e pagesave dhe krediton buxhetin me kushtet që vetë i përcakton.

Në rast se Kosova ka nevojë për hua nga FMN-ja, në kushtet aktuale do të ketë dy mënyra për të përfituar. Në bazë të rregullave të tij, vendet me të ardhura të ulëta mund të përfitojnë asistencë financiare nëpërmjet programit për zbutjen e varfërisë dhe në rast të kolapsit ekonomik.

Për të marrë një hua, së pari, duhet të përshtaten politikat buxhetore të Kosovës me programet që caktohen si dhe t'u përmbahet objektivave makroekonomike, që huaja të shkojë në të mirë të qytetarëve.

Qeveria e Kosovës duhet të fillojë të përgatisë projekte konkrete dhe t'i fusë në listën e shpenzimeve buxhetore, në mënyrë që të kërkojë financim për to nga FMN-ja.

Normat e interesit, me të cilat jep kredi FMN-ja, sillen nga 0.5 për qind

deri në 1.5 për qind dhe kanë një "greis periudhë" prej 3 viteve.

Historik i shkurtër i FMN-së

Fondi Monetar Ndërkombëtar është krijuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët e tyre për të financuar dhe drejtuar zhvillimin ekonomik pas Luftës së Dytë Botërore.

Fondi Monetar Ndërkombëtar (shkurt FMN) është një organizatë ndërkombëtare e 186 vendeve me seli në Uashington. Qëllimi primar i themelimit të FMN-së ka qenë që të krijohet një bashkëpunim monetar mes vendeve, stabilitet monetar në këmbim dhe marrëveshje të rregullta të këmbimit monetar për të shpejtuar rritjen ekonomike, për të ngritur nivelin e punësimit d.m.th. për zvogëlimin e nivelit të papunësisë dhe për të krijuar asistencë të përkohshme të shteteve të varfra për të balancuar sistemin e pagesave.

Që nga themelimi i vet, FMN gjithnjë i është përmbajtur qëllimit të themelimit, por teknikat e veprimit dhe mënyrat e reagimit ndaj problemeve të shteteve të ndryshme, si dhe numri i shteteve pjesëmarrëse gjatë viteve, kanë ndryshuar.

Si funksionon Fondi Monetar dhe si merren vendimet në këtë institucion?

Puna e FMN-së është e tri llojeve të ndryshme. Mbikëqyrja përfshin monitorimin e zhvillimeve financiare dhe ekonomike, në dhënien e këshillave mbi politikat e ndjekura që synojnë të shmangin krizat ekonomike. FMN-ja gjithashtu u huazon para vendeve me vështirësi në balancën e pagesave, për t'u dhënë financim të përkohshëm dhe përkrahje në korrjimin e problemeve; Huatë për vende me të ardhura të ulëta

- jepen për të reduktuar varfërinë; dhe Asistenca teknike dhe trajnim në fushat e saj të ekspertizës, të cilën FMN-ja u jep vendeve anëtare.

Gjithashtu, për të mbështetur këto tri aktivitete, FMN-ja punon në kërkime ekonomike dhe statistike. Vitet e fundit, në kuadër të përpjekjeve për të forcuar sistemin financiar ndërkombëtar dhe për të rritur efektivitetin në parandalimin dhe zgjidhjen e krizave, FMN-ja ka aplikuar mbikëqyrjen dhe asistencën teknike në zhvillimin e standardeve dhe kodeve të praktikës në fushat e saj të përgjegjësisë, dhe në forcimin e sektorëve financiarë. FMN-ja luan, gjithashtu, një rol të rëndësishëm në luftën kundër pastrimit të parave dhe terrorizmit.

Një nga përgjegjësitë kryesore të FMN është t'u japë hua vendeve me probleme në bilancin e pagesave. Kjo asistencë financiare i mundëson vendeve të rindërtojnë rezervat e tyre ndërkombëtare; të stabilizojnë valutat e tyre; të vazhdojnë të paguajnë për importet e tyre dhe të përtërijnë kushtet për rritje të mirë ekonomike. Ndryshe nga bankat, FMN nuk jep hua për projekte specifike.

Asistenca teknike është një nga përfitimet e anëtarësimit në FMN. Zakonisht jepet falas për çdo vend anëtar që e kërkon. Rreth 90% e asistencës teknike të FMN shkon për vendet me të ardhura të ulëta ose mesatare. Vendet e sapodala nga konfliktet janë gjithashtu përfituese. Përveç përfitimeve të menjëhershme nga vendet, asistenca teknike ndihmon stabilitetin ekonomik global, duke ndihmuar vende individuale të minimizojnë dobësitë e tyre ekonomike. Më tej, asistenca teknike që i jepet vendeve me industrializim të zhvilluar apo në zhvillim në fusha të caktuara të rëndësishme, e mban FMN-në në korrent me inovacionet dhe rreziqet që i kanosen ekonomisë ndërkombëtare. ■

Humbje kohe

“Pasha kohën! Me të vërtetë njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin. (Kur’an:103/1-3)



Muhamed J. KAJOLLI

Askush deri më sot, nuk ka mundur ta vërtetojë shkencërisht ekzistencën inteligjente të gjallesave të tjera në planetin tonë, përveçse ekzistencës inteligjente të njeriut. Ndërsa kjo genie, këtë privilegj ose thesar të çmuar që e posedon, ose duhet ta ndiejë si ogur të bardhë ose si ogur i zi. Kjo mbetet të vlerësohet nga secili njeri në vetvete. Të poseduarit e inteligjencës është sprovë e njeriut, por, në esencë, ky njeri pyetjes se nga i ra ky short atij që ta posedojë këtë thesar tepër të çmuar, iu përgjigj në dy mënyra.

Dy rrugë ka njeriu

Pjesa dërmuese e njerëzimit mendon se ky thesar ishte privilegj për të dhe meritë është Krijuesi i gjithësisë. E falënderon dhe i përkulet me bindje të plotë. Ndërsa pjesa tjetër, këtë privilegj ia dedikon të parëve tanë, të cilëve iu janë mirënjohës, sepse paskan arritur të shkëputeshin nga lloji i tyre shtazarak. Sipas këtyre, njeriu kafshë arriti që diturinë ta trashëgojë dhe gradualisht t’ia përcillte gjeneratave pasuese derisa erdhi në këtë ditë, të cilën jemi duke e jetuar.

Thënë shkurt, një grup i falënderohet Krijuesit të botëve, ndërsa grupi tjetër i falënderohet përvojës së paraardhësve të tyre. Secili grup ka hapur shkollat dhe institutet e veta, që të shohin edhe të tjerët perceptimet e tyre. Nëpërmjet tyre synojnë që secili grup të përvetësojë sa më shumë njerëz. Shkollat fetare i ofrojnë njerëzimit Librat e shenjta, me në krye Kur’anin dhe përvojën shkencore, ndërsa shkolla tjetër i ofron vetëm përvojën shkencore.

Shkolla fetare nuk ia ndaloi njeriut të mos merret me shkencë, përkundrazi të gjitha këshillat e kësaj shkolle të bazuara me Kur’an, e motivojnë njeriun

të bindet me anë të përvojave të jetës së tij. Kjo shkollë, vazhdimisht i ka paraprirë diturisë njerëzore. Me këshillat e dala nga Kur’ani, e ka këshilluar vazhdimisht atë që të largohej prej punëve të pista. Kjo këshillë ka ardhur për shkak se njeriu, përkrah mundësisë së tij për dituri, nganjëherë është pre e intuitës së tij të gabuar që vjen si rezultat i disa personave të cilët bazohen në mendime hipotetike, ose prej disa të tjerëve që ndikohen nga politika.

Të bazuar vetëm në ‘idetë shkencore’, shpeshherë njeriu e vë veten në pozitë ngërçi, ndërsa ky ngërç i merr një kohë bukur të gjatë deri në përmirësimin dhe kthimin e tij në gjendjen e mëparshme. Thënë shkurt, është humbje kohe dhe dëmtim i pariparueshëm për të gjithë ata që bien pre e ideve të tilla. Aq më tepër kur kemi viktimë.

Për këtë shkak, Krijuesi botëve, për të mos pësuar njerëzimi katastrofa (në këtë rast) nga epidemitë e ndryshme, e ka këshilluar njeriun që të mos merret me punë, esenca e të cilave është e paqartë për ta. Në pamje të jashtme, njeriu shpeshherë gjësendet i duken të mira, por realiteti është krejt ndryshe. Njeriu, jo gjithëherë është largpamës dhe i saktë, prandaj le të mos pretendojë për siguri të plotë. Ai fillimisht duhet të shërbehët me Librat e shenjta dhe pastaj të veprojë në mënyrë shkencore.

Shpeshherë njeriu, duke u përpjekur ta bindë njeriun tjetër besimtar se Librat e Shenjta nuk kanë vlerë, mundohet të

shpikë gjera të cilat janë kundër natyrës gjenetike. Për fat të keq, ai do ta vërtetojë se ‘zbulimi tij’ ka dhënë kundërefekte të mëdha, por atë do ta vërtetojë pasi do ta pësojnë (mbase) miliona njerëz.

Pa ndërhyrje

Çuditë prej nga buron gjithë ai elan për të sfiduar natyrën, kur vetë njeriu është një prej përbërësve të saj?! Njeriu do t’i lejohej çdo hulumtim shkencor, i cili buron nga qëllimi i mirë, por çfarë t’i thuhet atij/ atyre që sfidojnë gjenetikën (proceset e natyrës) për inat të besimit të të tjerëve dhe, me të, shkaktojnë rrezikimin e shumë specieve? Janë të pajustificueshme ndërhyrjet e politikave ekonomike ose të atyre të profesionit në punët e shkencëtarëve.

Si shembull do ta merrja zëvendësimin e qumështit të nënës me qumështin pluhur të prodhuar artificialisht nga përzierja e qumështit të lopës me vitaminë të tjera shtesë. Sfidë e madhe. Secila specie ka mënyrën e vet të të ushqyerit, ndërsa njeriu me këtë formë e sfidonte Krijuesin. Njeriu të bëhet më i mëshirshëm dhe më i ditur se Krijuesi?! Çudi! Sipas tyre, Ai nuk ia paska dhënë ushqimin e duhur krijesës së vet, ndërsa humanistët paskan arritur të prodhojnë qumështin i cili do t’i mundësojë njeriut ‘tani e tutje’ të bëhet disa herë më i fuqishëm krahasuar me qumështin e nënës!

Kjo formë e të ushqyerit u propagandua për disa decenie me radhë. Çfarë rezultoi? Foshnja fryhej mirë dhe tregonte



shenjat e një krijese të fuqishme dhe të lakmueshme në pamje. Por cilat ishin kundër indikacionet? Kësaj pyetje nuk do t'i përgjigjem me argumente shkencore. Këtu do të na mjaftonte Fan Noli. "Një ditë në Amerikë e kishin pyetur se çfarë i bën fëmijët tuaj t'i respektojnë prindërit e tyre? Ai iu thotë: Fëmijët tanë ushqehen me qumështin e njeriut dhe respektojnë njeriun, ndërsa fëmijët tuaj ushqehen me qumështin e kafshëve dhe ato i duan".

Pas shumë provave dhe mossukseve, po këto institucione tani u sugjerojnë nënave që mos t'i ndajnë foshnjat e tyre nga gjidhënia. Ushqimi i nënës qenka i pazëvendësueshëm. Kush u mor me pasojat e shkaktuara?... Pse e gjithë kjo humbje kohe?

Kështu ndodhi edhe me praktikën e veterinerëve. Jo shumë larg mësuam për sëmundjen 'çmenduria e lopëve'. Shkencëtarët e po kësaj shkolle, kishin 'vërtetuar shkencërisht' se lopët do të ishin shumë më të shëndosha sikur të ushqeheshin me ushqimin e përgatitur prej tyre. Përbërja e koncentratit të përpiluar nga ata, paska rezultuar 'shumë më e mirë' se sa ushqimi që ua ka përgatitur Krijuesi i botëve. Krijuesi ka krijuar specie kafshësh të ndryshme. Disa prej tyre ushqehen vetëm me mish, ose vetëm me bar, ose ka edhe prej tyre të cilat ushqehen edhe me mish edhe me bar. Por ama, kjo formë e të ushqyerit ishte nga Dituria e Tij absolute. Ai e di për secilin çfarë duhet të hajë e çfarë jo. Por në shembullin tonë, lopa është kafshë që ushqehet vetëm me bar, e jo me përzjerjen e barit dhe të mishit.

Për interesa të disa individëve, njeriu prodhoi ushqimin koncentrat dhe thoshte se, me të, kafshët e buta do të jenë më të majme se sa ato që ushqehen me ushqimin e natyrës. Shkencëtarët kishin prodhuar koncentrat të veçantë për shtimin e mishit dhe koncentrat të veçantë për shtimin e qumështit. Kështu, sërish dëgjoheshin zëra të papërmbytura kundër ligjeve të natyrës (Zotit). Sfiduan Krijuesin!? Pse duhej të sfidohej Krijuesi?! Çfarë e kënaq njeriun që sfidon Krijuesin, ose çfarë fiton vetë njeriu që e sfidon Atë?

Nëse Krijuesi i botëve ka paracaktuar që lopa të jetë vetëm barngrënës, lëre të tillë. Ajo nuk duhet të ushqehet me koncentrat të prodhuar nga njeriu i 'shumë ditur'. Njeriu nga ideja për të fituar më shumë dhe për të mos hedhur mbeturinat (eshtrat) e kafshëve, i bluante ato dhe duke u shtuar edhe një sasi bari, ua servonte lopëve si ushqim. Lopët, nga uria, u detyruan të mësoheshin ta hanin ushqimin e padëshiruar. Por pas disa vjetëve, doli rezultati i shumë pritur nga njerëzit besimtarë. Njerëzimi u alarmua për sëmundjen e çmendurisë së lopëve. Si ta fshihte njeriu se edhe kjo qenie kishte shenjat e çmendjes së njeriut të sotëm? Vrasje kudo dhe pa motiv, bile edhe fëmijët kanë filluar nëpër shkolla të reflektojnë dhunë, deri në vrasje, që po na tmerrojnë.

Këto ditë, kemi një alarm të ri, gripin e derrave. Sipas shkencëtarëve ende nuk është zbuluar mbrojtja nga ky virus. Njeriu duhet ta parandalojë këtë grip me anë të këshillave që ka këshilluar shkencë fetare, tash e disa shekuj. Se çfarë të

themi për këtë sëmundje, ende është herët, por ajo që mund të themi për të është: Njerëz, mos sfidoni proceset e natyrës, largohuni nga vendet e pista dhe nga amoraliteti, derisa nuk jemi përballur me përvojat akoma më të hidhura se sa këto të lartpërmendurat. Çmenduria e lopëve dhe qumështi 'special' do të na duken shumë të vogla krahasuar me sëmundjen e derrave ose të sëmundjeve që ende nuk i kemi në fjalorët tanë. Nga shumë kafshë, që Kur'ani ia ka ndaluar njeriut, derri ka një status të veçantë në familjen e kafshëve. Krijuesi i botëve e këshillon njeriun që të jetë sa më larg tij.

Krijuesi e ka lënë njeriun të lirë në veprime. Pra, statusi i njeriut na qenka liria e plotë. Ai ka lirinë e hulumtimit dhe të shpikjeve. Gjithsesi e ka lirinë që të mund ta 'sfidojë' edhe vetë Krijuesin. Ai, gjithashtu, ia ka bërë atij të qartë se do ta tolerojë derisa ai vetë të bindet se pronari i vetëm dhe i pa konkurrent është Krijuesi i Gjithësisë, e jo ndonjë tjetër. Ajeti kur'anor do të jetë dëshmitari ynë: *Ne do t'u tregojmë shenjat Tona në hapësirat tokësore e qiellore, si dhe në vetvete, derisa t'u bëhet e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë. Vallë, a nuk të mjafton ty që, Zoti yt është Dëshmues i çdo gjëje?! (Kur'an: 41/53)* Prandaj, le t'i kthehemi këshillave të Kur'anit, prej të cilit kemi dobi dhe të jetojmë nën mëshirën e Krijuesit i cili posedon Fuqinë dhe Diturinë Absolute. Pse të humbim kohë? Pse të bëhemi pre e atyre që mundohen ta mbulojnë krizën me gjëra tronditëse dhe frikuese për njerëzimin? ■

Ethet e testit të maturës

Ben VELIU

Më gjashtë qershor, në 29 komuna të Kosovës do të organizohet testi i maturës për vitin 2009. Maturantët shprehin shqetësimin e tyre para nënshtrimit në këtë test, duke e cilësuar atë si mjaft të rëndësishëm për vazhdimin e studimeve.

Pajtim Xhyllani, maturant në gjimnazin Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, në Drenas, shpreh se me kalimin e ditëve, brenga, stresi dhe pasiguria se a do të ketë sukses në këtë test shtohet.

Pajtimi pohon se ai ka qenë gjithnjë një nxënës i shkëlqyeshëm, por kjo nuk

e bën të ndihet aspak i sigurt nëse ai do ta kalojë testin. Ai thotë se është duke punuar në mënyrë intensive veçanërisht në lëndët në të cilat do të testohet. "Po mësoj rreth tri orë në ditë në mënyrë që ta kaloj këtë test. Kalimi i tij është shumë i rëndësishëm për mua sepse do të më hapte rrugën drejt studimeve" - shpreh Xhyllani, i cili me gjithë punën e palodhshme që ka bërë, ka frikë dhe ndihet i pasigurt. "Sado që përpiqem dhe mësoj me intensitet të shtuar, prapëseprapë, vetë ideja e një dështimi të mundshëm më tmerron" - thotë Pajtimi.

Një brengë për të është edhe shuma prej 10 eurove të cilën e ka vendosur Ministria e Arsimit për të pasur të dre-

jtë hyrje në test. "E di që pagesa prej 10 eurove nuk është shumë e lartë, por është brengosëse për mua sepse unë personalisht nuk kam asnjë anëtar të familjes në marrëdhënie pune" - shprehet ai.

Vitin e kaluar, testit të maturës në afatin e qershorit iu nënshtruan 20.516 maturantë, prej të cilëve 12.235 apo 59.63 % fituan të drejtën për t'u pajisur me diploma, ndërsa në afatin e gushtit, nga 8.815 maturantë, testin e kaluan 2.830, apo 31.97 %

Sivjet testit të maturës pritet t'i nënshtrohen afro 23.000 maturantë dhe kriteri i kalueshmërisë do jetë i njëjtë sikurse vitin e kaluar, ku një maturant duhet të plotësojë në mënyrë të saktë 50 % të pyetjeve për të fituar të drejtën e pajisjes me diplomë. ■

Dështimi i radhës: Trusti i pensioneve!



Sead UJKANI

Kriza botërore financiare, e cila karakterizoi botën fundvitin e kaluar, përkatësisht gjysmën e dytë të vitit 2008 dhe që është duke vazhduar edhe tani, pati efekte mjaft negative në ekonominë botërore në tërësi.

Në këtë kontekst, shenjat e kësaj krize u vërejtën edhe tek ne, edhe pse ekonomia e vendit tonë nuk paraqet ndonjë indikator të rëndësishëm në mbarë ekonominë botërore. Mirëpo kriza financiare e shtriu fushëveprimin e saj edhe tek ne, para së gjithash, në dy elemente kryesore: 1) në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe 2) në dërgesat nga bota e jashtme.

Shikuar në përgjithësi, mund të themi se kriza i preku qytetarët e vendit tonë duke ua zvogëluar mjetet pensionale të kursyera, si dhe zvogëloi gjithashtu dërgesat nga bota e jashtme, një element ky shumë i rëndësishëm për vendin tonë, sidomos në dy dekadat e fundit.

Nga të dyja këto, një çështje shumë e diskutuar dhe brengosëse ishte humbja e mjeteve të Trustit të Pensioneve, respektivisht rënia e vlerës së investimeve të Trustit gjatë gjithë vitit.

Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti) është institucion i themeluar në gusht të vitit 2002. Detyra kryesore e tij është administrimi dhe menaxhimi i kontributeve të obligueshme dhe vullnetare pensionale të të punësuarve në vendin tonë.

Gjatë gjithë këtyre viteve të funksionimit të tij, Trusti i pensioneve ka mbledhur një shifër të madhe të kontributeve pensionale të kursyera nga qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilat më pas janë bërë në klasa të aseteve, tregje botërore dhe industri nga më të ndryshmet. Dhe pikërisht këtu është edhe arsyeja kryesore që disa milionë euro humbën si pasojë e krizës, meqë mjetet e Trustit ishin mjaft të ekspozuara karshi krizës financiare, sepse ato edhe realisht ishin te investuara

në disa institucione dhe kompani financiare të rëndësishme botërore disa prej të cilave edhe falimentuan.

Një pyetje e cila ka qarkulluar dhe është debatuar shpesh ndër qytetarët e vendit është ajo se pse këto mjete nuk u investuan në vendin tonë dhe përgjigja ka qenë se e tërë kjo është bërë meqë në Kosovë nuk ekziston treg i mirëfilltë i letrave me vlerë dhe ende nuk ka zhvillim të tij.

Ajo çka është zhgënjyese është fakti se e tërë kjo kaloi pa ndonjë bujë të madhe dhe veprime konkrete nga institucionet e vendit, ndonëse mediat deri në një masë u munduan t'i japin rëndësinë e duhur kësaj çështjeje. Madje edhe kërkesa e bërë nga ana e disa deputeteve për debatuar për këtë çështje në Kuvend nuk u miratua.

Më ka rastisur të dëgjoj këto ditë shumë qytetarë të thjeshtë të diskutojnë rreth kësaj çështjeje, meqë shumë prej tyre këtë muaj janë njoftuar me saldoto e tyre të kursimeve poensionale dhe, në këtë drejtim, i kam vërejtur tek qajnë hallin dhe ankohen për zvogëlimin e këtyre kursimeve si pasojë e krizës financiare botërore.

TKPK: Humbja është ende e porealizuar

Një tjetër element mjaft i diskutuar ka qenë edhe fakti se a është realizuar humbja e këtyre mjeteve dhe a ekziston mundësia e kthimit të tyre. Në njoftimin e tyre përmes buletinit zyrtar të Trustit, të publikuar në webfaqen e tyre, është thënë si vijon: Kriza financiare ka shkaktuar rënien në vlerë të fondit të kursimeve pensionale të qytetarëve të Kosovës, e assesi humbjen e tij. Ju, përmes Trustit, vazhdoni t'i pronësoni sasinë e njëjtë të aksioneve të cilat i keni pronësuar para se kjo krizë të paraqitej. Dallimi i tashëm me atëherë është se vlera e këtyre aksioneve është zvogëluar, gjë që e zvogëlon vlerën e llogarive tuaja individuale. Me rritjen e vlerës së këtyre aksioneve edhe vlera e llogarive tuaja do të rritet. Është me rëndësi të mbahet mend se këto aksione janë pasuri, dhe të kuptohen si të tilla. Mirëpo vlera do të kthehet, ashtu siç ka dëshmuar historiku i ekzistencës së tregjeve.

Duke folur për këtë çështje, Shpend Ahmeti nga Instituti për Studime të

Avancuara - GAP, ka theksuar: "Trusti i Pensioneve të Kosovës i ka pasur paratë të investuara direkt në tregjet financiare, në fondet më të fuqishme botërore, të cilat kanë pësuar një goditje të rëndë nga kriza financiare globale. Është e pamundur që Trusti t'i shpëtojë gjithë kësaj. Kjo nuk ka të bëjë me praktikën e tyre të mira apo të këqija. Kanë humbur edhe institucione shumë më të mëdha dhe më profesionale. Ahmeti, gjithashtu, ka theksuar së Trusti duhet të jetë më transparent dhe nuk duhet t'i fshehtë humbjet, si dhe ka hedhur përgjegjësinë për këto humbje edhe tek Banka Qendrore. "Nuk është reale që të fshihet se sa para janë humbur. Po ashtu, unë mendoj se përgjegjësia nuk është vetëm e Trustit, por edhe e Bankës Qendrore, pasi që Trusti raporton para saj" - ka thënë Ahmeti.

Një element tjetër, që e ka karakterizuar Trustin gjithë këta muaj dhe që është zvarritur shumë, ka qenë edhe fakti se ai deri në këtë fillim muaji ka funksionuar pa bord dhe, natyrisht, ka ekzistuar edhe vakum në udhëheqjen e tij.

Mirëpo, shikuar në tërësi, për momentin kursimet e qytetarëve të vendit tonë janë zvogëluar dhe Trusti realisht ka pësuar humbje. Prandaj shpresojmë që kjo të shërbejë si një indikator i fuqishëm për ta shikuar politikën e investimeve të Trustit, si edhe për ta analizuar mundësinë e investimeve të tyre edhe në shtetin tonë, i cili ka nevojë të madhe për investime të tilla! ■

281.120 kontribuues

Gjendja e Trustit, në përfundim të tremujorit të parë të këtij viti, ishte si vijon:

258 milionë euro nën menaxhim

317 052 678.2946

281.120 kontribuues

▲ 2.182% - Çmimi i Aksionit në mars 2009

▼ 5.406% - Çmimi i Aksionit prej fillimit të vitit

▲ €5.60m - Kthimi në investim në mars 2009

▼ €13.09m - Kthimi në investim prej fillimit të vitit

Intervistë me Prof. dr. Salih Ahmetin, infektolog-hepatolog

Gripi e derrave – rreziku nga pandemia

- Derri është rezervuar i virusit e nga kjo rrjedh edhe emërtimi;
- Mundësia për t'u infektuar është më e madhe tek njerëzit që janë në kontakt direkt me derrat;
- Kosova e përgatitur për t'u përballur me këtë lloj gripi.

Intervistoi: Iliriana ALLOQI

Lajmi kryesor i këtyre ditëve, që ka tronditur botën, është një virus i ri që u quajt "Gripi i Derrave". Si njerëzit, edhe derrat, preken nga gripi (influenca virusi), por ky lloj virusi nuk është i njëjtë me ata të njerëzve dhe shumë më rrallë na prek neve për shkak të kontaktit të rrallë me derrat. Por, shpërthimi i fundit i këtij virusi është më ndryshe, pasi ai ka pësuar disa ndryshime dhe është aftësuar të kalojë prej njeriut tek njeriu dhe jo vetëm nga derri te njeriu.

Me qëllim që të njihemi më për së afërmi me këtë virus vdekjeprurës, zhvluam një intervistë ekskluzive me prof. dr. Salih Ahmetin, infektolog-hepatolog.

Derri është rezervuar i virusit e nga kjo rrjedh edhe emërtimi

PAQJA: *Profesor a mund të na sqaroni se çka është "Gripi i derrave" dhe kush e shkakton?*

AHMETI: Gripi i derrave është një sëmundje infektive akute e traktit respirator e cila aksidentalisht përhapet nga derri tek njeriu. Shkaktohet nga virusi i influencës tip A –H1N1, i cili i përket familjes së Orthomyxoviridae. Shfaqet në formë epidemike dhe pandemike. Burim i infeksionit është njeriu, ndërsa kafshët dhe shpezët (derri, kuajt, pulat, rosat, gjelat e detit, etj) mund të jenë rezervuarë të infeksionit dhe përgjegjës për ruajtjen e virusit gjatë periudhave interepidemike dhe rekombinimet e mundshme gjenetike të tij.

PAQJA: *A është i saktë emërtimi "Gripi i derrave"?*

AHMETI: Është rrjedhojë logjike që duke u bazuar në vendin e shfaqjes së parë të bëhet fjalë për "Gripi Amerikan-Verior". Shembull për këtë është "Gripi Spanjoll", që u përhap pas Luftës së Parë Botërore. Por mendoj se edhe këtu ekziston një analogji, ku kafsha,

në rastin tonë derri, është rezervuar i virusit e nga kjo rrjedh edhe emërtimi, përndryshe ky është vetëm një shtam i caktuar, apo një mutacion, që ka pësuar virusi i gripit. Pra, pavarësisht nga fakti se quhet gripi i derrat, kemi të bëjmë me një shtam të ri, i cili nuk është identifikuar më parë.

Mundësia për t'u infektuar është më e madhe tek njerëzit që janë në kontakt direkt me derrat

PAQJA: *Profesor a mund të na thoni cila është mundësia për t'u infektuar dhe çka e bën kaq të rrezikshëm "Gripi i derrave"?*

AHMETI: Mendoj se mundësia për t'u infektuar është më e madhe tek njerëzit që janë në kontakt direkt me këto kafshë. Njeriu infektohet dhe pas kësaj sëmundja fillon të përhapet me shpejtësi nga njëri person tek tjetri. Përhapet përmes spërklave të nxjerra në ambientin e jashtëm nga njeriu i infektuar përmes kollitjes, tes-



htitjes apo edhe në kontakte të ngushta ndërnjerezore. Mundësia aerogjene dhe intrahumane e përhapjes së sëmundjes e bën atë të rrezikshëm, për arsye se mundësia e izolimit është më e vogël dhe shpejtësia e përhapjes është e madhe.

PAQJA: *A mund të na i thoni disa fjalë rreth simptomave dhe asaj se si manifestohet ky gripi?*

AHMETI: Simptomat e këtij gripi tek njerëzit janë të ngjashme me simptomat e një gripi të zakonshëm: temperaturë, kollë, dhembje koke, dhembje e muskujve dhe e neyive, marrje mendsh, ndjenjë e lodhjes dhe këputje, humbje e apetitit. Shumë nga personat e prekur nga sëmundja mund të kenë edhe diarree dhe të vjella të vazhdueshme.

PAQJA: *Si mjekohet ky gripi?*

AHMETI: Sëmundja është një kombinim i gripit të derrat, shpendëve dhe njeriut. Në fakt nuk ka vaksinë për parandalimin e tij. Autoritetet e Kosovës tanimë kanë porositur edhe kontingjentin e parë të medikamenteve për trajtimin e gripit të derrave, i cili është përhapur në shumë vende të botës. Deri më tani, është siguruar një sasi e konsiderueshme e dozave të Tamifluse, bar ky që rekomandohet për këtë virus dhe gjithashtu është bërë mobilizimi i gjithë stafit mjekësor në drejtim të përgatitjes për rastet e para të mundshme. Tamiflu jepet në formë tabletash për 5-7 ditë.

PAQJA: *Profesor çka mund të na thoni për preventivën, cilat janë masat parandaluese?*

Meksika - epiqendër e infektimit

Sipas të dhënave që kanë arritur nga Meksika, e cila është epiqendra e infektimit, numri i të vdekurve nga gripi i derrave e ka kaluar shifrën 100.

"Të dhënat e fundit të cilat i disponojmë tregojnë për 1.614 raste, prej të cilave 103 kanë ndërruar jetë" - ka njoftuar ministri mexikan i Shëndetësisë, Hoze Anhel Kordoba. Të gjitha tubimet publike në këtë vend janë anuluar, ndërsa tregjet, restorantet dhe kinematë janë mbyllur. Nëpër rrugë dhe në transportin publik ka më pak njerëz, ndërsa disa mbajnë maska në fytyrë.

Banka Botërore i ka aprovuar hua Meksikos një vlerë prej 205 milionë dollarësh për luftimin e gripit të derrave, prej të cilëve 25 milionë dollarë do të dedikohen për furnizimin emergjent të ilaçeve dhe teknikës medicinale për diagnostifikim.

AHMETI: Në radhë të parë të kemi një higjienë të mirë të duarve dhe të ambientit përreth, të përdorim ushqime të përgatitura mirë termikisht, pemë dhe fruta, si dhe të shmangemi nga vendet që janë potencialisht burim i infeksionit. Personat e dyshuar apo të infektuar duhet të izolohen në pavijonet e sëmundjeve infektive.

Kosova e përgatitur për t'u përballur me këtë lloj gripi

PAQJA: *Tashmë janë regjistruar disa raste në Evropë. Na intereson të dimë, deri më tash, a ka raste të dyshuara në Kosovë?*

AHMETI: Fatmirësisht deri tash nuk ka raste të dyshuara në Kosovë, por kjo nuk do të thotë që nuk do të mund të ketë në ditët në vazhdim, kur kemi parasysh se në disa shtete të Evropës tashmë janë paraqitur rastet e para.

PAQJA: *Profesor, në rast dyshimi për ndonjë rast, a ekzistojnë në Kosovë kushte për një diagnostikim edhe një mjekim të drejtë të të infektuarve nga ky grip?*

AHMETI: Uroj të mos ketë raste të shënuara në Kosovë por, edhe nëse kjo ndodh, besoj që janë bërë përgatitjet e duhura për të vepruar konform gjendjes aktuale. Nuk është hera e parë që Kosova përballlet me epidemi dhe sëmundje me kontagjiozitet të lartë (ethet hemorragjike virale, meningjitet seroze, etj) por edhe këtë herë them se do të dimë ta menaxhojmë situatën.

PAQJA: *A mendoni që ekziston rreziku për shfaqjen e një pandemie?*

AHMETI: Edhe pse jam ekspert i këtij lëmi, në këtë pikë kam ca rezerva (shfaqja në një sezon jo të zakonshëm për gripin) dhe vetë fakti se në më shumë se 20 shtete të botës janë shënuar së paku nga një rast, e çdo ditë po vazhdojnë të shënohen edhe raste të reja, atëherë kjo flet për diçka serioze dhe për mundësinë e një shpërthimi pandemik.

PAQJA: *Profesor, nga se dallohet gripi i derrave nga ai i zakonshmi?*

AHMETI: Të dhënat e para për gripin i gjejmë që nga viti 1173 dhe deri më sot kanë ndodhur rreth 300 pandemi gripale. Pandemitë më të mëdha janë shënuar në vitin 1918-1919 "Gripi Spanjoll", më 1957-1958 "Gripi Aziatik" dhe në vitin 1968-1969, në të cilat humbën jetën miliona njerëz në vende të ndryshme të botës. Në fakt, nuk kanë dallime esenciale. Fjala është për të njëjtin virus, virusin e gripit tip A, vetëm se janë paraqitur shtame të tjera, shtame më agresive.

PAQJA: *Profesor, cila do të ishte këshilla juaj drejtuar lexuesve tanë?*

AHMETI: Mendoj se nuk ka nevojë për panik, por vetëm për kujdes dhe për përfilljen e këshillave mjekësore. Shfrytëzoi rastin t'ua kujtoj institucioneve kompetente, që ne jemi në prag të shpërthimit të mundshëm endemik ose epidemik të epidemisë së etheve hemorragjike, të cilat kanë rrezikuar dhe mund të rrezikojnë seriozisht shëndetin e popullatës, prandaj masat mbikëqyrëse dhe preventive duhet të fillojnë që tani. ■

Dhjetë vjet pas!

Abdurrahim MAXHUNI

Po bëhen dhjetë vjet që kur Kosova përfundimisht u shklorëzua nga e kaluara e saj e hidhur, e udhëhequr nga politikat serbo-sllave dhe Millosheviene, për të mos u kthyer kurrë më në radhët e saj.

Po bëhen dhjetë vite që kur Serbia kriminale e humbi administrimin e Kosovës, administrim që e mori nën udhëheqjen e saj OKB-ja.

Po bëhen dhjetë vjet që kur qytetarët e Kosovës, pa përjashtim, i madh e i vogël, i mbushën rrugët duke u uruar mirëseardhje misionit të ri në Kosovë. Kjo ishte ditë historike për një popull të vuajtur dhe të shkelur për më se një shekull. Kjo për çdonjërin ishte ditë e madhe dhe e shumëpritur, ditë për të cilën u derdh shumë gjak, u keqtrajtuat shumë njerëz dhe shumë të tjerë u dëbuan. Ditë në të cilën në fundin e tunelit u duk një dritë e vogël shprese, se tashmë ka ardhur koha për përparim, prosperitet dhe mirëqenie sociale.

Por, si duket kjo dritë në fund të tunelit, paska qenë vetëm një shkëndijë e vogël dhe tepër e largët për Kosovën dhe popullin e saj.

Po bëhen dhjetë vjet që e keqja mori hov, që kur korrupsioni në nivel institucional ka filluar të përhapet si një sëmundje e keqe për shoqërinë, kur varfëria ka arritur në kulmin e saj, kur gjendja ekonomike sa vjen e rëndohet dhe është fashitur shpresa për përparim, zhvillim ekonomik dhe ulje të varfërisë.

Pa dyshim se varfëria është çështja që më së shumti i preokupon qytetarët e Kosovës. Çështja e varfërisë është e lidhur ngushtë me papunësinë e madhe dhe është pikërisht përqindja e lartë e papunësisë që ka ndikuar në rritjen e numrit të familjeve që marrin asistencë sociale. Shifrat janë tejet alarmante. Afro 18 % e popullsisë jetojnë me më pak se një dollar në ditë, ndërsa për qindja e përgjithshme e varfërisë arrin diku 40 %.

Në anën tjetër, ekonomia siç duket nuk po lëviz nga vendi që kur Kosova hyri nën administrimin e OKB-së. Mungesa e sigurisë për investime nga jashtë ka qenë arsyeja kryesore e moszhvillimit ekonomik. Kësaj mund t'iu bashkëngjiten edhe paaftësia e institucioneve të Kosovës për të krijuar kushte për investime, siç është rasti me mungesën e energjisë elektrike, gjithashtu mungesa e projekteve konkrete dhe joshëse, mungesa e ligjeve etj.

Ka edhe gjëra të tjera negative që kanë dalë në shesh sikurse dalin kërpuhat pas shiut. Mungesa e energjisë elektrike, mungesa e infrastrukturës rrugore, mungesa e ujit të pijshëm, korrupsioni i lartë, madje edhe në nivele institucionale, mungesa e reformave në sistemin arsimor dhe atë shëndetësor, janë vetëm disa nga anët e këqija dhe negative të shoqërisë sonë.

Nga e tërë kjo shihet qartë se qytetarët e Kosovës janë duke u përballur me vështirësi të shumta, dhe të rinjtë janë ata që më së keqi po e kalojnë këtë gjendje. Shumë prej tyre të ardhmen nuk e shohin në Kosovë, por në shtetet perëndimore.

Qeveria e Republikës së Kosovës, me të gjitha mekanizmat e saj duhet të punojnë shumë që ta nxjerrë nga kriza këtë popull të vuajtur. Qeveria duhet të mendojë për perspektivën evropiane për zhvillimin ekonomik dhe për uljen e varfërisë. Ajo duhet të nxjerrë ligje, të bëjë projekte konkrete dhe të krijojë kushte për investime nga jashtë, në mënyrë që të ulet numri i të papunëve. ■

Korrespondencë nga Shkupi

Me NATO-n apo me Rusinë?!

Ndonëse shqiptarët me shumicë dërrmuese synojnë që Maqedonia të hyjë në NATO, kjo sipas anketimeve nuk qëndron kështu edhe me maqedonasit. Bile disa maqedonas radikalë janë shprehur se Maqedonia do të duhet të presë forcimin e Rusisë dhe se nuk ka përse të insistojë me çdo kusht për inkuadrimin në NATO.



Avni AVDIU

Maqedonia, nën tryshninë e brendshme dhe të jashtme, ndodhet në udhëkryq. Ferra që i ka dalë në rrugën e integritimeve euroatlantike është e madhe dhe e vështirë për t'u kaluar. Kontesti i emrit me Greqinë, aq shumë i stërzgatur, ka arritur drejt fundit: ose duhet zgjidhur përfundimisht, ose gjithçka do të mbetet pezull. Hezitimi i pushtetarëve maqedonas ndaj propozimit të fundit të shtruar në tryezën e bisedimeve është sa për të bërë naze. Në realitet propozimi 'Maqedonia Veriore' është kompromisi me më pak dhimbje që mund ta gëlltisë pala maqedonase. Madje-madje shikuar nga këndvështrimi i disa shembujve botërorë (si Koreja, ish-Gjermanitë...), ky propozim logjikisht nuk tingëllon në disfavor të Maqedonisë. Megjithatë pala maqedonase thekson se grekët duan më tepër: të cenojnë drejtpërdrejt identitetin kombëtar. Mirëpo sa i përket identitetit kombëtar atë e kanë kontestuar edhe bullgarët. Bile edhe ish-kryeministri maqedonas, Lupço Georgievski, është

shprehur se maqedonasit kanë identitet të përbashkët me bullgarët. Në anën tjetër, serbët kanë kontestuar kishën maqedonase. Dhe në vazhden e këtyre kontestimeve, qeveria kërkon të rikuperojë vetëbesimin e popullit maqedonas me ngjalljen e emocioneve nacionaliste dhe religjioze. Në këtë kontekst vlen të veçohet politika e qeverisë maqedonase për ndarjen e 10 milionë eurove për ngritjen e statujave: kuaj e luanë, të heronjve kombëtarë me në krye Aleksandrin e Madh dhe në ndërtimin e kishave të reja, përfshirë edhe atë në qendër të Shkupit. Ndërtimin e kishave kryeministri Gruevski e ka arsyetuar se janë në interesin shtetëror. Ambasadori i Bashkimit Evropian në Maqedoni, Ervan Fuere, është shprehur me të drejtë se, në këtë kohë të krizës globale, paratë e parapara nga qeveria për ndërtimin e skulpturave dhe kishave do të ishte më mirë të investoheshin për zbutjen e papunësisë dhe për përmirësimin e gjendjes ekonomike. Ndërkaq iniciativa për ndërtimin e kishës në qendër të Shkupit, ka zgjuar reagime nga pala shqiptare për ndërtimin e xhamisë Burmalit të rënuar më 1925. E përballur me kriza të ndryshme, Maqedonia tani për tani ka rënë kllloçkë në strofullin e etnocentrizmit, nacionalizmit dhe ksenofobisë. Ndonëse shqiptarët me shu-

micë dërrmuese synojnë që Maqedonia të hyjë në NATO, kjo sipas anketimeve nuk qëndron kështu edhe me maqedonasit. Bile disa maqedonas radikalë janë shprehur se Maqedonia do të duhet të presë forcimin e Rusisë dhe se nuk ka përse të insistojë me çdo kusht për inkuadrimin në NATO. Dhe pa mëdyshje, përgjegjësinë më të madhe për gjithë këtë gjendje kaotike e ka partia VMRO DPMNE, e cila në saje të politikës së saj antishqiptare ka arritur të fitojë pushtet absolut, duke zotëruar presidencën, parlamentin, qeverinë dhe pushtetin lokal. Ajo e ka fituar kredibilitetin e popullit për ta çuar vendin drejt progresit, por përkundër kësaj kjo parti ngurron. I bën bisht zgjidhjes së problemit me emrin, komprometohet duke u zënë me investitorin më serioz austriak EVN, gjë që jep sinjale negative për sigurinë e investimeve të huaja si dhe improvizon probleme të paqena, në vend se të angazhohet për zgjidhjen e atyre ekzistuese. Kjo politikë skajshmërisht absurde ka shpikur mekanizmin e referendumit për ta zgjidhur problemin e emrit, duke zgjedhur opsionin më të rrezikshëm të mundshëm, pa çarë kokën fare për reperkusionet e dështimit eventual të atij referendumit.

BDI-ja në siklet...

Dhe kur analizohet kjo situatë kaq e mjerë, subjekti më në zor që përballet me sikletin më të madh, është BDI-ja. Brenda kësaj partie ditëve të fundit kanë dalë qëndrime dihotomike, diametralisht të kundërta. Njëri zë thekson se koalicioni qeveritar shkon për mrekulli (Gëzim Ostreni), ndërsa tjetri thotë se koalicioni çalon (Fazli Veliu, Teuta Arifi, Xhevat Ademi...). Pas tetë muaj bashkëqeverisjeje është prononcuar edhe kryetari i partisë, Ali Ahmeti. Ai ka fajësuar ministrat shqiptarë për të cilët ka thënë se duhet të punojnë më shumë. Ishte ky veçse një tentim për të kërkuar alibi për pozicionin e dobët në qeveri. Në emisionin e TV AlsatM "Rruga



drejt”, kryetari i komunës së Gostivarit, Rufi Osmani, i ka sugjeruar kryetarit të BDI-së mënyrën për të dalë nga ky qorrsoakak. Ai i ka porositur krerët më të lartë të BDI-së që të marrin vetë pjesë në qeverinë Gruevski dhe, duke e kombinuar autoritetin politik me pushtetin ekzekutiv, të jenë më efikas për ta çuar përpara programin partiak, për zbatimin e të cilit kanë marrë votëbesimin e shumicës së elektoratit shqiptar. Në të kundërtën, nëse BDI-ja vazhdon bashkëqeverisjen e saj me këtë avaz, atëherë rrezikon rejtingun e përgjithshëm të shqiptarët. Në këtë sens mund të thuhet se duke e hetuar këtë fakt, prefekti i Gostivarit ka paralajmëruar formimin e partisë së tij. Zaten ai i mati forcat me të dy partitë, BDI-në dhe PDSH-në dhe fitoi dyfishin në Gostivar. Kështu që fama e tij mund të paraqesë rrezik permanent për BDI-në, partinë shqiptare në pushtet pa pushtet. Përndryshe largimi i Cërvenkovskit nga presidenca dhe inkuadrimi i tij në udhëheqjen e partisë LSDM, pritet të sjellë atmosferë të re politike në Maqedoni, ose me fjalë të tjera ekuilibrimin e forcave partiake maqedonase. LSDM-ja është shprehur për zgjidhjen sa më të shpejtë të problemit me Greqinë, qoftë edhe me ndërrimin e emrit. Këtë kjo parti synon ta arrijë përmes VMRO DPMNE-së ose me konsensusin partiak, njësoj siç qe arritur kompromisi rreth Marrëveshjes së Ohrit. Dhe koston e kësaj LSDM-ja e di më së miri. Ajo shpreson për përsëritjen e skenarit pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, kur VMRO-ja pësoi disfatë në zgjedhjet e atëhershme. Pra, LSDM-ja pretendon të vijë në pushtet pas ndryshimit të emrit. Atëherë ajo do të ketë çfarë t’i thotë popullit maqedonas për politikën e VMRO DPMNE - së, e cila fillimisht reziston ashpër sa për të fituar poenë politike, e pastaj me hir ose pahir lëshon pe.

Së këtejmi, pushteti absolut i VMRO DPMNE – së, në një anë, ka vazhduar flirtin me Beogradin, duke i normalizuar marrëdhëniet me Serbinë, kurse nga ana tjetër ashpërson kursin me shqiptarët. Politika maqedonase ka ndaluar në vendkalimin kufitar në Bllacë liderin e Lëvizjes ‘Vetëvendosje’ Albin Kurtin, të cilin e ka kërcënuar që të mos hyjë më kurrë në Maqedoni. Në vendkalimin në Bllacë automjetet me targa të Kosovës i nënshtrohen kontrollit të rreptë policor. Në Strugë autoritetet lokale janë arsyetuar se nuk kanë mjete për të shlyer grafitet në mure me parulla antishqiptare: ‘Vdekje shqiptarëve’. Kryeministri Gruevski nuk gjeti forcë as ta urojë kryeministrin shqiptar Berisha për anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në NATO. Pa i rinumëruar edhe shumë gjëra të tjera me theks antishqiptar, gjithsesi imponohet pyetja se nga motivohet e gjithë kjo energji antishqiptare e pushtetit maqedonas, pse i gjithë mllefi kundër fqinjëve kulmon dhe derdhet vetëm mbi shqiptarët dhe deri kur maqedonasit do ta kuptojnë se pa shqiptarët e kanë kot të mbajnë e të ruajnë shtet stabil? Tani për tani mund të thuhet vetëm një gjë. Këtë maqedonasit e as pushteti i tyre nuk mund ta kuptojnë, përderisa shqiptarët mbajnë pozicione vasale kundrejt tyre.

Korrespondencë nga Mitrovica

Rindërtimet në “Kroi e Vitakut” ngjallin shpresat për kthim

Ahmet Rama, përfaqësuesi i lagjes, rikujton se këtu, para lufte, kanë jetuar 127 familje shqiptare me 812 anëtarë, si dhe kanë qenë edhe 27 troje të shqiptarëve, prona të cilat nuk u kursyen nga demolimet dhe shkatërrimet.



Florije ADEMI

23 prilli i këtij viti do të mbetet në kujtesën e banorëve të lagjes veriore “Kroi i Vitakut” në Mitrovicë, ku pas dhjetë vitesh gjallërohet shpresa e mbi 100 familjeve për t’u kthyer në pronat e tyre, prej nga ishin larguar me dhunë nga forcat paramilitare serbe gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Ky proces ka filluar me pastrimin nga rrënojat e dy shtëpive të Sahit dhe Sabit Behramit, për rindërtimin e të cilave një pjesë të mjeteve janë siguruar nga OJQ “Veriu”. Ndërkaq ka vazhduar me rindërtimin edhe të pesë shtëpive të tjera që janë marrë me tender, dy prej të cilave, ajo e Ali dhe Kadri Kadriut vetëm do të rinovohen, ndërkaq të tjerat do të rindërtohen dhe do të kenë modelin e njëjtë. Për këto shtëpi qeveria e Kosovës ka ndarë shumë prej rreth 150 mijë euro.

Fillimi i këtij procesi nuk po u konvenon dhjetëra serbëve që konsiderohen

të jenë banorë të kësaj lagje, të cilët kundërshtimet e tyre po i shprehin përmes protestave të përditshme, duke tentuar që ta pengojnë punën.

Por si duket forcat e sigurisë kësaj here janë të vendosura në ofrimin e plotë të sigurisë për rindërtim dhe deri më tani nuk i kanë lejuar serbët e rebeluar të bëjnë një gjë të tillë.

I vetmi mjet që ata kanë përdorur për zmbarsjen e tyre është gazi lotsjellës, ndërkohë që protestuesit serb një ditë nuk kanë hezituar të gjuajnë edhe mjete eksplozive dhe me armë zjarri në drejtim të forcave të sigurisë, por fatmirësisht pa pasoja në njerëz.

Clasing: Jemi këtu për ta ndihmuar policinë lokale

Zëdhënësi rajonal i Policisë së Kosovës, Besim Hoti, thotë se kemi një ripërsëritje të një skenari të ngjashëm të protestës për kundërshtimin e procesit të rindërtimit të shtëpive shqiptare, derisa forcat policore të EULEX-it dhe ato të KFOR-it po e mbështesin këtë proces me parametra të zgjeruara të sigurisë. Sipas tij, gjatë këtyre ditëve është raportuar vetëm



Solidariteti...

Shqiptarët, kur duan, dinë t'i përkrahin dhe t'i shtyjnë përpara proceset, dinë të jenë solidarë dhe ta ndihmojnë njëri-tjetrin. Pronari i kompanisë "Lesna" në Prishtinë, Adem Dëshishku, një ditë ishte vizitë në këtë lagje, me ç'rast ka dhuruar dyer për 7 shtëpitë të cilat janë duke u rindërtuar, gjë të cilën siç u shpreh ai nuk e ka bëri për kapuç të madh, por për hatër të Zotit dhe të këtyre njerëzve. Ai, po ashtu, premtoi dyer për çdo shtëpi tjetër që do të ndërtohet në këtë lagje. Le të jetë ky një shembull për të gjithë ata që kanë mundësi në forma të ndryshme të përkrahin qytetarët e Mitrovicës, të cilët për dhjetë vite në "paqe" bartën mbi kurrizin e tyre çështjen e tërë Kosovës.

një rast i lëndimit të një protestuesi nga gazi lotsjellës. Ndërkohë u janë shkakuar dëme materiale dy veturave të forcave policore të EULEX-it, si pasojë e sulmit me gurë nga një grup personash të panjohur, derisa ishin të parkuara në një nga rrugët e kësaj lagjeje. Në një lokalitet tjetër në këtë pjesë të qytetit është sulmuar me koktej mollotovi dhe gurë një veturë tjetër e komponentës policore të EULEX-it. Sidoqoftë, zëdhënësi i misionit të EULEX-it në Mitrovicë, Hans Cristian Clasing, në një deklaratë dhënë mediave, ka thënë se jemi këtu për ta ndihmuar policinë lokale, ndërkaq me incidentet e tilla duhet të merret policia e Kosovës.

Ndërkaq, drejtori i infrastrukturës, Rasim Veseli, thotë se për procesin e rindërtimit kemi përkrahjen e organeve të sigurisë, atyre vendore dhe ndërkombëtare dhe kushdo që kërcënon duhet ta dijë se do të përballet me ligjin, se rendi dhe ligji duhet të vlejë edhe në këtë pjesë të qytetit.

Përkundër protestave të serbëve, që konsiderohen të jenë banorë të kësaj lagje, por që në mesin e tyre ndonjëherë janë vërejtur edhe anëtarë të organizatës së ashtuquajtur "rojet e urës", punëtorët me përjashtim të ditëve të diela që e kanë ditë pushimi, asnjëherë nuk i kanë ndërprerë punimet, as ditën kur plumbat e protestuesve serb kalonin mbi kokat e tyre.

Shtëpitë e para tashmë janë ngritur

"në këmbë" dhe sipas zyrtarëve komunalë brenda pesë javëve janë paraparë të përfundojnë.

Rama: Këtu, para luftime, kanë jetuar 127 familje shqiptare

Ahmet Rama, përfaqësuesi i lagjes, rikujton se këtu, para luftime, kanë jetuar 127 familje shqiptare me 812 anëtarë, si dhe kanë qenë edhe 27 troje të shqiptarëve, prona të cilat nuk u kursyen nga demolimet dhe shkatërrimet. Pas përfundimit të luftës, gjatë vitit 1999, me ndihmën e UN-HCR-së dhe KFOR-it, 12 familje shqiptare u kthyen në lagjen e tyre dhe filluan jetën nën tenda, e cila ju zgjati vetëm tri ditë.

Ai thotë se në prani të forcave paqeruajtëse të KFOR-it, serbët i sulmuan këto familje duke plagosur katër veta me armë zjarri, ndërkaq gjashtë të tjerë me armë të ftohta. "Ne ishim duarthatë sepse nuk kishim ardhur të luftonim me askënd, kështu që u detyruam të kthehemi në pjesën jugore të qytetit" - thotë Rama. Sipas tij, nga ajo kohë deri më tani kur ka filluar rindërtimi i shtëpive, në këtë lagje nuk ka shkelur këmbë shqiptari sepse nuk u është lejuar nga ndërkombëtarët, ndonëse iniciativa e banorëve për kthimin në pronat e tyre nuk ka munguar. "Ne gjithëherë kemi qenë në biseda me ndërkombëtarët, duke kërkuar që të na lejohet kthimi në pronat tona, por bisedat tona deri më tani nuk kanë qenë të suksesshme. Para një viti kemi biseduar edhe me serbët e lagjes, me ndërmjetësimin e UNMIK-ut, duke u munduar që të gjejmë një kompromis me ta, por një gjë e tillë ka qenë e pamundur, sepse ata çdoherë gje-

jnë ndonjë arsye, jo s'janë ftohur ende gjakrat, jo ai që duhet të japë vendim nuk është këtu, e tjera" - tregon ndër të tjera Rama.

Shumica e këtyre familjeve, gjatë këtyre dhjetë viteve, kanë jetuar në kushte minimale për jetë, nëpër strehimore kolektive dhe bodrume, ndërkaq një pjesë e tyre kanë paguar qira të majme.

Ata duan dhe shpresojnë që ky fillim i punëve të jetë i mbarë, duke thënë se kjo është meritë e institucioneve shtetërore, atyre komunale, dhe gatishmërisë së EULEX-it, KFOR-it dhe policisë së Kosovës për të ofruar siguri të plotë.

Burim Mehmeti pasi ka hedhur një lopatë beton në themelin e pronës së tij është shprehur tepër i gëzuar që më në fund do ta rindërtojë shtëpinë e re, duke thënë se posa ta përfundojë do të kthehet të jetojë aty ku ka lindur.

Ndërkaq, drejtori për shërbime publike dhe infrastrukturë në komunën e Mitrovicës, Rasim Veseli, vënie e gurthemelit të shtëpisë së parë e ka vlerësuar si një ngjarje të jashtëzakonshme që shënon fillimin e rindërtimit në këtë lagje.

Në anën tjetër, përfaqësuesi i lagjes, Ahmet Rama, një ditë pas vënies së gurthemelit të shtëpisë së familjes Mehmeti, është shprehur shumë i emocionuar, njëkohësisht edhe me brenga. "Jam me brenga kur mendoj se para 10 viteve në këto oborre kanë luajtur fëmijët tanë, të cilët u rritën jashtë shtëpive të tyre. Po ashtu, më brengos fakti se disa kryefamiljarë, që mezi prisnin të ktheheshin në pronat e tyre, nuk janë më në mesin tonë" - shprehet ai.





Shifra alarmante të vetëvrasjeve në Kosovë

Që nga janari i vitit 2009 e deri më sot kanë ndodhur mbi 20 vetëvrasje dhe 75 tentim vetëvrasje. Raporti që ka paraqitur policia përbëhet nga shifra alarmante të vetëvrasjeve.

Fatos SHALA

Nga viti 2000 e deri tani, afër 500 qytetarë të Kosovës i kanë dhënë fund jetës duke u vetëvrasur, ndërsa qindra të tjerë kanë tentuar të vetëvriten në mënyra të ndryshme. Që nga janari i vitit 2009 e deri më sot kanë ndodhur mbi 20 vetëvrasje dhe 75 tentim vetëvrasje. Raporti që ka paraqitur policia përbëhet nga shifra alarmante të vetëvrasjeve. Prej vitit 2000 deri në vitin 2008 numri i vetëvrasjeve të raportuara nga viti në vit nuk ndryshon shumë. Për dallim nga vetëvrasjet numri i tentim vetëvrasjeve prej vitit 2000 deri në vitin 2008 ka shënuar në vazhdimësi rritje tepër të ndjeshme, për të shënuar numrin rekord gjatë vitit 2008 me gjithsej 247 tentim vetëvrasje.

Prin rajoni i Prizrenit

Arbër Beka, zyrtar për informim në Policinë e Kosovës, ka thënë se krahasuar me vitin 2007, gjatë vitit 2008 vërehet një rënie e numrit të vetëvrasjeve për 6 raste ose 11 për qind më pak dhe një rritje e tentim vetëvrasjeve për 26 raste ose 12 për qind më shumë. Sipas tij, në vitin 2008 kanë ndodhur 51 vetëvrasje dhe 247 tentim vetëvrasje, ndërsa një vit më herët patën ndodhur 57 vetëvrasje dhe 219 tentim vetëvrasje.

“Gjatë vitit 2008 në rajonet Prishtinë dhe Mitrovicë është rritur numri i vetëvrasjeve, kurse në rajonet e tjera ky numër ka rënë. Ndërsa, në përgjithësi, numri i tentativave është më i madh ku

veçohet rajoni i Prizrenit me 18 raste më shumë se sa vitin 2007” - ka shtuar Beka.

Ai, po ashtu, ka thënë se vitet e fundit janë shtuar vetëvrasjet më tepër në vendet rurale se sa në ato urbane, ndërsa tentim vetëvrasjet janë në numër më të madh në zonat urbane sesa në ato rurale.

Meshkujt më të predispozuar për vetëvrasje

Pjesëtarët e gjinisë mashkullore kanë kryer disa herë më shumë vetëvrasje se sa pjesëtarët e gjinisë femërore. Ndërsa e kundërta e kësaj paraqitet te rastet e tentim vetëvrasjeve. Femrat në të shumtën e rasteve dështojnë te aktet e tilla, duke përdorur medikamente e preparate kimike.

Krahasuar me vitin 2007 gjatë vitit 2008 vërehet një rënie e numrit të vetëvrasjeve tek pjesëtarët e nacionalitetit shqiptar për 11 raste më pak, ndërsa numri i vetëvrasjeve është më i madh për 2 raste tek nacionaliteti serb. Ndryshe nga kjo paraqitet numri i tentim vetëvrasjeve ku te pjesëtarët e nacionalitetit shqiptar është rritur ky numër gjatë vitit 2008 krahasuar me vitin 2007 për 24 raste më shumë, ndërsa tek pjesëtarët e nacionalitetit serb është zvogëluar për 4 raste. Sipas statistikave të policisë, personat prej moshës 21-30 vjeçare kanë kryer me së shumti vetëvrasje dhe tentim vetëvrasje.

Uka: Është detyrë e shoqërisë t'i ndihmojë këto raste

Sipas psikologut Fitim Uka, vetëvrasja dhe tentim vetëvrasja nga të rinjtë dhe

adoleshentët në shoqërinë tonë është padyshim një problem me bazë psiko-sociale. “E tëra inicohet nga realiteti i hidhur që po jetojmë, nga pamundësia për t'u përshtatur e për të ballafaquar sfidat që ofron jeta. Dhe njerëzit që kanë personalitet të dobët dhe kanë karakter labil janë në gjendje t'i nënshtrohen çdo alternative që shmang ballafaqimin me realitetin, përfshirë këtu edhe vetëvrasjet” - ka thënë Uka.

Ai më tej ka shtuar se, zakonisht, përpara vendimit absurd për vetëvrasje apo tentim vetëvrasje, adoleshenti apo i riu kalon nëpër një fazë depresioni, përgjatë së cilës çdo gjë i duket e errët dhe e zymtë. Ai nuk sheh zgjidhje, andaj është detyrë dhe përgjegjësi morale e shoqërisë që t'u ndihmojë këtyre të rinjve dhe adoleshentëve, që të paktën t'u drejtohen qendrave të rehabilitimit.

Litari - mjete më të përdorur nga vetëvrasësit

“Gjatë vitit 2007, vetëvrasjet në numër më të madh janë kryer gjatë muajve janar dhe korrik dhe tentim vetëvrasjet gjatë muajit gusht, ndërsa gjatë vitit 2008 vetëvrasjet në numër më të madh janë kryer gjatë muajve qershor dhe tetor dhe tentim vetëvrasjet gjatë muajve korrik dhe gusht” - ka deklaruar Arber Beka, duke shtuar se metodat dhe mjetet të përdorura më së shumti për të kryer vetëvrasje janë varje në litar dhe përdorimi i armëve të zjarrit, ndërsa të rastet e tentim vetëvrasjeve janë përdorur medikamente mjekësore. ■

Drejtësia në Kosovë e mbarsur



Sabri HALILI

Gjendja në drejtësinë e Kosovës, një kohë të gjatë, ishte e mbarsur me shumë elemente anakronike të së kaluarës, edhe politike edhe ideologjike, por edhe me nuanca të mungesës së etikës, e shtresuar me mentalitetin e sistemit të njëmendësisë. Në të kaluarën jo shumë të largët, drejtësia kalkulohej dhe bëhej duke zbatuar vendime dhe urdhra politike, të gatuar në kancelaritë pushtetmbajtëse - politike. Shumë profesionistë në gjyqësor, ishin vetëm zbatues të devotshëm të politikave ditore të këtyre kancelarive. Aktualisht, shumë gjyqtarë dhe prokurorë të po atij sistemi, ende punojnë në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës. Është e qartë se disa prej tyre nuk kanë ndryshuar shumë nga mentaliteti i së kaluarës, edhe pse po bëhen 10 vjet të çlirimit nga prangat e një sistemi tashmë të dështuar. E mira e vetme e sistemit të kaluar ishte përkujdesja bukur e madhe për gjyqtarët dhe prokurorët, që ata të mos ndiheshin të pasigurt në punën e tyre, të mos ndiheshin inferior në asnjë segment të shoqërisë, as sa i përket pagave e shpërblimeve për punën e tyre, e as sa i përket statusit të përgjithshëm të tyre. Për pjesën më të madhe të qytetarëve të Kosovës, sistemi i kaluar gjyqësor ka lënë varrë të shumta që duhen harruar sa më parë.

Kur "nis drejtësia" në Kosovë

Çfarë ishte në Kosovën e pasluftës dhe si pasqyrohet situata aktuale në sistemin e drejtësisë, në atë gjyqësor dhe prokurorial në Kosovën e pavarur? Me çka po ballafaqohet drejtësia pas dhjetë vjetësh nga instalimi i një fryme të re, në trend me shoqëritë demokratike, me prezencën e fuqishme të shteteve me demokraci evropiane e botërore?

Kjo gjendje, aktualisht mund të pasqyrohet me pak fjalë: e rëndë, me tensione të brendshme, me rritje të mosbesimit... Në shikim të parë një gjendje pa rrugëdalje

dhe shumë shqetësuese. Arsyet për këtë gjendje janë të shumta, por arsyeja parësore na del se shoqëria, pushteti, gjegjësisht dy pushtetet në Kosovë (ndërkombëtar dhe ai vendor), gjatë kohës së pasluftës, gjegjësisht, gjatë periudhës tranzitore, por as sot kur jemi të pavarur, nuk i kushtuan dhe nuk i kushtojnë vëmendje aq të sinqertë dhe profesionale këtij segmenti të rëndësishëm shoqëror.

Është interesant të theksohet se kohë më parë, në një gazetë ditore, ishte një titull, "Nis drejtësia..."?! Për secilin njeri, e mos të flasim për profesionistët, do të dukej sa absurd, aq edhe shqetësues ky titull! Është një lajm për fillimin e rifunksionalizimit të gjykatave në veri të Mitrovicës. Pas dhjetë vjet çlirimi dhe pas dhjetë vjet qeverisje, edhe vendore edhe ndërkombëtare të Kosovës, kjo është për keqardhje!

Arsyet për mosfunksionimin e drejtësisë në atë pjesë të Kosovës, thonë se janë pakënaqësitë e serbëve për statusin e Kosovës. Edhe ky është një nonsense sui generis, në një shtet që synon ndërtimin e rendit demokratik dhe shtetin ligjor!

Pra, nëse tashti qenka arsyeja e statusit të Kosovës për kundërshtimin e drejtësisë në veri, cilat kanë qenë arsyet e mosfunksionimit të drejtësisë në të kaluarën, kur Kosova nuk ishte e pavarur?! Edhe 9 vjetet e kaluara në atë pjesë të Kosovës, nën menaxhimin e pushtetit unimikian, gjegjësisht të shoqërive demokratike ndërkombëtare, ndodhën krime ndaj qytetarëve, krime ndaj rendit dhe sigurisë, madje edhe sulme të rënda ndaj forcave të KFOR-it. Edhe BE-ja është "tëpër e shqetësuar për kontrabandën më të madhe në Evropë". Megjithatë, për këtë nuk dihet të jetë dënues deri sot ndonjë grup, apo individ, si bartës i këtyre krimeve.

Përgjigjja është e thjeshtë për ata që dëshirojnë ta shohin problemin me dioptri reale. Segmentet e caktuara politike dhe grupet e organizuara kriminale të kësaj pjese të Kosovës, në bashkëpunim me grupe jashtë kësaj zone, nuk dëshirojnë të ketë drejtësi.

Kjo gjendje e drejtësisë dhe qasja e diferencuar, varësisht nga nacionaliteti, për shqiptarët është e njohur vetëm në kohën e qeverisjes serbe në Kosovë. Edhe atëherë, serbët bënin ligje e gjyqe kudo

dhe kurdo, por vetëm për shqiptarët. Kjo ndoshta është arsyeja kryesore pse grupet e caktuara kriminale pengojnë drejtësinë dhe shtrirjen e rendit dhe ligjit në gjithë Kosovën. Ata dëshirojnë një terren me një anarki të plotë, me ligje e gjyqe që i bëjnë vet, apo që ua sjellin të gatuar nga Beogradi. Me një fjalë, ata janë instrument manipulues i kësaj politike të Beogradit, apo dorë e zgjatur e saj.

Sipas mendimit të shumë profesionistëve vendorë, kjo gjendje në drejtësinë kosovare ka qenë e ngjashme duke nisur nga fillimi i viteve nëntëdhjetë, ka vazhduar në periudhën unimikiane, por askush nuk dëshiron të mendojë që kjo të vazhdojë edhe në periudhën "këshilluese" të EULEX-it. Të gjithë mbajnë mend se në sistemin gjyqësor millosheviçian, derisa shqiptari ka mundur të dënohet me burg deri në 5 vjet, për të njëjtën vepër, ndaj serbit, as që është filluar procedura. Kjo praktikë, në variantin më të zbutur, ka vazhduar edhe në periudhën e pushtetit të UNMIK-ut dhe kemi me dhjetëra shembuj të qasjeve të këtilla ambivalente. Kjo ka bërë që serbët edhe sot e kësaj dite ta kundërshtojnë drejtësinë në Kosovë.

Si mund të arrihet qëllimi i drejtësisë

Të gjithë e kanë pasur të qartë se faza tranzitore do të jetë një proces i rëndë, i përcjellë me vështirësi të shumta. Por, askush nuk ka menduar se kjo do të zgjaste aq shumë. Madje, edhe po të kishte menduar dikush për këtë kohëzgjatje, është menduar se me kalimin e kohës, krahas ndryshimeve humane profesionale, të bëhen edhe ndryshime pozitive në infrastrukturën e përgjithshme, si në përmirësimin e kushteve të punës dhe të jetës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Megjithatë, kjo nuk ka ndodhur dhe gjendja është çfarë është, ndërsa ende nuk duket asnjë dritë shprese për përmirësim të shpejta. Ata që janë përgjegjës për t'i bërë këto ndryshime, nuk investojnë sa duhet për një ardhmëri më të shëndoshë të drejtësisë.

Reformat që po paralajmërohen nuk do të kenë sukses, pa krijimin e të gjitha kushteve, së paku, fillimin e krijimit të kushteve që do ta nxirrnin këtë sektor të shoqërisë nga gjendja e rëndë që ndodhet

r me refleksione të së kaluarës

aktualisht. Së paku të inkurajohen dhe motivohen, qoftë vetëm me një veprim konkret, gjyqtarët dhe prokurorët. Kjo do të ishte jepte një shpresë për opinionin dhe një motiv për gjyqtarët dhe prokurorët, për të punuar dhe për të dhënë çdo gjë nga vetja në profesionin e tyre, që është sa i vështirë aq i rëndësishëm, për çdo shoqëri dhe shtet ligjor. Suksesi në këtë segment do të jetë i matshëm edhe me krijimin e vetëdijes, edhe politike edhe shoqërore e shtet-formuese, gjegjësisht institucionale, me ndërgjegjësimin institucional, për rëndësinë e këtij segmenti shoqëror, si më i rëndësishmi dhe i vetmi, për luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe dukurive të tjera të shëmtuara, që një shoqëri e pasqyrojnë si të paorganizuar dhe të degjeneruar.

Kjo do të bëhet vetëm me ligjet adekuate me të cilët gjyqtarët dhe prokurorët dhe puna profesionale e tyre do të trajtoheshin ashtu siç e meriton, ashtu siç trajtohen në të gjitha shoqëritë demokratike dhe në shtetet e njëmendta ligjore dhe me krijimin e kushteve në infrastrukturë, sidomos asaj teknike, pajisje adekuate për seanca të pandikuara gjyqësore.

Për ndryshimin e kësaj gjendje, duhet të ndërtohen objekte adekuate, që përkohë me një gjyqësor të mirëfilltë. Objektet e gjyqësorit aktualisht janë të vjetruara, jashtë kohës, madje edhe arkitektura e tyre është që nga sistemi monist. Dhe nëse kemi parasysh edhe kushtet e përgjithshme, të apostrofuara më lart dhe dukuritë korruptive që e kanë kapluar drejtësinë dhe segmentet e tjera në Kosovë, atëherë para institucioneve relevante shtetërore, tashmë do të duhej të ishte ndezur sinjali i kuq. Përkundër kësaj, ende nuk shihet një brengë aq e sinqertë e tyre. Ndoshta dikujt nga pushtetarët, të të gjitha ngjyrave, kjo gjendje do t'u leverdiste, ngase me këto kushte gjyqësori do të mund të ishte i varur, jo vetëm në aspektin financiar, por edhe në aspekte të tjera. Në secilën shoqëri demokratike, gjyqtarët dhe prokurorët janë të pavarur dhe të pandikuar në punën e tyre.

Edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli VII, neni 102, gjyqësorin e përcakton si: unik, i drejtë, apolitik dhe i pavarur...Mirëpo, për shkak të kushteve dhe rrethanave në

të cilat punojnë e veprojnë aktualisht gjyqtarët dhe prokurorët, këto dispozita kushtetuese nuk respektohen në masë të duhur, e në këtë kontekst kjo ndikon edhe në punën e gjyqësisë dhe prokurorisë. Për këtë mangësi në implementim ka arsyetime të ndryshme, madje shumë joprofesionale dhe banale, si: Mungesa e infrastrukturës adekuate ligjore. Pas këtij arsytimi shtrohet pyetja e domosdoshme: Cila është detyra e parlamentit, nëse nuk nxjerr ligjet më të rëndësishme që i duhen një shoqërie? Arsytimi tjetër thotë se, implementimi i disa ligjeve (edhe pse janë aprovuar në parlament) kërkon mjete financiare, të cilat i mungojnë buxhetit të konsoliduar! Por çfarë është ai projektligj, i cili nuk i parasheh të gjitha këto implikime financiare paraprakisht. Dhe, në momentin kur miratohen ligjet, opinionin konsideron se janë planifikuar të gjitha rreziqet dhe pasojat e implementimit të ligjit në fjalë dhe, në këtë rrafsh, gjyqësori do të përballet me zbatimin e dispozitave të ligjeve të miratuara, e në fakt asnjëherë nuk varet çdo gjë nga gjyqësori.

Ka arsyetime që bazohen në dukurinë e dualizmit të zbatimit të ligjeve, gjegjësisht pushteteve në Kosovë. Ky dualizëm në drejtësi krijon segregacione të llojit të vet dhe në rastin më ekstrem edhe krijon privilegje për një pjesë të shoqërisë, në njërin anë dhe diskriminime në anën tjetër. Megjithatë këto arsye, gjegjësisht pengesa, duhet të pasqyrohen edhe në opinion, e jo të humbet besimi në tërësi të drejtësisë, pa fajin e profesionistëve vendorë për këtë gjendje, nëse vërtet është ashtu.

Perceptime të ndryshme nga këndvështrimet të ndryshme

Nga gjithë kjo që u shtrua më lart, shihet qartë se në Kosovë kemi dy aspekte të perceptimit për gjyqësorin e Kosovës. Derisa njëra anë është krejtësisht e ngarkuar me politikën ditore, të imponuar nga qarqe të ndryshme politiko-partiake, perceptimi i dytë ka të bëjë me humbjen e besimit ndaj gjyqësorit, për shkaqe të shumta, të elaboruara më lart.

Aspekti i parë ndërlihet me perceptimin e përgjithshëm të politikës së Beogradit, me çdo gjë në Kosovën e

pavarur. Këtu bëhet kalkulimi politik i Beogradit, qoftë edhe me serbin e fundit, për të penguar zhvillimet e përgjithshme, sidomos në fushën e sundimit të ligjit në përgjithësi, si alibi politike për paaftësinë e Kosovës për të menaxhuar gjendjen e sigurisë dhe të sundimit të ligjit.

Aspekti i dytë ka të bëjë me humbjen e besimit, për shkak të vazhdimësisë së një sistemi nga i cili ky popull nuk e ka realizuar asnjë të drejtë në të kaluarën, të një sistemi drejtësie që në çdo veprim dhe në çdo vendim të tij, ka prodhuar elemente diskriminuese dhe ka shkelur të drejtat elementare të njeriut. Është normale që pritjet e opinionit për ndryshime rrënjësore kanë qenë të mëdha. Megjithatë, ndryshimet kanë shkuar shumë ngadalë, madje në disa raste duket se asgjë nuk ka ndryshuar nga sistemi i kaluar.

Për ndryshimin e këtyre perceptimeve, duhet ecur në dy drejtime: Duke qenë të vendosur për vënien e rendit dhe ligjit në të gjitha hapësirat e Kosovës dhe njësoj për secilin qytetar në njërin anë, ndërsa në anën tjetër, duke krijuar besim në opinion me punë të pavarur, efektive, profesionale dhe të paanshme. Secili gjyqtar dhe prokuror, të vetmin këshilltar duhet ta ketë ligjin dhe Kushtetutën e Kosovës, duke ndryshuar rrënjësisht mentalitetin e qasjes dhe veprimit ndaj palëve, ndaj detyrës, ndaj profesionit, e sidomos në raport me ligjin.

Është e qartë se secili gjyqtar dhe prokuror, duhet të sillet dhe të veprojë edhe në bazë të ligjit në fuqi, por edhe sipas Kodit të Etikës Gjyqësore dhe Prokuroriale. Në bazë të këtij kodi, këta profesionistë, në punën e tyre duhet të veprojnë gjithmonë duke krijuar dhe prodhuar besim tek publiku, duke pasqyruar dinjitet, integritet, profesionalizëm dhe pavarësi. Gjyqtari dhe prokurori duhet të pasqyrojnë standarde të larta të sjelljes personale e profesionale, të respektojnë dhe të zbatojnë ligjin, të shmangin çdo sjellje apo situatë që do të sillte në pikëpyetje integritetin dhe paanshmërinë apo pavarësinë e tyre, të respektojnë në çdo moment të drejtat e njeriut, konform standardeve ndërkombëtare, për të gjitha palët në procedurë. Këto janë disa parime të përgjithshme të etikës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, që në praktikën e gjyqësisë kosovare mungojnë. ■

Pret një muaj dhe i shpenzon për një orë



Mevlude ZEJNULLAHU

6 7 vjeçari Ymer Sadriu ishte zgjuar më herët se zakonisht që ta zinte radhën në bankë për ta marrë pensionin. Derisa priste në radhë, bënte llogari se çfarë të blinte më parë me ato pak të holla...

Në barnatoren më të afërt, ai bleu 25 euro ilaçe, të cilat i përdor plot 14 vite, pasi që vuan nga një sëmundje e zemrës. Ai thekson se ka disa ditë që i janë harxhuar ilaçet, mirëpo nuk kishte të holla t'i blinte, prandaj kishte pritur që ta merrte pensionin. "Djali i vetëm që kam është i papunë. Punon rrallë ndonjëherë punë krahu. Fëmijët i ka ende të vegjël dhe nuk kemi të ardhura të tjera, po jetojmë si mundemi" - tregon xha Ymeri.

Duke ecur rrugës ai u ndal te një rrobaqepës për t'ia paguar borxhin prej 5 eurosh që i kishte ngelur në fillim të dimrit, kur ai ia kishte rregulluar pallton... Afër tregut të gjelbër në Prishtinë, ai bleu 10 pako cigare për 8 euro. "E di, e di që është i dëmshëm, por nuk mund të rri pa të. E pi plot 50 vite" - tha ai, kur vuri re se po e shikonim me habi. "Trupi kur mësohet me helm nuk bon me ja ndalu se nuk mundet t'i përballojë" - vazhdoi pensionisti.

Stacioni i tij i radhës është dyqani i vogël në hyrje të lagjes. Ditës së pensionit i gëzohen edhe të vegjlit. Xha Ymeri e di se në shtëpi e presin me padurim mbesat dhe nipërit, andaj duhej t'iu blinte "racionin" e tyre të ëmbël. Çokollatat dhe disa artikuj të tjerë ushqimorë i "shkëputën" edhe 5 euro tjera nga pensioni.

Në një rën dorë mbante qesen me gjësende, kurse në dorën tjetër shtrëngonte 2 eurot e fundit që i mbetën nga pensioni që mori para 1 ore. "Çka me ba, kështu qenka kjo jetë, fukarallaku po na zë frymën, kam frikë se as për nipat e mi nuk do të bëhet mirë se unë në këtë jetë

jam sot për nesër" - shprehet xha Ymeri, duke shtuar se me ato 2 eurot e mbetura do të shkojë për vizitë te motra e tij, në një fshat të Besianës.

Pension apo lëmshë?

Arritja e moshës së pleqërisë në Kosovë karakterizohet me rënien drastike të të ardhurave personale. Pensioni bazë prej 45 eurosh dhe ai i punës prej 80 eurosh, që i paguhet secilit qytetar të moshës mbi 65 vjeç, nuk mund t'i sigurojë individit as minimumin e ekzistencës individuale. Kështu që përkujdesjen sociale ndaj pleqve e merr përsipër familja, në të shumtën e rasteve fëmijët.



Se sa mjaftojnë 45 euro për një person të rritur (në këtë rast të moshuar dhe me shumë nevoja si ekonomike e shëndetësore) tregon rasti i Ymer Sadriut, e që fatkeqësisht ka shumë e shumë të tillë, të cilët me ato të ardhura nuk mundin t'i plotësojnë as nevojat minimale të jetesës.

Sistemi pensional në Kosovë është përcaktuar përmes rregullores 2001/35 të 22 dhjetorit 2001. Sipas kësaj rregulloreje, në Kosovë ekzistojnë dy lloj sigurimesh pensionale: pensioni bazë paushall dhe pensioni sipas kursimeve personale.

Pensionin bazë është pensioni të cilin e paguan administrata pensionale për secilin qytetar, i cili ka arritur moshën mbi 65 vjeç. Pensioni sipas kursimeve

individuale është pensioni të cilin e paguan Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës për personat që kanë paguar gjatë kohës që ishin në punë, kur ta arrijnë moshën 65 vjeçare.

Pensionin paushall bazë - është një skemë paushalle, e cila paguhet nga Qeveria e Kosovës. Është përcaktuar një shumë për secilin qytetar të moshës mbi 65 vjeç, pavarësisht nga e kaluara e tij në tregun e punës. Jeta personale dhe biografia e punës nuk luajnë këtu kurrfarë roli. Lartësia e pensionit përcaktohet rishtas çdo vit. Në vitin 2003 ishte lartësia mujore 35 euro, në vitet 2004/2005 është rritur në 40 euro, kurse tani është 45 euro.

Për të administruar pensionin në Kosovë është formuar Administrata Pensionale e Kosovës. Administrata e udhëheq dhe e administron pagesën e pensionit bazë për qytetarët, të cilët e kanë arritur moshën 65 vjeç. Autoriteti Qendror Fiskal i transferon të hollat në Administratën Pensionale, pas një aprovimi të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Lartësia e pensionit bazë aprovohet nga Kuvendi i Kosovës.

Në moshën e pleqërisë rreziqet shëndetësore shtohen dhe pasojat për gjendjen sociale të individit ndikohen nga gjendja e tij fizike. Kështu siguria sociale në pleqëri në shoqërinë e Kosovës nuk varet shumë nga profesioni i mëparshëm.

Shoqëria në Kosovë karakterizohet nga pabarazia në të ardhura, nga dallimet regjionale, etnike, gjinore dhe nga dallimet mes gjeneratave. E diçka që është shumë e evidente dhe që në një farë mënyre ka sjellë edhe këtë gjendje të mjerueshme janë edhe dallimet mes të "fortëve" dhe të "dobëtëve". Ata të cilët janë në pozita dhe në institucione vendimmarrëse shumë pak u besojnë hallexinjve të tillë. Ata u "besojnë" para kamerave, veçmas gjatë fushatave parazgjedhore.

Shpresojmë se Kosova do të jetë shtet i mirëqenies sociale e për lloj të këtyre shteti mund të flitet vetëm atëherë kur ai merr përsipër një përkujdesje të gjithanshme ekzistenciale e nuk i "mashton" paraardhësit e vet me 45 euro. ■

Pagëzimi i fëmijëve

Emrat më të preferuar Altin dhe Erza

Që nga janari i vitit 2007, ofiqaria është vendosur brenda QKUK-së. Para se ta marrin foshnjën në shtëpi, prindërit janë të obliguar që ta regjistrojnë. Kjo ua ka lehtësuar mjaft punën prindërve, sepse më herët është dashur të bredhin poshtë e lart në administratën komunale për t'i regjistruar fëmijët.



Florentina LATA

Korridoret e repartit të gjinekologjisë ishin të mbushura plot emocione nga prindërit dhe familjarët të cilët prisnin me padurim ardhjen në jetë të anëtarit të ri. Në mesin e tyre mund të vërehej lehtë fytyra e Fatmir Gashit, i cili me shume emocion priste të bëhej baba. "Shyqyr që Zoti ma mundësoi të bëhem baba. Gëzohem shumë sidomos që kam djalë, pasi që kam pasur gjithmonë dëshirë që fëmijën e parë ta kem të gjinisë mashkullorë". Ai tha se edhe më herët e ka ditur se bashkëshortja e tij do të lindë djalë, mirëpo deri në ato momente nuk arrinte ta besonte.

Ndërsa e shoqja, Leonita Gashi, kishte harruar të gjitha vështirësitë e lindjes në momentin kur kishte mbajtur në duar fëmijën e saj të parë. "Në momentin kur mjeku ma ka vendosur fëmijën në gjoks, unë nga gëzimi kam filluar të qaj dhe nga ai moment e kam ndier veten nënë". Edhe pse Leonita është vetëm 23 vjeçare, ajo mendon se është e gatshme të jetë nënë e mirë për ta rritur dhe edukuar fëmijën e saj.

Krenar për djalin e tyre, dy prindërit kërkojnë emrin më të bukur për fëmijën e tyre të parë.

Dilemat se a duhet fëmija të mbajë emër tradicional apo mod-

ern është një problem që i preokupon prindërit dhe, si pasojë, fëmijët mbesin pa emër një kohë të gjatë.

"Për emër kemi pasur shumë propozime si Leart, Enis, Leon, Albert, etj., kryesisht emra me domethënie historike kombëtare apo fetare, por edhe prej atyre modern si Erion, Nil, Flon etj., thotë Fatmir Gashi. Ndërsa e ëma Leonita, e cila një kohë nuk dinte si ta thërriste të birin e saj, mendon se emri më i përshtatshëm për djalin e saj është Flon. "Vazhdimisht kemi kërkuar një emër të bukur dhe për këtë arsye ka mbetur pa emër një kohë, po tani kemi vendos ta emërojmë Flon. Është propozim i axhës së burrit, i cili këtë emër e ka marrë nga interneti dhe, sipas tij, ky është një emër ilir".

Ofiqaria brenda QKUK-së

Që nga janari i vitit 2007, ofiqaria është vendosur brenda QKUK-së. Para se ta marrin foshnjën në shtëpi, prindërit janë të obliguar që ta regjistrojnë. Kjo ua ka lehtësuar mjaft punën prindërve, sepse më herët është dashur të bredhin poshtë e lart në administratën komunale për t'i regjistruar fëmijët.

"Fëmijën tashmë e kemi regjistruar në librin e ofiqarisë dhe mendoj se kjo është një mundësi e mirë, sepse u shmangemi korridoreve të komunës dhe pritjeve të gjata".

Mesatarisht 34 mijë lindje në vit

Gjatë vitit 2007, në Kosovë, janë regjistruar 33.312 lindje të gjalla dhe

Rënie e theksuar e lindjeve në Kosovë

Sipas Entit të Statistikave të Kosovës (ESK), lindjet në Kosovë kanë pasur rritje deri në vitet '90-të, ndërsa nga vitet '90-të e këtej ka një rënie të theksuar të lindjeve. Sipas burimeve dhe analizave të ndryshme nga ESK dhe institucionet e tjera, lindjet në Kosovë nuk raportohen të gjitha me kohë. Disa raste raportohen pas një kohe të gjatë (pas disa viteve), gjë që bën që ato të mos përfshihen në bazën e të dhënave nga ESK dhe të mos publikohen me kohë. Mos raportimi i lindjeve në kohë në Kosovë sillt rreth 10-15 për qind (duke përfshirë edhe mos raportimin e komuniteteve të ndryshme). Në Kosovë, mesatarja vjetore për periudhën 2002-2007 ka qenë 34.618 lindje.

280 lindje të vdekura. Prej gjithsej të lindurve gjallë, 17.514 apo 52.4 për qind ishin meshkuj, ndërsa 15.878 apo 47.6 ishin femra. Koeficienti i maskulinitetit ishte 110.7, ndërsa koeficienti i vitalitetit ishte 5.0.

Rreth 93.7 për qind e lindjeve kanë ndodhur në institucione shëndetësore, ndërsa 6.3 për qind kanë ndodhur në vend tjetër. Komuna e Prishtinës zë vendin e parë me 3.483 lindje, apo 10.4 për qind, pastaj vjen Prizreni me 3.163 lindje apo 9.5 për qind, Ferizaj me 2.084 apo 6.2 për qind e kështu me radhë... 31.5 për qind e foshnjave të lindura në institucione shëndetësore, kishin peshë 3.000 deri 3.499 gram. 428 nëna lindën fëmijë binjakë dhe 18 nëna lindën fëmijë trinjakë...

Emrat më të shpeshtë të djemtë ishin: Altin (106), Erion (105), Leon (96), Leart (91), Ermal (91), ndërsa te vajzat: Erza (177), Elsa (123), Rinesa (120), Agnesa (111), Elona (91). ■



Çka është rugovizmi dhe



Dr. Fadil MALOKU

Kohëve të fundit sërish është riaktualizuar çështja e monopolit të trashëgimisë rugoviane, siç po e quajnë dy partitë, kinse trashëgimtare politike LDK-ja dhe LDD-ja, nëpër mediumet publike, sidomos në TV Klan dhe nëpër aulat e tjera mediatike. Ky debat do të kishte kuptimin e vet meritator sikur të ngrihej në nivelin e analizave dhe studimeve akademike të tipit të analizës së përmbajtjes, e sidomos të tipit të metodologjisë analogjike, sikurse bëhet gjithkund në botën e civilizuar. Para detektimit të titullarit rreth kësaj “pronësie”, për mendimin tim është shumë me rëndësi të studiohet çështja e përkufizimit të asaj që monopolistët nga LDK-ja dhe LDD-ja e edhe vetë mediet e shquajnë si “filozofi rugoviane”, “trashëgimi rugoviane”, “filozofi jo violente”, etj., në mënyrë që më pastaj të kalohet tek pronësia dhe monopoli politik...

Ky shkrim ka për qëllim të prekë pak a shumë disa nga këto aspekte të këtij konteksti kohor dhe atij shoqëror, pra si u ambientuan kaq shpejt kosovarët me të, sa ishte i arsyeshëm aplikimi masiv i kësaj ideje te të gjithë qytetarët e Kosovës.

Si lindi “filozofia rugoviane”?

Përkundër shtet - krijesave postkomuniste që iu nënshtruan një imperativi të vetëm, pra atij të animimit të opinionit të brendshëm dhe të jashtëm për ecuritë e proceseve të reja demokratike, shqiptarët e Kosovës, në vitet 90-ta, në fakt u desh t’i nënshtroheshin edhe një synimi tjetër, që te perëndimorët me konfirmimin e Mastroiut kishte filluar të zgjonte kërshërinë e shuarjes apo shkrijes së asaj që te ata identifikohej me shekuj si identitet shtetëror (që ata asnjëherë nuk arritën ta kenë të vetin në asnjë periudhë kohore!) apo kulm i përbashkët identitetesh kombëtare.

Procedimi i tillë dualist i shqiptarëve të Kosovës, shikuar nga këndvështrimi

pragmatik, në esencë ishte një përpjekje e fundit e tyre edhe për t’u identifikuar me rrjedhat dhe trendët aktuale që po ndodhnin pas rënies së Murit të Berlinit, pra komunizmit, por edhe për t’u çliruar nga regjimi kolonialist serb. Meqë, kosovarët aktualisht nuk kishin asnjë shans ta arrinin këtë synim të tyre për çlirim kombëtar dhe për ta bërë strehën e shtetit të tyre, edhe për shkak të raportit të forcave ushtarake, politike, ekonomike, etj, por edhe të një disfavorit tjetër që kishte të bënte me rrethanat e jashtme globale, ku ish Jugosllavia akoma kishte një kredibilitet të pakontestuar, kujtoj që historia do ta dëshmojë se ndërrimi i kursit nga ai historikisht violent, në një kurs të përkohshëm jo violent i lëvizjes rugoviane, në fakt, ishte vetëm një stacion pritjeje historike, pra një periudhë e konsolidimit dhe përgatitjes së asaj që edhe de fakto ndodhi në vitin 1999, kur edhe u pa se lufta e armatosur ishte e paevitueshme në Kosovë.

Duke mos dashur të jem as apologjet e as kundërshtar i këtij diskursi që tash ka filluar të rikeqkuptohet me qëllime apo pa qëllime të caktuara, do të doja që si një dëshmitar i asaj kohe, pra si një sociolog i ri që kishte bërë analiza dhe studime (empirike) të asaj periudhe, të bëj krahasime dhe të gjurmoj të vërtetën e ndërrimit të përnjëhershëm të kursit të sjelljeve të shqiptarëve të Kosovës.

Interesimi ynë do të fokusohet për ngjarjet që kanë të bëjnë me periudhën pas viteve '90- ta, kur kualiteti i synimit shqiptar për ta bërë identitetin e vet, ashtu siç e kishin bërë edhe kombet e tjera të Evropës, u begatua edhe me një formë dhe përmbajtje të re (gjykoj të paelaboruar sa duhet nga ne) të panjohur gjer atëherë për etikën e tyre shekullore të sjelljes: atë të jo dhunës, apo jo violencës siç e quanin perëndimorët, që ishte një befasi e madhe, jo vetëm për shqiptarët e Kosovës dhe ata të Shqipërisë e gjetiu, por edhe për vetë serbët dhe regjimin e Millosheviqit!

Futja dhe implikimi i një strategjie të tillë, tashmë edhe me një aplikativitet masiv të jashtëzakonshëm, sikur e futi çështjen e demokratizimit dhe të

çlirimit nga regjimi serb të shqiptarëve të Kosovës në shtratin e Prokrustit ndërkombëtar, pra të Amerikës dhe të aleatëve të tjerë perëndimorë. Ishte një hap i madh ky! Problemi tashmë ishte si të “arsyetohet” përbrenda hapi për jo violencë dhe qetësi (për mua ishte gjithnjë një indiferencë pasive) masive, ngase ekzistonte rreziku real i shfarosjes nga ana e shtetit serb.

Por, procesi i inicimit të rrënimit të stereotipive tradicionale siç ishin ato: të besës, mikpritjes, trimërisë, pastaj atij të gatishmërisë për t’u flijuar për të mirën e atdheut dhe mirëqenies së kombit dhe konceptit të mos durimit ndaj të huajit, filluan tash të marrin kuptimin e një refuzimi masiv. Dhe ajo që është edhe më interesant në tërë këtë histori të pranimit të përnjëhershëm (pa ndonjë konsensus paraprak masovik, pra pa ndonjë referendum) filloi të harrohet historia e stereotipive “identifikuese”, përmes të cilave shqiptarët gjithandej Ballkanit njiheshin në memorien e popujve! Të orientuar kështu, shqiptarët e Kosovës tani filluan në mënyrë të (pa)vetëdijshme dhe me aplikativitet masiv ta këmbëjnë dogmën e jo dhunës (e cila kuptimin e të menduarit kreativ shqiptar e rrudhi në një kod të vetëm, i cili e funksionalizoi pranimin e durimit si mjet të vetëm të mbijetimit), me stereotipat e mëhershëm (të rebelimit individual) që i kishin kulti-



a ekziston ai si i tillë sot?

vuar gjatë tërë qenësimit të vet shekullor në këto hapësira!

A të sakrifikohej shteti apo demokracia?

Është interesant se kodi i ri, apo sistemi i ri i sjelljeve shqiptare në Kosovë, përveç tendencës së mbijetimit që tashmë ishte bërë tërësisht evident, sepse kërcënohej edhe biologjikisht nga lufta shfarosëse e iniciuar nga serbët, që siç dihet shpërtheu në Slloveni, Kroaci, e sidomos në Bosnjë, filloi dalëngadalë me një takt të sponsoruar kryesisht nga shtrësia e intelektualëve, të dalë si aspirues ekskluziv vetëm i shtetit (por jo edhe i çlirimit definitiv nga regjimi serb), në mënyrë që më vonë të ndërtohet demokracia dhe të ushtrohet relaksimi i raporteve midis shteteve dhe kombeve.

Dalja e proceseve demokratike, në plan të dytë të preokupimit, për shqiptarët e Kosovës pati reperkusione të natyrës së dilemave përcaktuese, ngaqë për elitën udhëheqëse (Ibrahim Rugovën) të kësaj kohe, ishte diskutabile koncepti i trasimit të hapave të mëtejme, që reduktoheshin në dilemat:

a) Se a thua, do të ishte më mirë të viktimizehej ideja e demokratizimit të proceseve dhe raporteve (rrugëtim ky, të cilin vendet e tjera postkomuniste veç e kishin filluar menjëherë pas shembjes së komunizmit) për hir të realizimit të synimit shekullor për shtet, i cili dorën

në zemër nuk shihej askund në horizontin e rrjedhave dhe ngjarjeve,

b) Apo më mirë do të ishte që të viktimizehej ideja madhore e realizimit të këtij synimi për hir të idesë së shtetësisë (kushtimisht ta quajmë funksionale!) embrionale që kishte filluar të ngrihej nën monitorimin e elitës intelektuale (ende jo edhe asaj politike!) të Kosovës, me anën e zgjedhjeve të lira, referendumit, dhe formave të tjera të shprehjes së këtij vullneti?

Ishte i çuditshëm fakti, se megjithëqë nuk pati ndonjë artikullim të dukshëm, do të thoshim promovues përkitazi me këto probleme madhore për kombin, prapëseprapë dilemën e manifestuar kësajsoj ata e materializuan përmes një përcaktimi, do të thoshim aristotelian, duke e orientuar vullnetin e tyre ekskluzivisht në pavarësi si nga Serbia, ashtu edhe nga Shqipëria, me lëvizjen gjer atëherë të panjohur dhe të pastudiuar paqësore të identifikuar me emrin e Ibrahim Rugovës, që sot aparatçikët e LDK-s dhe atyre të LDD-s, po e kualifikojnë si "rugovizëm".

Në këtë kontekst, shqiptarët duke i respektuar rregullat e trendëve perëndimore dhe sistemin e vlerave të tyre, filluan të gjurmojnë mundësin e kaptimit të brengës së tyre kolektive për identitetin e përcaktuar shtetëror të Kosovës, me strategjinë e evolucionit (politikës si art i së mundshmes!) demokratik, që për ta ishte tërësisht një terra incognita!

Pozicionimi i tillë kosovar, u dha kurajë atyre që të shpresojnë në sintagmën e njohur: "se diplomacia dhe politika (si art i së mundshmes) thyejnë shumë tabu, bile edhe atë të mos ndryshimit të kufijve". Mirëpo, ndërkohë shtrohej edhe çështja e dyshimit në kaçikun, e përgjithësisht interesimin e tërësisht shqiptar, për ta bërë realitet tërë këtë prejjudikim e preokupim kolektiv të tyre, me një metodologji të tillë të panjohur dhe të pa konsumuar sa duhet nga asnjë komb në Evropë!

Dyshimi, siç do të vërehet dhjetë vjet më vonë, do të përkujtohet si dyshim i bërë më vend. Ngaqë, vetëm rikthimi i tyre në kodin identifikues të rebelimit dhe stereotipive të tjera tradicionale

shqiptare, do të bënin që problemi i pazgjidhur i Kosovës të marrte kahet e një orientimi të dëshiruar të realizimit të asaj që ne sot jemi duke e gëzuar. Në kontekst të kësaj periudhe, është evidente se i tërë procesi i amputimit të filozofisë së jo violencës në mentalitetin dhe etnopsikologjinë e shqiptarëve të Kosovës ka kaluar nëpër disa faza, apo disa modele, apo etapa emancipuese, modele këto që do të thoshim, në një mënyrë, pasqyrojnë jo vetëm nivelin e emancipimit të gjithëmbarshtëm politik të klasës dhe shoqërisë shqiptare në Kosovë, por edhe të vetë qytetarëve për ta pranuar këtë vlerë të re dhe deri atëherë të papraktuar në jetën e tyre të përditshme.

Të gjendur mes pamundësisë së shfrytëzimit të tëra mjeteve dhe arsenalit të poseduar, ende vetëm në nivel një entuziazmi shpeshherë edhe improvizues (!) dhe papjekurisë së kushteve dhe rrethanave që do shkonin në favor të tezës "makiavelistë", se: duhen përdorur të gjitha mjetet (duke mos e përgjatur as luftën e armatosur, në mënyrë që të bëhet realitet qëllimi shekullor për shtetin e tyre), kosovarët, pas dhjetë "vjetëve të humbura", siç do thoshte z. Kraja, do të fillonin t'i ktheheshin vetvetes dhe ta rishqyrtonin rrugëtimin e tyre maratonik.

Në realitet, përmes një retrospekcioni sociologjik, jemi munduar të cilësonim dhe identifikonim disa nga modelet apo pozicionimet e sjelljes së shoqërisë kosovare gjatë kësaj periudhe kërcënimesh, shantazhesh dhe ndjekjesh të mëdha, të cilën e përmbylli eksodi i vitit 1999. Këto modele pozicionimesh për dioptrinë e një sociologu ishin interesante edhe për faktin se identifikuan disa modele sjelljesh kolektive, siç ishin: ai euforik, dyshues, dhe iluzionist.

Me daljen e UÇK-s në skenën politike, u aktivizua edhe kodi i heshtur për një dekadë të tërë i rebelimit që pasoi me çlirimin definitiv të Kosovës nga kolonializmi dhe dominimi serb. ■

(Autori është doktor i shkencave të sociologjisë, anëtar i Shoqatës së Sociologëve Botërorë)



Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

21 shtete “mbrojnë” pavarësinë e Kos

Demir RESHITI

Republika e Gambias dhe Arabia Saudite janë dy shtete që gjatë muajit prill e kanë njohur Kosovën shtet, duke e çuar në 58 numrin e shteteve që e kanë njohur realitetin e ri të krijuar në Kosovë. Gjatë muajit prill, Kosova ka qenë temë trajtimi në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND), ku 35 vende të botës i kanë dorëzuar kërkesat për pjesëmarrje në procesin lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Prej tyre, 21 janë shprehur pro pavarësisë, kurse 13 kundër. GJND-ja këto deklarata ia ka dorëzuar Ministrisë së Jashtme të Kosovës me kërkesën që pas shqyrtimit, deri më 17 korrik, t'ia kthejë ato. E veçanta tjetër është se gjatë këtij muaji është vërejtur një kërkesë e shteteve më të fuqishme drejtuar Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën dhe njohjen e pasaportave të saj...

Në vazhdim po paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajit prill 2009.

(1 prill) “El Mondo” kritikon kryeministrin Zapatero për shkak të Kosovës

Madrid - Gazeta e njohur spanjolle “El Mondo”, në një koment të sajën, ka kritikuar kryeministrin spanjoll Hose Luis Zapatero për shkak të Kosovës dhe ka kërkuar nga ai t'i ndalë veprimet të cilat e nxjerrin Spanjën qesharake para botës, ashtu siç bëri në rastin e Kosovës.



Jean Francois Terral

(2 prill) Terral: Serbia duhet të normalizojë marrëdhëniet me Kosovën për të hyrë në BE

Beograd - Ambasadori i Francës në

Beograd, Jean – Francois Terral ka thënë se Serbia duhet të gjejë mënyra për normalizimin e raporteve me Kosovën. “Njohja e Kosovës nuk është kusht që Serbia të bëhet anëtare e BE-së, por Serbia duhet të gjejë mënyrën që të normalizojë raportet me Kosovën për të hyrë në Bashkimin Evropian” - i ka deklaruar ai gazetës beogradase “Veçernje Novosti”.



Stjepan Mesiq

(3 prill) Mesiq: Serbia duhet t'i normalizojë marrëdhëniet me Kosovën

Londër - Presidenti i Kroacisë, Stjepan Mesiq, në një intervistë për BBC-në, ka thënë se Kosova është një realitet të cilin Serbia duhet ta respektojë edhe pa e njohur pavarësinë e saj. “Nëse Serbia nuk dëshiron të njohë Kosovën si subjekt ndërkombëtar, ajo duhet të hapë komunikimin, duhet të lejojë fluturimin e aeroplanëve, të lejojë komunikimin e qytetarëve, qarkullimin e kapitalit e kështu me radhë, duke normalizuar marrëdhëniet” - ka theksuar presidenti kroat.

(5 prill) NATO: KFOR-i do të vazhdojë të veprojë në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244

Bruksel - Drejtuesit e NATO-s kanë përshëndetur progresin e arritur deri tani në Kosovë, duke thënë se aleanca është e vendosur në ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit në Ballkan. Shefat e shteteve dhe qeverive të 28 vendeve anëtare të aleancës kanë ritheksuar se KFOR-i do të vazhdojë të veprojë në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244. “Nëse Këshilli i Sigurimit i OKB-së nuk vendos ndryshe, KFOR-i do të vazhdojë të qëndrojë në Kosovë dhe do të bashkëpunojë me të gjithë akterët kryesorë, me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të një Kosove stabile, demokratike dhe shumetnike”, kanë deklaruar ata.



Gambia

(7 prill) Gambia njeh pavarësinë e Kosovës

Uashington - Republika e Gambias e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Vendimi për njohjen e pavarësisë së Kosovës i është bërë i ditur sot, ambasadës së Kosovës në Uashington, nga ambasada e Gambias po në Uashington. Republika e Gambias është shteti i 57-të që e ka njohur Kosovën. Gambia ndodhet në pjesën më perëndimore të Afrikës. Përpos daljes në Oqeanin Atlantik, Gambia kufizohet me Senegalin.

(8 prill) Manter: SHBA-ja po bën çmos që shteti i Kosovës të jetë i suksesshëm

Beograd - Ambasadori amerikan në Beograd, Kameron Manter ka deklaruar në një intervistë për agjencinë serbe të lajmeve “Tanjug” se marrëdhëniet e SHBA-së dhe Serbisë janë në ngritje e sipër dhe në to, përpos mospajtimeve rreth Kosovës, nuk ka çështje të hapura. Ambasadori amerikan, njëkohësisht, ka vënë në dukje se SHBA-ja nuk e ka ndryshuar qëndrimin mbi pavarësinë e Kosovës dhe do të ushtrojë parashtrësë me shkrim në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë ku do ta arsyetojë qëndrimin e vet.

(9 prill) Vetëm 4 për qind në Serbi e shohin Kosovën si problem kryesor

Beograd - Një anketë e publikuar në gazetën serbe “Politika” tregon se vetëm 4 për qind e banorëve të atij vendi e konsiderojnë Kosovën si “problemin kryesor”. Në qendër të vëmendjes së opinionit publik të atjeshëm mbeten çështjet ekonomike dhe sociale, si papunësia, ekonomia dhe standardi jetësor.

(15 prill) Scheffer: KFOR-i po i kryen detyrat në mënyrë efikase në Kosovë

Kosovës në Hagë

Bruksel - Gjatë pothuajse një decenie, KFOR-i po i kryen detyrat e tij në mënyrë efikase për të realizuar një mjedis të sigurt në Kosovë, në pajtim me mandatin e tij në bazë të rezolutës 1244 të KS të OKB-së - ka thënë sekretari i përgjithshëm i NATO-s Jap de Hop Scheffer.

(16 prill) The Guardian: Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë - provë e krijimit të një rendi botëror humanitar

Londër - Gazeta britanike "The Guardian", në një koment kushtuar dhjetëvjetorit të sulmeve të NATO-s, ka theksuar se ndërhyrja e NATO-s në Kosovë duhet mbajtur mend si një ndërhyrje e përgjegjshme nga ana e perëndimit, si një provë e krijimit të një rendi botëror humanitar. "Shteti serb ndoqi një plan të pamëshirshëm për të ndryshuar përbërjen etnike të Kosovës nëpërmjet vrasjeve dhe shpërnguljeve masive" - shkruan gazeta.

(20 prill) Freizer: Njohja e shtetit të Kosovës do të vazhdojë edhe pas vendimit të GJNK-së

Bruksel - Njohja ndërkombëtare e Kosovës do të vazhdojë si para ashtu edhe pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë - ka deklaruar drejtoresha e Programit për Evropën e Grupit Ndërkombëtar të Krizave, Sabine Freizer.



Arabia Saudite

(21 prill) Arabia Saudite njeh pavarësinë e Kosovës

Nju Jork - Përfaqësuesi i përhershëm i Mbretërisë së Arabisë Saudite në OKB, ambasadori Khalid al Nafisse, gjatë një bisede telefonike i ka konfirmuar ministrit të jashtëm të Kosovës, Skënder Hysenit se, Arabia Saudite e ka njohur zyrtarisht Kosovën, shtet të pavarur dhe sovran. Duke përcjellë përshëndetjet e ministrit të jashtëm saudit, Princit Saud

Al- Faisal për krerët e institucioneve të Kosovës, ambasadori Al Nafisse e ka uruar popullin e Kosovës për pavarësinë. Arabia Saudite është shteti i 58-të që e njeh pavarësinë e Kosovës. Kjo është vlerësuar si një njohje me rëndësi të jashtëzakonshme, duke qenë se vjen nga një prej shteteve kryesore të botës islame.

(22 prill) 21 vende mbrojnë Kosovën në Hagë, 13 janë kundër

Hagë - Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë ka deklaruar se 35 shtete anëtare të OKB-së, kanë dorëzuar në këtë gjykatë kërkesat për pjesëmarrje në procesin lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Prej tyre 21 janë pro pavarësisë, kurse 13 kundër.

(24 prill) Kermabon: EULEX-i nuk zbaton gjashtë pikëshin e UNMIK-ut

Uashington - "EULEX-i nuk po e zbaton marrëveshjen gjashtë pikëshe të arritur ndërmjet UNMIK-ut dhe Beogradit për zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me policinë, drejtësinë e doganat në Kosovë" - ka thënë shefi i Misionit të BE-së për policinë dhe drejtësinë në Kosovë, Iv de Kermabon, në një intervistë për Zërin e Amerikës.



GJND

(25 prill) GJND i dorëzon Kosovës 35 deklaratat e deponuara

Hagë - Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë i ka dorëzuar Ministrisë së Jashtme të Kosovës 35 deklaratat e deponuara rreth rastit të Kosovës. Zyrtarë të ministrisë thanë për mediat se ekspertët kanë filluar shqyrtimin e tyre. Përgjigjet duhet të kthehen deri më 17 korrik.

(27 prill) Busek u kërkon vendeve të BE-së dhe Serbisë të njohin pasaportën e Kosovës

Beograd - Këshilltari special për zgjerimin e BE-së gjatë presidencës së Çekisë, diplomati austriak Erhard Busek,

ka kërkuar që edhe vendet e tjera të Bashkimit Evropian, por edhe Serbia, të njohin pasaportat e Kosovës. Ai ka thënë për gazetën serbe "Blic" se Kosova duhet të trajtohet ashtu si të gjitha vendet e tjera.



Luis Maria de Puç

(28 prill) De Puç: Duhet të shqyrtohet edhe kërkesa e Kosovës për anëtarësim në KE

Bruksel - Kryetari i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Luis Maria de Puç, ka deklaruar se deri më tani, Këshilli i Evropës nuk ka marrë ndonjë kërkesë për të shqyrtuar anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë. Luis Maria de Puç, ka thënë se një ditë ndoshta Këshilli i Evropës duhet ta shqyrtojë edhe këtë çështje. Ai ka përkujtuar se nga 47 vende anëtare të Këshillit të Evropës, 33 tashmë e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

(29 prill) BE e shqetësuar lidhur me protestat e dhunshme të serbëve në veri

Bruksel - Bashkimi Evropian ka shprehur shqetësim të thellë lidhur me protestat e dhunshme të serbëve në veriun e Kosovës. "Bashkimi Evropian është shumë i shqetësuar lidhur me shpërthimin e fundit të protestave të serbëve, të cilat lanë të plagosur disa njerëz në veri të Mitrovicës" - ka deklaruar përfaqësuesi i Republikës Çeke, e cila ka radhën e presidencës së BE-së.

(30 prill) Nga 1 maji deri më 30 tetor kufiri Kosovë-Shqipëri kalohet pa pasaportë

Prishtinë/Tiranë - Nga 1 maji deri më 30 tetor të këtij viti aplikohet regjimi i lehtësuar i kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë. Gjatë kësaj periudhe, qytetarët e Republikës së Kosovës do të mund të kalojnë kufirin me Republikën e Shqipërisë pa pasaporta dhe vetëm me letërnjoftim valid, thuhet në marrëveshjen e nënshkruar nga dy ministritë përkatëse. ■

Histori Islame (30)

Persët nuk ishin monoteistë. Ata nuk i përballuan goditjes së fuqishme të muslimanëve, si në front, ashtu edhe në fe dhe në natyrshmërinë njerëzore. Marrëveshjet midis ushtrisë islame me politeistët pers nuk ishin të njëjta sikurse me bizantinët. Atje Islami pranohej me të shpejtë dhe pa asnjë mëdyshje.

Omeri r.a. ishte njeri me tipare të veçanta, të cilat e dallojnë atë shumë nga sahabët e tjerë. Ishte shumë i drejtë dhe njëkohësisht i rreptë. Drejtësia e tij e frikësonte shumëkënd, ai nuk falte askënd. Mund të thuhet se kjo veçori e tij, bëri që shteti islam të zgjerohej për disa miliona kilometra më shumë, sepse ata nuk merrreshin me thashetheme. Intrigat, polemikat dhe interesat personale do të dilnin më vonë.

Meqenëse shteti islam për dy vjet qeverisje të Ebu Bekrit r.a. ishte stabilizuar dhe kishte marrë të mbarën, Omeri r.a. nuk kishte pse të mendonte për ndonjë strategji të re, përveçse të vazhdonte rrugën e Ebu Bekrit r.a. Ai mëntonte përhapjen e fesë në brendi të dy superfuqive, sepse nuk kishte zgjedhje të tretë. Kjo ishte rruga e vetme për atë kohë, prandaj secilit qytet që ishte pranë kufirit me muslimanët i kërkohesh të pranonte fenë ose xhizjen, në të kundërtën do të detyroheshin të luftonin.

Omeri r.a. ishte shumë i kujdesshëm dhe strateg i madh. Ai nuk kërkonte asgjë më shumë nga ushtarët e tij se

Çlirimi i Lindjes së

sa të qëndronin fort në besimin e tyre në një Zot të vetëm dhe u kërkonte që ta mbanin lart moralin sepse vetëm me të ata do ta mund ta mposhtnin ushtrinë kundërshtarë. Ai e kishte të qartë se forcat e tij ushtarake, në krahasim me të ato të Herakliut (Bizantit) dhe të Kistrasë (Persisë), ishin shumëfish më të vogla.

Nuk ka dyshim se çlirimet e përnjëhershme të trojeve të të dy superfuqive, ishte një absurd i kohës. Logjika e shëndoshë nuk dëshiron ta pranojë, por ja që historia ka dëshmuar për humbjet që u shkaktoi dy superfuqive më të mëdha të botës së atëhershme. Cilat ishin shkaqet e rënies së këtyre dy superfuqive janë tema me të cilat merren shkenca të tjera, por ajo që bie në sy të një analisti, nuk ishte e lehtë edhe për muslimanët, përkundër shumë mrekulive që janë treguar.

Janë transmetuar bisedat (transkriptimet) e shumta që janë zhvilluar midis përfaqësuesve të ushtrisë muslimanëve dhe komandantëve të ushtrive me të cilat përballëshin muslimanët, si edhe bisedat me mbretër ose me perandorë. Është interesant të theksohet, se para se të fillonin bisedimet rreth arsyes së luftimeve, jomuslimanëve iu kanë lënë përshtypje të veçantë pamja e jashtme e veshjes së thjeshtë të deleguesve muslimanë. Përfaqësuesit muslimanë, edhe pse kishin takime me perandorë, nuk i



Muhamed J. KAJOLLI

Ata shkonin në takime ashtu siç ishin në prani të shokëve të tyre. Me të tilla rroba shkonin për t'i takuar edhe perandorët. Rrobat e tyre iu kanë lënë përshtypje në shumë raste: "ata nuk kishin me vete as çizme ushtarake, por në front dilnin me nalle të drunjta, për të mos thënë këmbëzbathur". (Bidaje: 5/284)

Tregohet se për të treguar fuqinë dhe pasurinë e madhe që kishin, palët e të dy perandorëve me qëllimin e futjes së frikës, paraqitjet e tyre përpara deleguesve të muslimanëve i kishin të nivelit shumë të lartë ushtarak, por nuk është treguar asnjëherë se muslimanët e parë janë entuziazmuar, kanë lakmuar ose të jenë frikësuar prej atyre defilimeve. Muslimanët ishin thellë të motivuar. Ata duhet ta shpërndanin monoteizmin e pastër të tyre, ndërsa kjo i bënte shumë të thjeshtë, të devotshëm dhe gjithashtu të fuqishëm.

Ndërsa, në anën tjetër, morali për fitore ishte i vogël si në anën e persëve, ashtu edhe në anën e bizantinëve. Dikush mendon se numri i madh i përkatësive arabe në perandorinë bizantine, ka bërë që bizantinët të humbin shpejt nga arabët. Ky është një faktor dhe është i vërtetë, por arabët e islamizuar tani ishin njohur në rajon si njerëz shumë të drejtë dhe të butë me besimtarët dhe me të gjithë ata që ishin nën mbrojtjen e tyre. Ndërsa, në anën tjetër, si persët, ashtu edhe bizantinët i kishin rritur tatumet, udhëhiqeshin nga administratorë të korruptuar dhe tirania sa vinte e shtohesh edhe më shumë.

Çlirimi i Damaskut

Ashtu siç theksuam më herët, muslimanët kishin arritur fitoren e madhe ndaj Herakliut në Jermuk, në kohën e Ebu Bekrit. Bizantinët nuk e kishin pritur aspak këtë fitore të muslimanëve, por edhe persët nuk iu gëzuan gjatë humbjes së bizantinëve, sepse edhe këta humbën ngjashëm në Kadisije. Mbase muslimanët ishin nënvleftësuar fillimisht prej



Një nga dyert e qytetit të Damaskut, Siri

Mesme dhe Persisë

tyre, por këto fitore u pasuan me fitore të tjera të njëpasnjëshme dhe kjo shpjegonte për një forcë reale të tyre.

E si mos të nënvlerësoheshin muslimanët, kur logjika e shëndoshë nuk besonte se ata do të mobilizoheshin aq shpejt dhe mirë sa për t'i mundur ata, kur pak vite më parë arabët nuk ishin të panjohur në rajon? Thënë shkurt arabët ishin nomadë që mezi ngopeshin me ushqim. Nuk ishte e largët koha që ata kujtonin kur ushqeheshin me çdo gjë që lëvizte mbi shkretëtirë. Se si arritën që të organizonin popullin dhe të themelonin një ushtri të rregullt, ishte befasi për të cilën asnjë institucion i atëhershëm dhe i tanishëm nuk arrin ta kuptojë.

Gjithashtu, se ata njëherësh do të sfidonin edhe ushtritë më të mëdha të kohës, është dhe mbetet enigma më e madhe, që logjika nuk do të arrijë asnjëherë ta kuptojë. Sido që janë zhvilluar ngjarjet, arabët e islamizuar i bënë bizantinët dhe persët të tërhiqen vazhdimisht, duke mos ju lënë kohë për të menduar për rikthimin e trojeve të humbura. Ata do të përshëndeteshin përfundimisht me këto vende.

Persët nuk ishin monoteistë. Ata nuk i përballuan goditjes së fuqishme të muslimanëve, si në front, ashtu edhe në fe dhe në natyrshmërinë njerëzore. Marrëveshjet midis ushtrisë islame me politeistët persë nuk ishin të njëjta sikurse me bizantinët. Atje Islami pranoi me të shpejtë dhe pa asnjë mëdyshje.

Ndërsa bizantinët ishin monoteistë dhe muslimanëve do t'iu duhej kohë më e gjatë për t'i b i n d u r në fenë e re. Islami tek bizantinët kupto-

hej si një sekt i ri, i cili ishte i përafërt me besimin e tyre. Por ata e kishin të vështirë që ta pranonin atë "sekt", sepse vinte nga një pjesë e botës së pazhvilluar. Askush nuk besonte se prej shkretëtirës do të lulëzonte një civilizim i ri. Për këtë arsye, çlirimi i tokave në këtë perandori ishte më i ngadaltë. Muslimanët do të duhej të ishin shumë më të vëmendshëm. Ata do të duhej të vepronin me shumë strategji për të çliruar vendet e trojeve bizantine, në veçanti Kuds (qendrën e monoteistëve). Për këtë arsye, ata fillimisht do të çlironin Damaskun, i cili në atë kohë ishte një prej qendrave më të mëdha të perandorisë bizantine pas Kostandinopojës. Ai që e ka vizituar këtë qytet, e kupton se çfarë qendre e madhe ka qenë në atë kohë. Damasku u çlirua pa luftë. Sipas disa historianëve, ai u çlirua pas një rrethimi të gjatë prej shtatëdhjetë ditësh, ndërsa disa të tjerë thonë pas katër ose gjashtë muajve rrethimi. Disa të tjerë thonë se është bërë një luftë e vogël dhe si rezultat i saj ushtria muslimane kishte të drejtë të kërkonte pjesë në shfrytëzimin e katedrales së madhe të Jovanit. Kjo katedrale numërohej si një prej katedraleve më të mëdha të rajonit. Për arsye që qyteti të mos shkatërrohej, ushtria bizantine pranoi kushte e kapitullimit.

Marrëveshja përfundoi jo sikurse me persët, sepse të krishterët megjithatë ishin pjesëtarë të fesë qiellore. Gjysma e kishës së Jovanit (pjesa lindore) do të shndërrohej në xhami, ndërsa pjesa perëndimore do të vazhdonte edhe më tutje me predikimet kishtarë sikurse edhe më parë. Ata që e kanë vizituar Damaskun edhe sot e kësaj dite mahnitën me madhështinë e kësaj xhamie-katedrale. Në mungesë të të

krishterëve në vend, gjatë historisë pjesa perëndimore e kishës sot qëndron e rrënuar. Duken gërmadhat e shtyllave gjigante, ndërsa xhamia vazhdon të qëndrojnë e bukur sikurse ka qenë edhe në atë kohë.

Çlirimi i Kudsit

Marrëdhëniet e çifutëve me arabët ishin të hershme. Ata e njihnin njëri-tjetrin shumë mirë. Njohja e tyre nuk ishte vetëm në saje të marrëdhënieve tregtare, por, Kur'ani çifutëve ia kishte kushtuar shumë ajete. Edhe pse ishin shumë të rezervuar, tregtia asnjëherë nuk ishte ndërprerë. Ashtu sikurse gjatë kohës së Muhammedit s.a.v.s., edhe pasi ai ndërroi jetë, tregtia me Kuds nuk ishte ndërprerë. "Ata fushin mjaltin e bletëve, hurmat, pallmat madje dhe rrushin deri në Taif pranë Mekkes". (Zhak Atali: 117)

Muslimanët, edhe pse shpalesën monoteizmin e pastër, ishin këshilluar nga Kur'ani që me ithtarët e Librit të ishin të vëmendshëm dhe, nëse do të hapnin debate, ata do të duhej të ishin shumë të kujdesshëm. Kështu, këtë virtut të sinqertë të muslimanëve kanë filluar ta vlerësojnë edhe studiuesit e sotëm. "Por ndoshta gjëja më e rëndësishme ishte se nuk e kishin dënuar Biblën si të vjetërsuar, apo nuk kishin propozuar që shkrime të reja të shenjta ta zëvendësonin atë". (Lewis: 31)

Kudsi (Jerusalemi), është qyteti më i rëndësishëm në botë për të gjithë ithtarët e Librit. Këtë qytet e pretendo/nin/jnë çifutët, krishterët dhe muslimanët. Për këtë arsye Omeri r.a., para se të drejtohej drejt Kudsit, do t'iu çlironte të gjitha qytetet përreth tij. Për Kuds ishin shkruar shumë, po shkruhet edhe tani dhe do të shkruhet deri në përfundimin e kësaj bote. Këtu nuk do të shtjellojmë argumentet rreth mënyrës se si u çlirua Kudsi nga ana e muslimanëve në kohën e Omerit, sepse edhe ky qytet është çliruar pa luftë, por ajo që na in-





tereson neve është marrëveshja pas dorëzimit të çelësave nga ana e çifutëve.

Çifutët kishin paralajmërimet e tyre mbi dorëzimin e Kudsit, prandaj kishin kërkuar prej ushtrisë muslimane që çelësat do t'ia dorëzonin prijësit të tyre, Omerit r.a. Për këtë arsye Omeri r.a. u nis për në Kuds, ndërsa në Medinë si zëvendës e la Alinë r.a. Me të hyrë në qendër të qytetit, Omeri pastroi plehurat në qendër të qytetit, tek vendi (shkëmbi) në të cilën dy decenie më parë Muhammedi s.a.v.s. ishte ngjitur për në qiell. Ky shkëmb ka historinë e vet. Derisa qyteti i Kudsit ishte nën sundimin e çifutëve, ky shkëmb përdorej si vend flijimi i kafshëve. Nga shumë studiues thuhet se mu në këtë shkëmb çifutët kishin prerë kokën e Jahjasë a.s. (Gjonit). Po ashtu, në këtë vend (sipas të krishterëve) ishte "kryqëzuar" Krishti dhe, për këtë arsye, kur qyteti kishte kaluar në duart e të krishterëve, ky vend (shkëmb) ishte shndërruar në vend për hedhjen e plehrave të qytetit. (Bidaje: 5/281)

Shkurt, këtu do të sjellim edhe marrëveshjen që Omeri bëri me popullin e krahinës së Ilisë dhe Ludit (Palestinë), në të cilën ishte edhe qyteti i Kudsit:

"Me Emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit.

Kjo është besa që Omer bin Hatabi, prijësi i muslimanëve, ia jep popullit të (Palestinës):

I gjithë populli është i siguruar në jetën, pasurinë, familjen dhe nderin e tyre. Ata janë të siguruar në besimin e tyre, në kishat dhe manastiret e tyre. Kushdo është i lirë të zgjedhë, nëse do të qëndrojë në fenë e tij, apo do të pranojë Islamin. Liria e besimit do të jetë e drejtë e të gjithë popullit dhe askush nuk do të dhunohet për besimin që ka.

Populli i Palestinës duhet të nxjerrë jashtë të gjithë hebrenjtë. Ata kurrë nuk duhet të pranohen si banorë të Palestinës, për shkak të krimeve që kanë kryer ndaj pejgamberëve të Zotit të Lartëmadhëruar

Në këmbim të këtyre të drejtave, të krishterët që janë në Palestinë do të paguajnë xhizjen. Kështu, ata do të kon-

siderohen me të drejta të plota njëjloji si muslimanët dhe do të jenë të mbrojtur ekskluzivisht nga shteti musliman. Cilido nga banorët e këtyre vendeve që dëshiron të transferohet në vendet bizantine, do të jetë i mbrojtur deri sa të arrijë në ato vende". (Eduard Thartori: 63, Tabriu 2/449)

Çlirimi i Persisë

Omeri r.a. duke e kuptuar se numri i muslimanëve që ishin drejtuar drejt Persisë ishte i vogël, kishte vendosur që ta drejtonte vetë atë ushtri. Më herët thamë se Ebu Bekri r.a. kishte dërguar katër ushtri për në Sham, të cilat qëndronin ende atje. Si përforcues të tyre, nga pjesa perëndimore e Eufratit, kishte dërguar për në Sham (Lindjen e Mesme) Halid ibn Velidin, çlirimtarin e tokave përgjatë vijës së lumit Eufrat. Prandaj ushtria muslimane në këto krahina ishte numerikisht shumë e vogël. Atyre ju duheshin përforcime të reja dhe kjo e shtyri Kalifin e ri ta merrte vetë në dorë këtë ekspeditë. Persia ishte fuqia më e madhe e kohës.

Omeri r.a. doli me ushtrinë e tij për në Persi, ndërsa në Medinë kishte lënë si zëvendës të tij Alinë (Zoti e fisnikëroftë fytyrën e tij). Këtë po e theksoj këtu për të treguar se marrëdhëniet midis Alisë dhe Omerit dhe sahabëve të tjerë ishin shumë normale dhe korrekte. Asnjëherë nuk është vërejtur ndonjë mospajtim midis tyre. Omeri r.a., gjithashtu, e kishte lënë Alinë si zëvendës edhe në kohën kur mori rrugën për në Kuds (Jerusalem). Këto janë tregues të qartë se marrëdhëniet midis tyre ishin vëllazërore. Por politika e mëvonshme ka përgënjeshtuar faktet dhe kanë shpifur për njëri-tjetrin.

Në rrugë e sipër, derisa ushtria e Omerit r.a. kishte ndaluar për të pushuar në një vend, Abdurrahman Ibn Aufo dhe shokët e tij, arritën ta bindin Omerin që të kthehej në Medinë, sepse forca e tij për të komanduar nga Medina ishte më e madhe se sa në vetë pjesëmarrjen në fushëbetejë me persët. Pasi u bind, ai u kthye duke lënë për komandat të forcave muslimane Sead ebi Vekasin.

Atij i tha: -O Sead, asnjëherë mos të të gënjejë mendja për post, e as që je daja i Pejgamberit s.v.a.s. Ne të zgjodhëm si më të devotshmin prej të tjerëve, prandaj ke frikë All-llahun e Lartëmadhëruar, sepse me këtë cilësi do të jesh triumfues kudo që të shkosh dhe mbështetu te Krijuesi i botëve.

Për të mos numëruar betejat e Sead-it r.a., ne do të theksojmë fitoren e tij më të rëndësishme që u zhvillua në vendin el-Kadisije (edhe sot mban këtë emër), që është në pjesën perëndimore të lumit Eufrat. Transmetuesit në këtë betejë, tregojnë se si janë zhvilluar bisedime disamuajshe, derisa ka ardhur deri tek lufta. Shpeshherë, si komandanti i ushtrisë perse Rustumi, ashtu edhe perandori pers, e ndienin humbjen prej muslimanëve edhe pse numerikisht ishin më të shumtë. Pyetjes se pse do të duhet që ne të luftojmë me ju, kur ju jeni nomadë dhe të përçarë, muslimanët iu përgjigjeshin: Është kohë e kaluar për ne, kur ne ishim të tillë, por neve na gëzoi Krijuesi me të Dërguarin e Tij, të cilin e besuam dhe tani jemi të thirrur që ta përhapim këtë besim. Transmetuesit tregojnë se, si komandanti në el-Kadisije, ashtu edhe perandori, iu kishin thënë: Po sikur ne të prananim Islamin, ju a do të na luftonit? Ata i kishin siguruar se marrëdhëniet midis tyre do të ishin vetëm vëllazërore dhe se nuk do të kishte luftëra. Fjalët bindëse dhe logjike që prezantonin delegacionet e muslimanëve në bisedime, ishin mahnitëse.

Thuajse ishin bindur, që të merreshin vesh për të mos luftuar, por nënkomandantët pers nuk kishin pranuar, duke ju siguruar se me arabët do të korrnin sukses të shpejtë dhe do t'ju jepnin goditjen përfundimtare. Kështu u shkua deri tek betejja në el-Kadisije, betejë që konsiderohej porta kryesore për në Persi. Pas një lufte të ashpër, fitorja ju takoi muslimanëve dhe që prej kësaj betejë ushtria e Sead-it nuk kishte të ndalur. Derisa Omeri r.a. ishte në krye të shtetit islam, kjo ushtri kishte arritur në tokat e Ermenisë, Azerbejxhanit dhe Afganistanit. ■

Organizata Human Rights Watch i akuzon landet gjermane për racizëm kundër myslimaneve

Racizëm në emër të neutralitetit

BERLIN

Organizata Human Rights Watch, zyra e saj në Berlin, ka kërkuar nga qeveritë lokale në tetë lande gjermane që t'i anulojnë ligjet e aprovuara para pesë vitesh, të cilat ndalojnë bartjen e mbulesës në punë, shkollë dhe në vendet zyrtare.

Organizata në fjalë e cila është një organizatë botërore që merret me të drejtat e njeriut, në raportin e saj të nxjerrë në Berlin, ligjet e aprovuara nga gjysma e landeve gjermane, në vitin 2003, të cilat e ndalojnë bartjen e mbulesës në vendet zyrtare dhe e quajnë si kundërligjore një gjë të tillë, e cilësuan si një sulm të hapur dhe shkelje flagrante të të drejtave të njeriut dhe racizëm të qartë ndaj femrave myslimane, të bazuar mbi bazën e gjinisë dhe fesë.

Raporti i kësaj organizate, i përfshirë në 73 faqe dhe i titulluar "Racizëm në emër të neutralitetit", në hyrje të tij ka paraqitur një hulumtim intensiv të bërë në terren brenda tetë muajve, pastaj analizën e thellë të ligjeve që ndalojnë që femra myslimane të punojë e veshur me mbulesë në vendet zyrtare të qeverisë gjermane, një analizë e përqendruar në kontekstin e parimeve për të drejtat e njeriut të njohura botërisht. Raporti, gjithashtu, përfshin edhe sondazhin e bërë në terren nga 72 qytetarë, lidhur me ligjet që ndalojnë veprimin e lirë në punë zyrtare, të femrave të veshura me mbulesë.

Nga personat e përfshirë në sondazh ka edhe politikanë, juristë, hulumtues, specialistë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare. Krahas tyre janë intervistuar edhe 34 myslimane, që janë dëmtuar për shkak të ndalimit të tyre që të punojnë në institucione zyrtare.

Racizëm dhe urrejtje

Iniciuar nga zonja Marianne Heuwa-gen, drejtoreshë e zyrës së HRW në Gjermani, organizata HRW disa herë ka reaguar edhe ndaj shteteve si: Mbretëria e Arabisë Saudite, Irani dhe Afganistani, kundër detyrimit të femrave që të veshin rroba të natyrës fetare.

Ajo thotë se ligjet që ndalojnë mbulesën (hixhabin) në vendin e punës në institucionet zyrtare në tetë landet e

Federatës Gjermane, paraqesin armiqësi dhe shkelje flagrante të parimeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe të drejtat themelore të gruas, e sidomos të drejtën e vendimmarrjes, të drejtën dhe lirinë e zgjedhjes së metodës për të jetuar sipas bindjes personale dhe pa imponim.

Raporti i Organizatës HRW thekson se qëllimi i këtyre ligjeve është që t'i jepet fund veshjeve me simbole fetare gjatë punës nëpër shkolla dhe institucione zyrtare, mirëpo në interpretimin e këtij ligji na paraqitet shumë qartë se ai është drejtuar vetëm kundër femrave myslimane dhe ka për qëllim që t'i ndalojë femrat myslimane që ta bartin mbulesën.

Raporti në fjalë, bën të qartë se këto ligje, në përmbajtjen e tyre, përmbajnë frymë raciste kundër femrës myslimane dhe kundër fesë islame, si dhe shprehin urrejtje ndaj të gjitha atyre femrave që bartin mbulesën mbi kokën dhe trupin e tyre si rezultat i bindjeve të tyre.

Raporti vazhdon përpjekjet për të ndikuar rreth ligjeve që ndalojnë mbulesën (hixhabin) në jetën e nëpunësve myslimane, duke theksuar se këto ligje kanë ndikuar rrënjësisht në jetën dhe karrierën e femrave myslimane. Atyre që kanë punuar në arsim si arsimtare për një kohë të gjatë, vetëm e vetëm pse janë këmbëngulëse që ta bar-

tin mbulesën (hixhabin), i detyrojnë që ta ndërpresin karrierën e tyre. Gjithashtu, në raport sinjalizohet se ato që kanë përfunduar studimet universitare dhe që kanë marrë dekorata për sukseset e tyre në studime dhe në punë si profesoresha, rrezikohen që për një moment të dështojnë dhe ta humbin vendin e punës vetëm e vetëm pse kanë vendosur mbulesën mbi kokën e supet e tyre.

Theksohet se disa nga këto myslimane kanë ndryshuar profesionin e tyre, ose kanë emigruar në landet e tjera ku nuk ndalohet mbulesa (hixhabi) për të punuar në profesionin e tyre.

Është edhe një grup tjetër prej tyre, që edhe përkundër faktit se janë me origjinë dhe nënshitetësi gjermane, e kanë lëshuar vendin dhe kanë emigruar jashtë Gjermanisë. Ndërsa është edhe një pakicë e vogël e atyre që kanë pranuar që ta heqin shaminë gjatë orarit të punës së tyre në institucionet zyrtare.

Mbulesa ose vello islame (hixhabi) dhe neutraliteti

Autorët e raportit të HRW thonë se justifikimi i landeve gjermane për aprovimin e ligjeve që ndalojnë përdorimin e simboleve fetare ishte fakti se kinse ato po ruajnë neutralitetin fetar brenda institucioneve të tyre. Sipas tyre, mbulesa me vello (hixhabi) po e dëmton neutralitetin.



Disa policë qëndrojnë për të mbajtur rend gjatë një proteste të mbajtur kundër Islamit dhe muslimanëve në Gjermani

Deri më tani, ata nuk kanë arritur që të gjejnë qoftë edhe argumentin më të vogël se femrat myslimane që mbajnë veshje islame e kanë dëmtuar neutralitetin fetar. Përkundrazi, ato kanë kërkuar që të bëhet vlerësimi i tyre mbi bazën e standardeve të efikasitetit dhe aftësisë për punën që bëjnë, e jo në bazë të bindjeve dhe veshjeve të posaçme që mbajnë dhe kanë.

Ftesë për dialog

Brizhit Merjem Vajs, përgjegjëse e lartë e Komitetit Suprem për Çështjen e Gruas Myslimane në Gjermani (KSCG-MGJ), thotë se shumica e grave myslimane shpeshojnë në ndikimin që mund të ketë raporti i Organizatës Human Rights Watch për anulimin e ligjeve që ndalojnë mbulesën (hixhabin) për gratë myslimane që punojnë në institucionet zyrtare.

Në intervistën e dhënë për Al-Jazeera.net, ajo konstaton se këto ligje janë kontradiktore me interesimin e shoqërisë gjermane për inkurajimin e femrës që të punojë dhe të ketë personalitet të pavarur.

Gjithashtu, kjo gjë po e pengon tregun e punës në vend që t'i shfrytëzojë dhe t'i zhvillojë aftësitë e grave që kanë kryer nivelet e larta universitare dhe profesionale.

Vais, e cila është profesoreshë dhe e cila është dëmtuar për shkak të ligjeve që ndalojnë mbulesën (hixhabin), potencon se racizmi politik me të cilin po ballafaqohet femra myslimane për shkak të mbulesës (hixhabit) mund t'i shërbejë rrymave ekstreme djathtiste që janë në shoqërinë gjermane dhe, në anën tjetër, i detyron një pjesë të myslimanëve që të izolojnë dhe të tërhiqen nga jeta e tyre publike.

Nga ana tjetër, Hajnc Bielefeldt drejtori i Institutit Gjerman për të Drejtat e Njeriut e sheh se të shikuarit e fesë islame me sy dyshimi paraqet njërin nga shkaqet që do të nxirrte në pah debat shoqëror rreth çështjes së mbulesës. Ai konsideron se shumica dërmuese e grave myslimane e bartin mbulesën nga bindja e tyre fetare dhe kjo është zgjedhja e tyre e lirë personale, sepse një gjë e tillë paraqet identitetin e tyre fetar.

Lidhur me këtë, pak ditë më vonë, në

Itali ndodhi e kundërta e kësaj që ndodhi dhe po ndodh në tetë landet gjermane, kur një zyrtar italian deklaroi haptas se nuk mund ta ndalojë mbulesën e femrës, sepse edhe Shën Maria (Merjemja a.s.) del para nesh me kokë dhe trup të mbuluar (kishte për qëllim pamjet që i besojnë të krishterët për Merjemen a.s., e ëma e Isait (Mesit) a.s. e cila na paraqitet nga artistët e afreskeve krishtere me veshje të njëjtë sikur femrat myslimane).

Mirëpo ky zyrtar italian u akuzua nga laikët se po tregohet racist fetar në shtetin laik.

Çudirat ndodhin edhe aty ku nuk i presim. Mbi të gjitha mbetet urtësia e Zotit mbi krijesat. ■

Shënim: Materiali dhe të dhënat shtesë janë huazuar nga Faqja zyrtare e Organizatës Human Rights Watch dhe nga korrespondenti i Aljazeera.net në Berlin, Khalid Shemet

E përgatiti: Fitim Flugaj

Mbresa nga një ekskursion në Turqi

Në Canakkalen e rezistencës



Emine A. VEZAJ

Të organizuar në formën më të mirë të mundshme, një delegacion nga Kosova me maturantet e medresesë së mesme "Alauddin", me dy paralelet e saj, atë të qendrës në Prishtinë dhe me paralelen e ndarë fizike në Prizren, mësyu këto ditë gjysmë pranverore Turqinë, shtetin aleat më të mirë të shqiptarëve. Ky delegacion kishte për qëllim që të informohej më për së afërmi me

historinë dhe të kaluarën e Turqisë. Fillimisht, mysafirët nga Kosova u pritën në mënyrën më miqësore nga organizatori i këtij ekskursioni, valiu i Tekirdagut, zt. Aydin Nezih Dogan. Maturantet nga Kosova patën kënaqësinë që të ndajnë dy javë të plota në Turqi, kryesisht në Tekirdag, në një vend të njohur si vend i teknikës dhe teknologjisë bashkëkohore, por edhe si vend i rezistencës kundër një lufte të egër të cilën e kishin përjetuar me vite me radhë – Luftës së Canakkales.

E gjetëm veten si mysafirë të nderuar të Turqisë, në vendin më të shenjtë të Turqisë, në Canakkalen e rezistencës, aty ku në mesin e shumë dëshmorëve të rënë në altarin e lirisë, figuronin edhe shumë emra shqiptarë, të cilët ishin nga vise të ndryshme të Kosovës, e sidomos nga Prizreni, Prishtina e edhe nga vise të tjera.

Edhe sot e kësaj dite, në një pjesë të Tekirdagut ku rrugët janë me kalldrëme, ato ndër popullatën turke njihen me emrin "kalldrëme arnaut".

Ndërsa ne e gjetëm veten si mysafirë të nderuar të Turqisë, në vendin më të shenjtë të Turqisë, në Canakkalen e rezistencës, aty ku në mesin e shumë dëshmorëve të rënë në altarin e lirisë, figuronin edhe shumë emra shqiptarë, të cilët ishin nga vise të ndryshme të Kosovës, e sidomos nga Prizreni, Prishtina e edhe nga vise të tjera.



Mbase janë gjëra që pashmangshëm na lidhin nga e kaluara, por edhe e sotmja e dëshmon këtë sepse Turqia është vendi i dytë në botë që njohu sovranitetin e Kosovës. Ajo e njohu Kosovën shtet të pavarur dhe është e para që bëri heqjen e vizave për qytetarët kosovarë të cilët do ta vizitojnë në të ardhmen këtë vend. Gjithashtu, turqit janë edhe të parët të cilët në formën më masive i kanë shtrirë investimet e tyre në fusha të ndryshme të jetës politike, shoqërore e sociale.

Këto informime dhe njohuri të thella për këtë vend na i ka dhënë një person, të cilit ne do t'i jemi falënderues pafund, e ky është valiu i Tekirdagut, z. Aydin Nezih Dogan, i cili na ofroi mundësinë që kujtimet më të mira t'i marrim pikërisht nga vendi më i dashur, më bujar dhe miku më i mirë i shqiptarëve. Faleminderit zt. Aydin dhe gjithë nëpunësve të tij, të cilët bënë që ky udhëtim dyjavësh të jetë i organizuar në formën më të mirë të mundshme. Le të shpresojmë se kontaktet tona mes dy vendeve do të rriten dhe do të fuqizohen edhe më shumë. Në rastin konkret shpresojmë që qyteti i Tekirdagut të binjakëzohet me njërin ndër qytetet më të bukura të Kosovës, qytetin e kulturës dhe historisë - Prizrenin e lashtë.

Stambolli – qyteti me më shumë shqiptarë

Shqiptarët si popull në terminologjinë turke njihen me emrin “ar-naut”, ndërsa sipas të dhënave historike – turke, njihet si popull që Perandorisë Osmane – turke, i dha mbi dyzet e pesë kryeministra. Në veçanti sanxhaku i Kosovës dha edhe shumë njerëz të dijes, me në krye Sami Frashrin, të njohur në historinë turke me emrin Shemsettin Sami, pastaj Mehmet Akif Ersoy si dhe shumë dëshmorë të rënë në luftën më të madhe dhe të njohur në historinë turke, në Luftën e Canakkalas. Sipas një statistike, jo edhe aq të verifikuar, thuhet se gjendja aktuale e shqiptarëve të Turqisë, kap shifrën rreth katër milion. Këta shqiptarë të shpërngulur në Republikën e Turqisë, në përgjithësi, janë të vendosur ose jetojnë në vende të ndryshme të këtij vendi, por shumica e tyre janë vendosur më së shumti në qytet e mëdha, siç janë Stambolli, Izmiri, Ankaraja, Bursa, Edirneja etj. Pjesa dërmuese, në bazë të disa të dhënave jo edhe aq zyrtare, jetojnë në Stamboll. Shumica e shqiptarëve të emigruar në këtë pjesë të Ballkanit, të cilët janë vendosur në qytetin e Stambollit, jetojnë në rrethinën e Zeytinburnut, Bajrampashës, Alibeykoyit, Ymranijes, Kadikoyit etj. Marrë në përgjithësi, shqiptarët dhe turqit, janë të afërt mes vete.

Ato gjenerata të vjetra të cilat edhe sot janë në Turqi, kanë arritur ta ruajnë gjuhën shqipe. Mbase këtë arritëm ta vërejmë edhe në tregjet e Stambollit, ku një pjesë prej tyre e flisin një shqipe ashtu gjysmë të kuptueshme. Jo larg, por afër njëri-tjetrit, si dy vende që janë njohur edhe si popuj ballkanas, shqiptarët dhe turqit kanë pasur për shumë kohë një histori të përbashkët.

Nëse do të interesoheshim për veten dhe si na njohin të tjerët, në mentalitetin turk dhe në perceptimet e tyre për përshkrimin e shqiptarëve, ekzistonin fjalë të mira dhe shumë domethënëse. Një shqiptar në sytë e një turku do të dukej kështu: trim, i besës, tip i inatosur, i lidhur për familjen, i përshtatet popullit turk, etj.

Shqiptarët asnjëherë nuk kanë ditur të humbin të mirën që të tjerët i kanë bërë. Në këtë rast, pas çdo takimi që patëm, ne konsideronim se ndiheshim si në shtëpitë tona, pasi jemi në një vend, që pos asaj që na bashkon historia, neve si popuj na bashkojnë edhe shumë gjëra të tjera. Është besimi islam që na bashkon dhe kultura, e cila edhe sot e kësaj dite është dëshmi e asaj perandorie gjigante që ishte prezent në Kosovë për një kohë të gjatë, gjë që mund të vërehet tek shumë qytete dhe fshatra të Kosovës. Këtu mund të përmendim xhamitë, mejtepet, hama-met e shumë kulte të tjera. ■

Rrymat e pasluftës



Ekrem AVDULLAHU

Po të nise mi e të kërkojmë së pari fjalën 'kuller' dhe prejardhjen e kësaj fjale, pa ndonjë mund të madh këtë do ta gjejmë në fjalorin e gjuhës angleze: *cool/er*, e që në shqip na jep disa shpjegime si: ftohës, frigorifer, freskues etj.

Pra, po ta analizojmë këtë nocion, kullerizmi na dalka si një rrymë e shoqërisë që na sjellka freski në mjediset tona. Në mesin e shumë rrymave 'moderne' të pasluftës që arritën të depërtojnë (me apo pa dashjen tonë) në Kosovë, si: muzika, veshja, edukata, kultura etj., që në vete bartin të dy anët e medaljes, në muajt e parë të pasluftës në Kosovë, (së pari në Prishtinë, e më vonë në gjithë Kosovën) hyri njëfarë trendi që tani po quhet si kullerizëm.

Ky lloj trendi preku pjesën më vitale të shoqërisë – rininë, duke u përhapur me një shpejtësi marramendëse dhe, tani, thuhet mbi 60 % e rinisë e zonave urbane dhe mbi 40 % e zonave rurale, në njëfarë mënyre e kanë përqaftuar këtë dukuri.

Shpesh në deklaratat e politikanëve dhe njerëzve publikë kemi dëgjuar fjalët më të fuqishme dhe më miradije për rininë kosovare, duke aluduar kështu për një rini të pastër, të çiltër, larg rinisë së botës perëndimore, e cila çdo ditë

Kullerizmi

Nëse dëshiron të jesh kuller apo kullere mjafton të dish të flasësh zhargon të mbrapshtë, të mbash një frizurë asimetrike, të të shihet gjysma e prapanicës nga aeroplani, të shkosh në orët e vona në shtëpi e të flesh deri vonë, të mos komunikosh më babanë tënd, e nëse je nxënës, të ulësh në bankat e fundit të klasës dhe të lozësh me celular dhe të imitosh ose përqeshësh arsimtarët.

ballafaqohet me probleme të natyrave të ndryshme si: narkomani, prostitucion, hajni, dhunë etj.

Por, realisht, a e ka Kosova sot këtë rini të pastër? Po të jemi jorealë ndaj realitetit të përditshëm, sigurisht se do të japim një përgjigje pozitive. Dhe, po të jemi realistë – përgjigja do të jetë tepër e hidhur.

Dhe një ndër dukuritë më të çoroditura dhe më të shëmtuara, që ka degraduar dhe degjeneruar rininë kosovare, është pikërisht kullerizmi. Nëse dikush mendon apo gjykon se kullerizmi është model edhe për rini të tjera të botës, atëherë do të isha shumë kureshtar të dija se cilat janë ato të mira nga ky model?! Çfarë ka këtu për t'u mburrur ose për t'u ndier krenarë për fëmijët tanë?

Meqë nuk jam prind i kësaj moshe rinie, do të doja të dija komentin e një prindi të një kulleri apo kullerke, se me çka do të mburrej ai prind për fëmijën e vet.

Sot, në mjediset ku gjallojnë njerëzia, nuk është shumë mund i madh për të identifikuar një kuller/e.

Veshja

Gjëja e parë që do të bie në sy tek ta është veshja.

- Tek meshkujt kullerë shfaqet një veshje ekstravagante, me pantallona të grisur, të gjerë, të lëshuar poshtë, pa rrip mbajtës dhe thuhetse prapanica u shihet nga aeroplani. Më këmisha asimetrike dhe me jaka të ngritura lart. Me bluza shumë të ngushta ose shumë të gjera, ose me dimensione të mëdha që më shumë u ngajnë xhamallëve, sesa njerëzve të rëndomtë. Shumë prej tyre kanë tatuazhe me domethënie dhe pa domethënie, por kjo s'është çudi, sepse vetë të qenit kuller nuk është domethënës.

- Tek femrat kullerka shfaqet një agresivitet edhe më i madh në veshje dhe një paradoks që më parë mund të ekzistonte vetëm në trillimin e ndonjë regjisori të çmendur.

Edhe tek femrat thuhetse trendi i veshjes është i ngjashëm ose i afërt me atë të meshkujve. Me pantallona shumë të ngushta ose të gjera dhe të shkurtra, të lëshuara poshtë, ku edhe atyre mund t'u shihet qartë gjysma e prapanicës, e në shumë raste u shihen 'mercedeskat' (të brendshme femërore me dimensione shumë të holla e që i ngajnë markës së Mercedesit, prandaj edhe e kanë marrë këtë emër). Pastaj me bluza apo këmisha të hapura në gjoks, me gjinj të tejngritur ku vetëm thithat sa nuk u shihen...

Gjuha

Po të përpiqemi të flasim për gjuhën e kullerëve, sigurisht se nuk do të arrijmë në asnjë lloj përfundimi nëse ata flasin ndonjë gjuhë apo të folme që ekziston apo ka ekzistuar ndonjëherë në trojet shqiptare. Në fakt, ata në vend të gjuhës përdorin një zhargon të vrazhdë që pakkush mund t'i kuptojë. Në



fjalorin e tyre nuk ka gjë tjetër veçse fjalë të shqiptuara për së prapthi si psh: /op/ për po, /ishmi/ për shihemi, /jush som lof/ për shuaj mos fol, /som u leç/ për mos u çel (mos hap debat), /sipat/ për pisat, /rofe/ për fore etj.

Pastaj fjalë të tjera të shqipes për me domethënie tjera, si: /shumë smut a/ për shumë bukur, mirë, /shumë naj s a/, pastaj fjalë miratimi /OK/ (angl.) për në rregull, /çao/ (ital.) tung, mirupafshim.

Pra, kjo nuk është asnjë lloj gjuhe, dialekt apo e folme, pos një konglomerat me grimcash e ndryësirash fjalësh e shprehjesh, ku motra, nëna janë caku i drejtpërdrejtë i sharjeve dhe i prekjeve në moralin familjar shqiptar, i cili është ruajtur me shekuj. Shprehjet më të zakonshme sharëse dhe ofenduese janë si: /ta q... motrën, ta ha mamin, t'i q... robtë/ etj.

Sjellja

Sjelljet e tyre në shoqëri, gjithashtu, janë paradoksale. Mënyra e të veshurit, e të folurit dhe qëndrimin në shoqëri nuk ua mundëson atyre të jenë ndryshe, pos paradoks. Shumica prej tyre janë të vrazhdë, injorantë, të çuditshëm, e si të tillë edhe të padëshirueshëm në shoqërinë e civilizuar. Shumë nga ta nuk kanë raporte të dëshiruara me prindërit e tyre. Shumë nga ta/to nuk janë nën sundimin hierarkik familjar. Mbi 60 % janë duhanpirës fanatikë, alkoolistë, narkomanë, klientë të rregullt të kafeneve dhe bareve të mesnatës. Dhe, duke qenë të tillë dhe të papunë, medoemos, janë ose bëhen diletantë e hajdutë. Shpesh mosmarrëveshjet i 'rregullojnë' me rrahje, therje ose edhe me vrasje. Në shkolla janë më problematikët, më të padëgjueshmit dhe më të dobët në mësim. Meqë kullerizmi ka prekur më shumë moshat e tinxherëve, si të tillë, edhe për disa vjet nuk mund të kenë ndonjë vizion për jetë. Raporti me gjininë e kundërt është i shpërqendruar. Ca prej tyre janë homo, lezbike, madje edhe biseksual.

Duke qenë kështu, larg kontrollit prindëror, shumë prej tyre manifestojnë incese brenda një rrethi të ngushtë fisnor.

Të gjitha këto që i cekta, janë gjykimet e mia ndaj kësaj dukurie, që, ndoshta edhe mund t'i kem gjykuar jo drejt.

Sidoqoftë, do të doja të isha gabim... ■

(vijon nga numri i kaluar)

Kur'ani si letërsi sublime

Kur'ani vlerësohet si një mrekulli e formës sublime që përshtatet në mënyrë absolute me një përmbajtje sublime dhe që shkakton një efekt sublim. Kjo mrekulli estetike apo letrare e Kur'anit u pranua nga të gjithë muslimanët si dëshmi për autorësinë e tij hyjnore.

Mimoza SINANI

Sublimiteti i formës

Muslimanët i kushtuan studimit të Kur'anit si vepër letrare dhe u përpoqën që të zbulonin sekretet e bukurisë dhe mrekullisë së tij, aspektet apo shkaqet që e bënin Kur'anin të papërballueshëm dhe të pakrahasueshëm.


Së pari, Kur'ani nuk është as poezi, as prozë e rimuar. E para përbëhet nga vargje identike në skemën e tyre metrike (numër, zgjatje, dhe pozicion të rrokjes) dhe rimë (bashkëtingëllore dhe vokalizim të rrokjes së fundit). E dyta është proza, fjalitë dhe frazat e së cilës theksohen prej një rime e cila mbahet gjatë gjithë veprës. Kur'ani nuk është asnjëra, ndonëse ai përmban diçka prej karakteristikave të të dyjave. Kur'ani bën përdorimin e lirë të tyre me qëllim që të nxjerrë në pah synimet e tij. Përdorimi nga ana e Kur'anit i elementeve të poezisë dhe prozës së rimuar është gjithmonë më i miri dhe më elokuenti, por ai nuk është

kurrë i tillë sa për të bërë të mundshëm ngjashmërinë apo pëshjtjellimin me to. Kjo është arsyeja se përse duhej shpikur një kategori e re për ta klasifikuar Kur'anin përtej poezisë dhe prozës, dhe pikërisht 'prozë absolutisht e lirë'.

Së dyti, ajeti kur'anor përbëhet prej fjalëve dhe frazave që i përshtaten domethënies në mënyrë perfekte. Diksioni i tij është gjithmonë i saktë dhe perfekt në mënyrë absolute. Çdo ndryshim, sado i vogël, është një ndryshim për keq. Asnjë fjalë nuk mund të kapërcehet pa prishjen e rrjedhjes dhe domethënies së vargut.

Së treti, fjalët dhe frazat kur'anore të një verseti, apo të një pjese të versetit, krahasohen apo vihen në kontrast në mënyrë perfekte me ato të frazës apo vargut paraprijës apo pasues, qoftë në ndërtim, qoftë në domethënie. Rrjedhja e fjalëve të tij shkakton kështu tensionin dhe shpresën më të madhe, qetësinë dhe kënaqësinë më të madhe të mundshme. Kjo cilësi e kompozicionit kur'anor

u





quajt tevazun apo balancë dhe ajo vepron si te forma, ashtu edhe te përmbajtja e tekstit.

Së katërti, fjalët dhe frazat kur'anore shprehin domethëniet më të pasura dhe më të fuqishme në format më të shkurtra. Ai nuk është kurrë fjalëshumë dhe asnjë fjalë nuk është kurrë e tepërt. Çdo parafrazim i një fraze, fjalie apo verseti, kërkon më tepër fjalë dhe gjithmonë shfaqet i zgjatur, artificial, fjalëshumë dhe rrjedhimisht, më pak i fuqishëm, më pak elokuent dhe më pak prekës sesa origjinali kur'anor. Megjithatë, shkurtësia nuk është parim absolut për t'u respektuar në çdo rast. Ekzistojnë shembuj në Kur'an në të cilët përsëritja dhe shtrirja janë të domosdoshme. Në këto raste ato kanë justifikimin e tyre të veçantë.

Së pesti, krahasimet dhe metaforat, konjunksionet dhe disjunksionet e koncepteve dhe urdhrave, përçojnë apelimin më të madh të mundshëm. Ato përplasen me imagjinatën me një forcë të tillë të fuqishme, sa që ato e lënë atë "pa frymë" në tronditjen dhe magjepsjen e saj. Për këtë cilësi unike të Kur'anit, estetët letrarë arabë shpikën termin 'sublimisht kreative'.

Së gjashti, kompozimi kur'anor është gjithmonë i përpiktë, si një vepër arti me perfeksionim absolut. Rrjedha dhe struktura e tij është krejtësisht e lirë prej zbrazëtirave apo pikave të dobëta. Ekzistojnë shembuj të shumtë ku një fjalë apo një frazë e tërë mungon, por domethënia është gjithmonë e qartë.

Fjala apo fraza munguese është hequr në mënyrë të qëllimshme, me qëllim që ta bëjë atë që i paraqitet vetëdijes akoma më të tendosur.

Së shtati, stili kur'anor është po aq i fuqishëm, emfatik dhe ngulmues, sa edhe i butë dhe delikat. Lexuesi mund ta ndiejë atë të bjerë si shkëmb mbi të, apo të bjerë me finesë dhe butësi të pafundme. Kjo është arsyeja se përse ai u quajt 'bukuria e rënies mbi vetëdije'. Qoftë kur ai murmurit si një krua i kulluar, qoftë kur godet furishëm si një përrua, qoftë kur kërcen dhe hidhet vetë me rrëmbim si një sulm kalorësie, ika-ja e tij është gjithmonë perfekte.

Së teti, kompozimi kur'anor nuk ka strukturë në kuptimin e zakonshëm të termit. Ai kombinon kohën e tashme, të shkuar, të ardhme dhe mënyrën urdhërore në të njëj-



tin fragment. Ai zhvendoset nga fjalimi raportues i personit të tretë tek personi i dytë adresues; nga deskriptivja tek normativja, nga pyetësja tek thirrmoja dhe nxitësja. Ai është përsëritës, ndonëse në çdo përsëritje përçohet një mesazh i ndryshëm.

Së nënti, teksti kur'anor nuk është i renditur as topikalisht, as kronologjikisht, mbasi qëllimi i tij nuk është as analiza sistematike, as raportimi, as historiografia. Ai është përmbi gjithçka, fillim e fund, trup i letërsisë në të cilin çdo frazë, varg, grup vargësh, apo sure përbën një njësi autonome, të plotë në vetvete, dhe njësitë janë të lidhura së bashku. Ndryshimi i papritur i kohës dhe tonit ushtron një fuqi më emocionale mbi imagjinatën. Përsëritja nuk është kurrë e tepërt meqë mësohet dhe theksohet një mësim i ri që bazohet në një aspekt të ri të një ngjarje tashmë të njohur. Asnjë rrëfim i Kur'anit nuk jepet për informacion. Më saktë, familjaritetin e pranuar të dëgjuesit me vijën e përgjithshme të ngjarjes apo ndodhisë, Kur'ani e përdor si mbartës për mësimin e ri që ai synon ta ngulitë në mendjen e dëgjuesit.

Së fundi, rrjedha e vazhdueshme e njoftimeve, përshkrimeve, dhënieve të llogarisë dhe leksioneve të Kur'anit synon që të të bindë dhe të të mbushë mendjen me anën e bukurisë dhe forcës së frazave, vargjeve, apo grumbullit të vargjeve të tij. Një person me kompetencën e nevojshme në gjuhën arabe ndoshta mund t'i rezistojë vetvetiu kërkesës së një vargu, apo një grumbulli vargësh; por asnjë nuk është i aftë që t'i rezistojë kërkesës që shfaqet nga rrjedha në dukje e pafundme. Rrjedha kur'anore gjeneron një energji që e dëbon mosbindjen e dëgjuesit dhe kokëfortësinë e tij me anën e goditjes së larmishme dhe e bart më në fund atë dëgjues në destinacionin e saj. ■

Në Prishtinë ka zhvilluar punimet Kongresi i Parë Ndërkombëtar Ballkanik
 “Historia dhe kultura e Ballkanit”

Kontribut shkencor për shtetin e ri

Osman D. GASHI

Në Sallën e Kuqe të Fakultetit të Filologjisë, më 11 dhe 12 maj është mbajtur Kongresi i Parë Ballkanik me temë “Historia dhe kultura e Ballkanit” i cili u organizua nga Universiteti i Prishtinës në bashkëpunim me Universitetin e Sakaria-s, në Turqi. Në hapjen solemne të Kongresit kanë marrë pjesë ministri i arsimit, shkencës dhe teknologjisë, prof. dr. Enver Hoxhaj, përfaqësuesi i Turqisë në Kosovë, Dogan Işık, përfaqësuesi i Universitetit të Sakaria-s, prof. dr. Recai Coşkun, prorektori për burime dhe infrastrukturë, prof. dr. Marjan Demaj, dekani i fakultetit të Filologjisë, prof. dr. Nuhi Rexhepi, dekani të fakulteteve të ndryshme në Kosovë dhe jashtë saj, profesorë e studiues nga Kosova, Shqipëria e Turqia.

Kongresin e ka shpallur të hapur prorektori i Universitetit të Prishtinës, prof. dr. Marjan Demaj i cili, pasi ka përshëndetur të pranishmit, ka theksuar se Universiteti i Prishtinës si një institucion i Arsimit të Lartë ka bashkëpunim me shumë universitete të botës dhe ky aktivitet e fuqizon këtë bashkëpunim

edhe më shumë. “Ky bashkëpunim po zgjerohet edhe në fushat e takimeve shkencore, siç është ky Kongres për historinë, kulturën, gjuhën, letërsinë, marrëdhëniet ndërkombëtare, ekonominë si dhe shkenca të tjera” - ka thënë Demaj.

Hoxhaj: Kongresi ka rëndësi të veçantë

Më pas të pranishmit i ka përshëndetur edhe koordinatori i këtij kongresi, përfaqësuesi i Universitetit të Sakaria-s, prof. dr. Recai Coşkun i cili ka theksuar se Universiteti i Sakaria-s ka një protokoll bashkëpunimi të nënshkruar me Universitetin e Prishtinës dhe dëshiron që ky kongres të jetë një ndihmesë dhe një kontribut për Universitetin e Prishtinës dhe për Kosovën. “Dëshira jonë është që të kontribuojmë diçka në shtetin më të ri të Ballkanit dhe të botës, kështu që mendoj se edhe kontributi në aspektin shkencor është i rëndësishëm” - ka thënë Coşkun.

Ndërkaq, ministri i arsimit, shkencës dhe teknologjisë, Enver Hoxhaj, ka thënë se në Kosovë janë organizuar dhe mbajtur shumë kongrese, por ky kongres është i një rëndësie të veçantë për arsye politike, historike dhe tradicionale. “Me luftën e

vitit '98-'99, me intervenimin e NATO-s, ka filluar të ndryshojë karakteri i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe me pavarësinë e Kosovës në vitin 2008, realisht, ka ndryshuar historia e Ballkanit, prandaj një fokus i tillë edhe nga universitetet turke është i mirëseardhur” - ka thënë Hoxhaj.

Dekani i Fakultetit të Filologjisë së Universitetit të Prishtinës, prof. dr. Nuhi Rexhepi, ka theksuar se pas Seminarit për Gjuhë, Letërsi dhe Kulturë Shqiptare, ky kongres është i dyti që organizohet nga Fakulteti i Filologjisë. “Tubimet me kaq rëndësi, siç është ky kongres, marrin vlera të pazëvendësueshme shkencore për të gjithë të interesuarit, për të gjithë punonjësit shkencorë që merren me këto fusha studimi. Jemi të bindur se kongresi do të sjellë prurje të reja dhe me vlerë në dobi të shkencës, duke ndërtuar një shumësi vlerash në një kontekst të gjerë ballkanik për t’iu përgjigjur vizionit për të shkuar drejt së ardhmes” - ka thënë Rexhepi.

Në këtë kongres dyditor, rreth 80 studiues nga Kosova, Shqipëria, Turqia dhe vendet e tjera të Ballkanit janë paraqitur me kumtesat e tyre, të cilat temë bosht kishin historinë dhe kulturën e Ballkanit. ■





Kultura në harresë

Fakulteti i Filologjisë e ka harruar traditën e aktiviteteve kulturore

Studentët ankohen për mungesë të përkrahjes, dekanati për mungesë të vullnetit për organizime, ndërsa të dyja palët ankohen për financa. Ku qëndron problemi?

Armend ATASHI

Fakulteti i Filologjisë ka një kohë të gjatë që e ka harruar traditën për aktivitete kulturore. Është e njohur mirëfilli se para luftës ky fakultet kishte një traditë të pasur sa i përket këtyre aktiviteteve. Edhe pse punonin në kushte të vështira dhe ishin të rrezikuar nga pushteti serb, studentët dhe mësimdhënësit e vazhdonin punën me qëllim që ta ngrinin vetëdijen letrare e kulturore. Shumë profesorë e kujtojnë me nostalgji grupin letrar “Jeronim de Rada” si dhe grupin recitativ “Aleksandër Moisiu”.

Mirëpo, sot kur janë të gjitha kushtet dhe mundësitë për zhvillimin e jetës kulturore, pasi që tanimë veç jemi bërë shtet dhe nuk na ndjek askush, ne nuk bëjmë asgjë dhe vetëm ia hedhim fajin njërit-tjetrit. “Pse të heq keq unë kur ka të tjerë për m’u marrë me atë punë? Jo është faji i atyre, jo i këtyre”. Këto janë disa nga arsyetimet, ndërsa faji për një neglizhencë të tillë duket se është i të gjithëve.

Një nismë të mbarë e kishte filluar Paqja Studentore e Universitetit të Prishtinës, konkretisht dega e kësaj organizate në Fakultetin e Filologjisë, me dy apo tri takime në fillim të vitit 2008, të cilat fatkeqësisht u ndërprejnë.

Edhe pse kemi mjaft data dhe personalitete të rëndësishme, për të cilët do të mund të organizohej në shenjë respekti dhe nderimi ndonjë manifestim sado i vogël qoftë, fakulteti ynë nuk zhvillon asnjë aktivitet.

Kishim njëvjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, apo data e fundit 24 Prilli, Dita Ndërkombëtare e Librit dhe e Mbrojtjes së të Drejtave të Autorit etj., por asnjë nga këto festa nuk u shënuan në hapësirat e filologjisë.

Përveç Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës që kishte një program për Ditën e Librit, për çudi duke shfletuar gazetën, shoh se atje diku në Zhur të Hasit të Prizrenit kishin organizuar një aktivitet kulturor për këtë ditë. Kjo, pa dyshim se është një vërejtje për fakultetin tonë.

Sipas prodekanit të Fakultetit të Filologjisë, profesor Osman Gashit, Universiteti dhe Fakulteti në radhë të parë janë institucione edukativo-arsimore dhe nuk janë të obliguar që të mbajnë ndonjë aktivitet kulturor për shënimin e datave të ndryshme.

Mirëpo, profesori Gashi nuk e mohon se gjithsesi që kemi shumë nevojë për aktivitete të tilla, duke pasur parasysh edhe traditën e pasur në të kaluarën. “Fakulteti edhe po të dojë nuk ka buxhet të destinuar për çështje të tilla, mirëpo studentët, konkretisht këshilli i studentëve, duhet të ketë vullnetin për të bërë diçka në këtë drejtim” - shprehet prodekan Gashi, duke i shpjeguar procedurat deri te përkrahja financiare, e cila duhet të vijë nga rektorati.

Profesori Osman Gashi shprehet i bindur se, megjithatë, me një vullnet më të madh do të mund të bëhej më shumë, mirëpo ai konsideron se si stu-

dentët ashtu edhe profesorët, nuk janë fort të prirë që të merren me aktivitete të cilat nuk janë të obligueshme.

Ai mendon se studentët do të duhej që në të shumtën e rasteve t’iu prijnë disa gjërave, ndërsa si aktivitet të përherëshëm kulturor të Fakultetit të Filologjisë ai përmend Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Kulturën dhe Letërsinë Shqiptare.

Pak më ndryshe mendohet në Këshillin e Studentëve të Fakultetit të Filologjisë. Kryesuesi i këtij këshilli, Burim Qorri, thotë se për shumë gjëra është përgjegjës Dekanati i Fakultetit, pasi që këshilli i studentëve nuk ka ndonjë buxhet të vetin.

“Edhe pse kemi bërë kërkesa për përmirësimin e kushteve të punës në të cilat punojmë, si dhe kërkesa të tjera, si financimi i një reviste etj., përgjigjja është s’ka mjete” - tregon ai.

Burim Qorri konsideron se patjetër që do të duhej të organizoheshin aktivitete kulturore për shënimin e datave të rëndësishme, në mos me iniciativën e studentëve, atëherë me iniciativën e dekanatit gjithsesi. Sa i përket sugjerimit të Dekanatit se Këshilli i studentëve duhet t’iu prijë gjërave, Qorri përgjigjet me humor. “Ne jemi më të vegjlit” - thotë ai.

Dhe derisa palët ia hedhin fajin njëra-tjetrës, festat dhe datat e rëndësishme shkojnë e vijnë, ndërsa gjeneratat e studentëve ndërrohen pa përjetuar madje asnjë manifestim kulturor gjatë tërë viteve të studimit të tyre. ■

Studim

Krahasimi në këngët e dashurisë

Kodi shënjes preket, ndërsa diskursi oral i këngëve të dashurisë shihet e formohet nga figurat, duke shkuar deri te figurat fizike e metafizike. Shkurt, variantet e leximit të figurave formohen e shqyrtohen në interpretim.



Flamur MALOKU

1. Teorizimi/Funksioni

Libri monografik "Poetika e krahasimit" i Zymer Nezirit, botuar nga *Instituti Albanologjik i Prishtinës*, 2004, në nivelin e përgjithshëm kategorial të analizimit është kërkim i veçantë teorizues/argumentues i figurave poetike të krahasimit në këngët tona popullore të dashurisë. Duke e aplikuar gjithnjë teorinë semantike gjatë analizimit/hetimit, figurat e krahasimit dalin dhe bëhen modele shënjesuese gjatë venerimit në strukturën e tekstit-kërkimit. Për të argumentuar figurën e këngëve, së pari bëhet modeli për aplikim, model nga i cili analizohet *figura/sistemi/diskursi*.

Nga ky trinom *figurë/sistem/diskurs*, që njëherësh është edhe trinom *teorik/aplikues*, Zymer Neziri bën sistemimin e vazhdueshëm të këngëve, ku komunikimi me figurën do të bëhet i dyfishtë, nga *estetika e semantika*. Një relacion i këllillë i kërkimit në rrafshin e përgjithshëm nënkupton esencat kryesore të shqyrtimit, çdoherë në funksion të argumentimit e identifikimit. Identifikimi i figurës në shtresa të këngëve, kryesisht në rrafshin teorik e semantik, formon vetvetiu metodën e krahasimit. Figurat e krahasimit në këngët e dashurisë, ajo e *djalit-vajzës*, e vënë në funksion çdoherë interpretimin, por edhe vetë figurën e kërkuar në botën, diskursin e këngëve të dashurisë. Duke e pasur të qartë funksionin e këtyre dy figurave, pra *djalit-vajzës*, do të theksohet gjatë shqyrtimit konotacioni estetik i tyre. Prandaj, gjithnjë funksioni estetik në diskursin e këngëve të dashurisë, bëhet

nga shenjat semantike, të cilat theksohen duke u lidhur esencialisht me argumentimin. Nocionet operative, të shtruara në analizimin e përgjithshëm teorizues, reflektohen nëpërmjet *shkrimit/këngëve/figurave*.


2. Premisat estetike

Variantet e figurave nëpër diskursin e këngëve nisen e thellohen, gjithnjë mbi kategorizimin poetik të krahasimit. Kodi shënjes preket, ndërsa diskursi oral i këngëve të dashurisë shihet e formohet nga figurat, duke shkuar deri te figurat fizike e metafizike. Shkurt, variantet e leximit të figurave formohen e shqyrtohen në interpretim. Kështu, Zymer Neziri përgjatë hetimit të premisave estetike çdoherë ndjek lin-

jën dy figurave poetike, *djalit-vajzës*, që njëherësh janë dy figurat kyçe në këngët e dashurisë. Përshkrimi e analizimi i tyre në tërësinë strukturuese të monografisë jep rëndësinë e veçantë të figurave *djalit-vajzës*. Identifikimi e krahasimi i mundshëm estetik, në këngët e dashurisë, në esencë sforcon poetikën e krahasimit, që del çdoherë mbi pikat e venerimit, siç thekson Zymer Neziri: "Krahasimi hap, plotëson ose përmbyll pamjen poetike; është fillues, shpalues, përfundues a varg qendror në strukturën e këngës; është hapës i dialogut lirik dhe ngritës i tensionit erotik; provokues i rrjedhave dhe i situatave shqetësuese të përjetimit; zbulues i veçorive psikologjike dhe etnopsikologjike; zgjues i parafytyrimit vizual të prerë, të jashtëzakonshëm, të shkallëshkallshëm ose të përnjëhershëm dhe shprehës i larushive të kufizuara të ngjyrave". Ky përkufizim përgjithësues, argumenton vlerën e funksionit të poetikës së krahasimit, estetikën e realizimit përgjatë këngëve të dashurisë.

3. Objekti krahasues

Objekti krahasues i figurave, i *djalit/vajzës*, i kërkuar në këngët e dashurisë, ndërlidhet esencialisht me kuptimet e shumta. Dihet se kërkimi i kuptimeve të figurave dhe zbërthimi i tyre kërkon njohje e (dije) të madhe të botës semantike. Kjo për Z. Nezirin nuk paraqet problem, sepse njohja e botës semantike e kuptimor në zbërthimin gjeneralizues bëhet argumentues gjatë aplikimit. Nga kërkimi i kuptimeve të vazhdueshme dhe aplikimi i kuptimeve që diskursi/figura e këngëve të dashurisë ofron, në esencë zgjidhen edhe nyje të shumta. Nyejt e zgjidhura, nga aspekti teorik, në planin përcaktues theksojnë atë që quhet pamje poetike në rrafshin kategorizues/krahasues të këngëve. Duke elaboruar figurat e shumta, Z. Neziri thekson edhe **shtresëzimin** e situatave, të ngjarjeve. Siç vë në dukje, edhe në figurat për djalin, situatat e ngjarjet kodifikohen kryesisht të mbështetura në rrafshin *objektiv/krahasues/humanizues dhe janë të mbështetura në objekte krahasuese prej rrafshit*



krahasues tokësor e deri tek ai kozmik. Megjithatë, në krahasim me vashën, këto figura janë shumë më të pakta në numër, por shprehjen e tonit lirik popullor e pasurojnë me një ngjyrim pamjesh poetik humanizues që nga shfaqja e ndjenjave të thella intime erotike e deri të pamja madhështore dhe epike e trimit. Ecja nëpër këtë vijë të kërkimit konceptualizon kategorinë e përbashkët të figurës me objektin krahasues. Kjo edhe hap rrugën e mundshme drejt fenomenit të figurës, si veçanti vlerësuese në këngët popullore të dashurisë. Variantet ilustrative të këngëve bëhen variante themelore mbi parimin e ndërsjellë estetik. Tiparet përshkruese të *djalit/vajzës* bëhen me interes të veçantë aplikues. Nga tiparet e përshkuara, vetvetiu, këngët e dashurisë, së bashku me figurat e *djalit/vajzës*, bëhen dialogim shpalues përgjatë përshkrimit, të vetë bukurisë poetike. Pamja e djalit me ngjyrimet e shumta bëhet atribut i kategorisë estetike. Mbi këtë, edhe akti artistik i përjetimit gjatë leximit bëhet i ndjeshëm, i ndërtuar e i rindërtuar mbi bazën e figurës së krahasimit. Nga pamja poetike djali përkufizohet, ndërsa ana e brendshme psikologjike e emocionale mjeshtërisht *shtjellohet/përkufizohet*. Pra, lexohet figura e djalit nëpërmjet simbolikës-figurshmërisë së këngëve. Prandaj, mund të hetohet se edhe është një hetim e analizim, gjithnjë mbi simbolikën e kuptimit. Shtrirja e ngadalshme në përshkrim, bëhet deri te hulumtimi i variacioneve, që prodhojnë këto dy figura. Thellimi e përshkrimi i të gjitha esencave, bëhet shumëfish, nga një pozicion reflektues e përkufizues. Nga kjo shihet që libri monografik i Zymer Nezirit "Poetika e krahasimit" nuk është ndërtuar nga evidenca e skema e një interpretimi pozitivist, por është metodë krahasuese, metodë e cila përcakton gjithnjë esencën teorike/semantike. Nëpër disa nyje objekti poetik krahasues bëhet domen i një sistemimi të veçantë, sistem ky që i ka munguar deri më sot letërsisë sonë popullore, në veçanti dy figurave kryesore djalit/vajzës në këngët e dashurisë. Pra, për herë të parë, Zymer Neziri rikthen në interpretimin tonë vlerën e diskursit, vlerë kjo e identifikuar përgjatë objektit analizues. ■

(Shkëputur nga një studim i gjatë)

Lajme kulturore

Përrurohen 10 libra të përkthyer nga gjuha turke

Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsim - AKEA në bashkëpunim me shtëpinë botuese "Logos-A", në Institutin Albanologjik të Prishtinës ka bërë përrurimin kompletit të 10 librave të rinj të nga gjuha turke, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe botuar nga kjo shtëpi botuese. Përkthimi i këtyre 10 titujve nga fusha të ndryshme të dijes, nga autorë të njohur të inteligjencës, letërsisë dhe të shkencës turke, ka një rëndësi të veçantë veçanërisht për kulturën shqipe, pasi dy nga autorët e përkthyer kanë lidhje, jo vetëm kombëtare, me kombin tonë. Në mesin e tyre gjendet edhe gjeniu i madh i kombit tonë, Sami Frashëri, me veprën e tij "Qytetërimi islam" dhe poeti i kombit turk me origjinë shqiptare Mehmet Akif Ersoj-Pejani.

Studiuesi dhe publicisti, Milazim Krasniqi, duke çmuar punën e bërë nga SHB "Logos-A" në përkthimin dhe botimin e këtij kompleti në gjuhën shqipe, ka konsideruar se botimi i vlerave të letërsisë turke në gjuhën shqipe është një e mirë e veçantë për kulturën tonë. "Botimi i poezisë së Mehmet Akfi Ersoit në gjuhën shqipe ofron një mundësi të mirë që të njohetemi nga afër me vlerat artistike të tij dhe vlerat e mëdha njerëzore të këtij intelektualit. Mehmet Akif Ersoj është poet turk, autor i himnit të shtetit turk, por prejardhja e tij shqiptare bën që të jetë edhe pjesëtar i vlerave poetike dhe kulturore shqiptare"

– ka thënë studiuesi Krasniqi, me rastin e promovimit të këtyre 10 veprave nga "Logos-A". Veprat e botuara të Logosit nga gjuha turke janë: "Fletët" (Safahat) të Mehmet Akif Ersojit; "Qytetërimi Islam", nga Sami Frashëri, "Kultura dhe Qytetërimi" nga Jëllmaz Ozakpënar, "Tri Çështjet, teknika-civilizimi-tëhuajësimi" dhe "Erbaini"- (poezitë e dyzet vjetëve) nga Ismet Ozel, "Transformimi qytetërimor dhe bota myslimane" dhe "Kriza globale (Debate rreth 11 Shtatorit)" nga Ahmet Davutoglu, "Antologji e poezisë klasike turke" – Poezia e Divanit nga Mustafa Cipan, "Brenge" - (poezi) nga Nexhip Fazëll dhe "Kokë më kokë me të rinjtë" e Ali Fuad Bashgilit. ■



Alban Skenderaj fitues i "Video-fest 09"

Këngëtari Alban Skenderaj, ka fituar çmimin kryesor "Best Video", në edicionin e sivjetmë të "Video-fest 09" që është mbajtur në Teatrin Kombëtarë të Kosovës.

Grupi tjetër që ka marrë më së shumti çmime është ai nga Kosova, Troja të cilët kanë rrëmbyer tri çmime, çmimin e publikut, videoklipi më i mirë në kategorinë rok dhe në konkurrencën e grupeve.

Çmimi i karrierës i është dhënë vet-

eranes së muzikës se lehtë në Kosovë, Liljana Çavolli.

Çmime kanë fituar edhe Elvana Gjata, Shpat Deda, Mihrije Braha, "NRG" Band, Hana Cakuli, "Da Ghost", "Capital T", "2PO2" dhe Dafina Zeqiri.

Befasi e festivalit ka qenë rap-këngëtari i njohur i viteve '90, "Nana" i cili ka mbajtur një koncert të vogël para adhuruesve të tij në Sheshin përpara teatrit. ■

Përgatiti: **Esat VATOVCI**

Monografi për studentët e gazetarisë

Duke marrë përvojat e universiteteve evropiane dhe amerikane, Demir Reshiti ka botuar librin monografik të titulluar "Libri i Gjeneratës", që i përkushtohet studentëve të gjeneratës së dytë të degës së gazetarisë së Universitetit të Prishtinës. Autori i librit, ka thënë se praktika të tilla duhet të ndiqen edhe nga degë tjera të UP-së

Hekuran AVDYLI

Krijuesi Demir Reshiti këto ditë është paraqitur para lexuesve me një libër monografik të titulluar "Libri i Gjeneratës", që i kushtohet studentëve të gjeneratës së dytë të degës së gazetarisë së Universitetit të Prishtinës.

Libri hapet me një parathënie të autorit ku përshkruhet ideja dhe mënyra e hartimit të kësaj monografie. Autori sqaron se ideja për botimin e librit i ka ardhur duke parë përvojat e universiteteve me renome botërore. Reshiti tregon se ka hartuar një pyetësor të cilin ua ka bërë studentëve dhe në bazë të përgjigjeve që ka marrë, ka ndërtuar profilin e kolegëve të tij studentë.

"Një pjesë e studentëve preferuan të përgjigjeshin paksa me humor, gjë

që e bënte edhe më joshës leximin e përgjigjeve. Një pjesë tjetër ishin shumë seriozë" - thekson Reshiti.

Në monografi janë përfshirë edhe mendimet dhe vlerësimet e 20 profesorëve për këtë gjeneratë. Sipas vlerësimeve të profesorëve, del se mediat e Kosovës kanë ku të drejtohen për të



kërkuar kuadro për gazetari.

"Vlerësimet" e profesorëve ishin nga më të ndryshmet. Kishte nga ata që i lavdëronin studentët shumë, kishte edhe asi që i kritikonin, por përfundimi i të gjithëve ishte: se e duan këtë gjeneratë dhe presin nga ajo të dalin emra të njohur të gazetarisë" - ka thënë Reshiti.

Një historik i shkurtër i degës së Gazetarisë, studentët bursistë nga kjo degë, çmimet që kanë fituar këta studentë, pjesëmarrja e tyre në Universitetin Veror të gazetarisë në Ohër, etj, janë disa nga kapitujt e shtjelluar në këtë monografi.

Krahas vlerësimeve të profesorëve, janë portretet e 48 studentëve të kësaj gjenerate, të prezantuara me fotografi dhe me rrëfime interesante për çdonjërin veç e veç, që e bëjnë librin më joshës për lexim.

Libri është botuar në kuadër të edicionit botues të Universitetit të Prishtinës. ■

Pse dhe si të lexohet?



Jeton ISUFI

Një autor shkruan me qëllim që të nxitë shoqërinë dhe rininë në veçanti për të lexuar. Të rinjtë kanë shumë nevojë për formim intelektual në nivel individual dhe kolektiv. Prej mjeteve më të shfaqura në këtë drejtim është leximi i frytshëm. Ai i ndërton shoqëritë dhe të rinjtë dhe i bën ata më rezistues ndaj kulturës së huaj, kurse rinia lexuese bëhet më me ndikim të tjerët dhe ndikohet më pak nga kulturat e tjera. Leximi i gjerë dhe shfletimi i llojlojshëm, përcjellja e botimeve të reja e ngjall oreksin për të shfletuar çdo të re. Një autor amerikan thotë: "Sa më shumë zmadhohet ishulli i njohjes, aq më shumë shtohet zgjerimi i bregdetit të sekreteve" Me lexim njeriu i shkurton hapësirat, përfiton nga përvojat e tjerëve, i lartësohet mendimi, i mprihet mendja, i shpejtohet perceptimi, i zgjerohet diapazoni, i pasurohet njohuria, i shtohet kultura, i zmadhohet ambicia, i përmirësohet mendimi, i kalitet personaliteti, i përqendrohet gjuha, i shtohen argumentet, i forcohen faktet, i lartësohet pozita dhe i njihen meritat. Një studiues thotë: "Një specialist bashkëkohor duhet të llogarisë se prej 10-20%

të informatave të tij janë vjetruar dhe ato duhen ripërtërirë." Edhe kulturat përjetojnë pleqërim nëse ato nuk kaliten dhe ripërtërihen me shfletim të përhershëm dhe përcjellje të të rejave dhe të dobishmes që mos të dobësohet njohja e depouar që e kemi në trurin tonë. Njeriu duke vazhduar me lexim dhe shfletim të lirë lartësohet në shkallët e kuptimit, perceptimit dhe njohjes. Burimet e informatave dhe mjetet e shtimit të dijes janë të shumta, mirëpo më i dobishmi dhe më themelor në përgjithësi është libri, i cili është miku dhe shoqëruesi më i mirë dhe është më i lirë nëse krahasohet me mjetet e tjera.

Sa bukur e përshkruan librin një poet i shquar:

*Ndërrova librin me miqtë
Mirëpo nuk gjeta besnik si libri askënd*

Pikat në vijim shpjegojnë më tepër për leximin, vështirësitë e tij në fillim, për librin dhe rëndësinë e tij:

1. Fillimi zakonisht është i rëndë dhe pjesa më e vështirë është etapa e parë. Ndoshta nga shkaku i vështirësisë së saj është e dobësia e rezultateve të saj, sepse rezultatet nuk përballen me mundin e dhënë. Ai që merret me vrapim në vazhdimësi, fiton aftësi dhe shkathtësi. Po ashtu, edhe leximi ka nevojë për stërvitje dhe vazhdimësi, derisa lexuesi të fitojë aftësinë e mjaftuar, duke krijuar edukatë të leximit të këndshëm.

2. Prej gjërave që të shtyjnë në lexim është posedimi i një

librarie të përshtatshme shtëpiake, e cila përmbledh libra të rinj e të dobishëm, nga të gjitha sferat e dijes. Pastaj duhet përcaktuar një kohë për të shfletuar raftet e librave dhe duke ia dhënë hakun që e meriton.

3. Secili njeri ndikohet nga shoqëruesi i tij pa vetëdije. Ai që shoqërohet me njerëz të thjeshtë dhe pleq, përfiton prej tyre shumë gjëra nga përvoja, ai që shoqërohet me intelektualë dhe mendimtarë, nuk është i barabartë me ata që shoqërohen me masën e gjerë. Andaj njeriu duhet të zgjedhë ata që i bëjnë dobi dhe ia shtojnë dijen. Le të kujdeset të lidhet me miqtë e librit, duke caktuar një ndenje të veçantë, ku do të shpalosin atë që kanë lexuar dhe të përcjellin gjërat e reja.

4. Njerëzit zakonisht kanë shumë kohë të lirë. Po qe se e shfrytëzojnë me lexim të dobishëm, do të ankoheshin nga koha e ngushtë, e nuk do të mërzhiteshin e as nuk do t'i mërzhitnin të tjerët. Lexuesit e devotshëm ankohen nga vjedhësit e kohës të cilët nuk bëjnë gjë tjetër veçse e humbin kohën me gjëra të pavlera dhe të ulëta.

5. Leximi nuk preferohet dhe nuk i jep frytet e veta përveçse në momentet kur mendja është e kthjellur dhe e gjallë, atëherë kur nuk është e preokupuar me angazhime, është i qetë dhe nuk është nën ndikimin e stresseve.


6. Preferohet që lexuesi të ketë afër vetes fjalorë dhe leksikonë të ndryshëm, që të mos ndërpritet leximi, kur të ketë nevojë që të shfletojë fjalorin për ndonjë fjalë të panjohur ose të paqartë.

7. Nuk duhet shikuar sasia e të lexuarit, por rezultati dhe fryti i vjelë nga leximi dhe shfletimi. Kjo duhet të shfaqet në moralin, sjelljen, gjuhën dhe shprehjet, të cilat përshkruajnë gradën dhe përcaktojnë formën e kulturës së lexuesit. Nëse lexuesi vepron sipas asaj që përfiton, kjo bën që ajo dije të mbetet dhe të ngulitet më fuqishëm në mendjen e tij. Me fjalë të tjera, duhet munduar që atë që e lexojmë edhe ta praktikojmë në mënyrë që të mbetet në mendje.

8. Ai që lexon një libër duhet të ketë me vete laps, me të cilin shënon mendimet interesante të librit, ose që i regjistron në ndonjë vend të caktuar, të cilat mund t'i shfletojë kur të dëshirojë.

9. Ai që dëshiron të vlerësojë ndonjë libër, le të lexojë hyrjen e autorit, e cila i mundëson atij që të gjykojë metodën e autorit, cilësinë e shprehjeve dhe forcën artistike që ato kanë. Nëpërmjet hyrjes, lexuesi e kupton se ai libër është pishtar në atë lëmi, është replikë ndaj ndokujt, është shtesë e ndonjë teme të përpunuar më herët, është sqarim i ndonjë çështje të caktuar ose është pjesëmarrje në zgjidhjen e ndonjë çështje në hapësirën e kulturës, ose teme të caktuar etj. Le të lexojë edhe përmbajtjen e librit, që të shohë planin e plotë të librit, unitetin tematik dhe gjithpërfshirshmërinë e lëndës. Le të shfletojë referencat e librit, në të cilat është mbështetur autori gjatë përpilimit të librit, me të cilat zbulon qëllimin e autorit dhe të cilat paraqesin animin e tij shkencor. Pa dyshim se leximi i shumtë dhe vazhdimësia në lexim krijojnë të njeriu forcë nëpërmjet së cilës e njeh librin e dobishëm për të dhe i garanton përfundim të shpejtë.

10. Lexuesi medoemos duhet ta zgjerojë leximin e tij. Leximi i tij nuk duhet të jetë i përzgjedhur në një rrafsh të caktuar shkencor, por duhet të jetë i gjerë dhe gjithpërfshirës, me qëllim që mendimi i tij të çlirohet nga kufizimet partiake,



rajonale dhe që ai të mos të mbetet i lidhur pas ndonjë gjëje që ia frenon pikënisjen. Ai duhet të jetë i vetëdijshëm për dijen që i duhet rinisë së sotshme që të jetojë me cilësi, aktivitete dhe që të ketë mundësi të përballet me sfidat ekzistuese.

11. Libraritë duhet të posedojnë libra të shumtë dhe të llojllojshëm, duke filluar nga ata nën themelore, referenca të përgjithshme, enciklopedi të ndryshme, fjalorë, tekste, komente të ndryshme për nga madhësia, libra të veçantë për specializim, libra ideologjike, për kulturë të gjerë, divanet me poezi, romanet botërore, etj.

12. Shumë njerëz lexojnë, mirëpo në mënyrë sterile. Ata që lexojnë në mënyrë të mirë janë ata që kanë mundësi të shfrytëzojnë këtë në librat dhe jetën e tyre. Ata nuk lexojnë me dorëzim dhe skajim të logjikës, por lexojnë me logjikën kritikuese të veçantë, duke detyruar logjikën që të polemizojë në çdo gjë, qoftë e madhe apo e vogël. Leximi kritik është stërvitje shumë e madhe.

13. Lexuesi nuk duhet ta mohojë natyrën dhe animet e tij natyrore. Ai duhet të ketë personalitet të pavarur dhe të jetë larg ndikimit të shpejtë nga të tjerët.

14. Lexuesi duhet të sigurohet se sa më shumë që lexon dhe shfleton, aq më tepër e shton kuptimin dhe pjekurinë.

15. Le të jetë preokupim i lexuesit që në fund të secilit libër që e ka lexuar të japë një vlerësim preciz librit duke e përmendur edhe kohën e përfundimit të leximit.

Libri, përveç dobive të përgjithshme dhe vlerave të mëdha që ka, është pasuria më e ndershme dhe bukuria më e çmueshme. Libri është miku më i sigurt, shoqëruesi më i gëzueshëm, shoku më i pastër dhe profesori më orator. ■

Poezi

Fyell i lënë mbi një gur

Korbat mbi varrezat

1.
Ndërmjet muzgut e dritës së hënës
Seç m' ia shprushën plagët Nënës.

Zgjojen mallkimet, ringjallen Hijet
Vriten ëndrrat, digjen Yjet.

Kohë e arkivoltë –
Mbretëron mbi Botë.

2.
Një mijë e një herë ke për të vdekur
Më thanë,
Tek Guri i Plakës s' ke për të arritur.

Zgjojen dhembjet, ngjallen kujtimet
Bastisen kafkat, avancohen krimet.

Trokasin portat, trokasin vargjet
Mbrohen kullat, mbrohen pragjet.

3.
Korbat –
Me sy të përgjakur,
Me leksik të prishur.

Një mijë e një herë ke për t'u syrgjynosur,
Më thanë,
Në Varrezat e Arbrit s'ke për t'u varrosur.

Ata – sinonim të djallit,
Ata – sinonim të shkrumbit dhe të hirit.

Ndërmjet tmerrit e dritës së hënës
Seç m' ia prishën gjumin Nënës...

Verbimi i Poetit M. B.

I mbështjell në Enigmë,
Mediton në terr.

Në Orët e Vona
I ndez qirinjtë.

Me Kitarën e Jusufit –
Nis këngën në vend të vajit.

I vetmuar në Breg
End pëlhurën e blerimit.

Nën dritë të Hënës –
Ëndërron fytyrën e Nënës.
Duke pritur Godonë
Rron me metafora...



Milaim BERISHA

Fyell i lënë mbi një gurë

1.
Koha ime –

Sprovë në vazhdime.

Mijëra ofshamë,
Milionat mallkime.

Pritje të gjata
Në shtrëngata.

Net' të tëra
Pagjumësie.

Pakëz ëndrra
Dashurie...

2.
Jeta ime –

Grevë në vazhdime.

Biografi –
E pashkruar.

Urnë e ndezur,
Në qivur.

Fyell i lënë –
Mbi një gur...

Duke pritur agimet

Në Natën e Muzave
Ëndërrojme takimet.

Lugjeve me gjemba,
Brigjeve me pisha.

Pastaj –
I kremtojmë ditëlindjet
Për t' ikur nga vdekjet:

- Duke ikur nga vdekja
Me vdekjen takohemi. *

Jetojmë në ankth –
Duke pritur agimet...

Si ta ofrojmë ndihmën e parë në mënyrë të drejtë?

Bernard TAHIRBEGOLLI

Ndihma e parë konsiston në kryerjen e të gjitha veprimeve, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për ruajtjen e jetës së një të plagosuri rëndë. Kjo ndihmë fillon që në momentin e parë kur ndodh aksidenti deri në momentin kur i lënduari merr një ndihmë mjekësore të specializuar.

Shpeshherë kur njerëzit ballafaqohen me të aksidentuar që u kanë pushuar frymëmarrja dhe zemra nuk e kanë as idenë më të vogël se si veprohet në këto raste. E kur veprojnë, ata veprojnë gabim dhe e acarojnë situatën edhe më tej.

Ndihma e parë në një aksident rrugor

Së pari, shmangni panikun dhe turmën e njerëzve rreth të aksidentuarit, thirrni ndihmën e shpejtë dhe vazhdoni me:

I. Nxjerrjen e të aksidentuarit nga automjeti

Viktima e aksidentit rrugor duhet trajtuar me kujdesin të madh. Duhet të shmangen veprimet e dhunshme, përkatësisht lëvizjet e tepruara. Nxjerrja e të aksidentuarit nga makina e goditur duhet bërë me shumë kujdes, jo të tërhiqet menjëherë. Nëse rrobat i kanë ngecur diku grisni rrobat e assesi mos e tërhiqni prej rrobave për ta nxjerrë të aksidentuarin nga automjeti.

Në radhë të parë duhet të kujdeseni për kokën, fytyrën, kraharorin. Këto pjesë të trupit duhet t'i zhblokoni në fillim, në mënyrë që nëse keni nevojë ta realizoni frymëmarrjen artificiale dhe masazhin kardiak.

Shtylla kurrizore dhe koka mundësisht duhen lënë në pozicionin në të cilin janë gjetur. Nëse i aksidentuari duhet lëvizur atëherë duhet të siguroheni që koka, qafa dhe kraharori të mbahen në pozicion të qëndrueshëm.

Pasi nxirret nga automjeti, i aksidentuari shtrihet me shumë kujdes mbi një batanije ose diçka

tjetër që keni përreth. Pozicioni në të cilin duhet ta vendosni të lënduarin është me fytyrë përpjetë dhe koka duhet të jetë më ulët se kraharori.

Aksidentet e rënda zakonisht lënë të lënduar pa ndjenja. Veprimi i parë që duhet të bëni është të kontrolloni frymëmarrjen dhe të rrahurat e zemrës.

Mos e braktisni të aksidentuarin, i cili nga pamja e jashtme duket sikur e ka humbur jetën, sepse mund t'ia shpëtoni jetën nëse veproni shpejt duke i dhënë frymëmarrje artificiale dhe duke i bërë masazh të zemrës, deri në momentin e arrijtes së ambulancës, gjegjësisht ndihmës profesionale.

Ndalja e frymëmarrjes bën që, për pak minuta, të pushojë edhe zemra, e pas pushimit të zemrës dhe frymëmarrjes ndalon shpejt JETA e të aksidentuarit.

II. Nëse i lënduari ka rrahje të zemrës por nuk ka frymëmarrje?

Kjo vërehet lehtë më sy. Nuk ka ngritje e ulje të gjoksit dhe ju nuk ndieni lëvizje nga ajri i nxjerrë. MENJËHERË filloni frymëmarrjen nga goja!

a - Vendoseni të lënduarin në shpinë mbi një sipërfaqe të fortë. Pastrojani gojën nga të vjellat, trupat e huaja (protezat, gjuha, etj).

b - Hapni rrugët e frymëmarrjes me dy gishta (treguesin dhe të mesmin).

c - Mbylljani hundën me një dorë dhe me dorën tjetër uljani mjekrën duke ia hapur gojën. Merrni frymë thellë dhe jepini dy herë frymë. Nëse ka punë të zemrës prit pesë sekonda dhe vazhdo njëllë, derisa të vijë ndihma e shpejtë.

III. Nëse i lënduari nuk ka frymëmarrje dhe rrahje të zemrës?

Si të dimë se a ka ndaluar zemra apo jo? Këtë e bëjmë duke e kontrolluar pulsën. Zakonisht në qafë, nga të dy anët, janë dy arterie të cilat në qoftë se zemra rreh, edhe ato pulsojnë duke dhënë ndjenjën e një goditje të vogël dhe të vazhdueshme ndër gishtërinjtë tanë. Nëse nuk ka puls atëherë

Lëvizja e tepruar e të aksidentuarit është arsyeja kryesore e shfaqjes së gjendjes së shokut dhe e komplikimeve të tjera.

duhet të vazhdohet me masazh. Masazhi i zemrës përdoret së bashku me frymëmarrjen gojë më gojë, për të mbajtur në lëvizje gjakun nga një zemër që ka pushuar. Masazhi e zemrës konsiston në shtypjen e gjoksit në qendër me 80 shtypje në minutë në kor-

relacion me frymëmarrjen. Bëhen 15 shtypje/2 frymëdhënie.

IV. Ndihma e parë në rast gjakderdhjes

Veprimi i radhës, pas atyre që u përmendën, është ndalimi i gjakderdhjes, fashimi – mbështjellja e pjesës nga ku del gjak. Së pari duhet të vendoset një kompresë sterile dhe të shtypet konstant mbi zonën nga e cila rrjedh gjaku. Nëse është e mundur ngrijeni pjesën e dëmtuar mbi nivelin e zemrës. Vazhdoni kështu deri sa të arrijë ekipi i specializuar mjekësor, apo të arrini në qendrën e parë mjekësore. Nëse ka thyerje kockash duhet bërë imobilizimi i tyre duke i mbajtur pa i lëvizur deri sa të arrijë në qendrën shëndetësore.

KUJDES NËSE NË TRUPIN E TË PLAGOSURIT GJENDET MJETI ME TË CILIN ESHTË LËNDUAR MOS E LARGONI NGA TRUPI!!! Ngase shkaktoni gjakderdhje më të madhe dhe i aksidentuari mund të vdesë menjëherë nga gjakderdhja.

Nëse ka më shumë se një të aksidentuar?

Duhet vepruar sipas gjendjes së secilit të aksidentuar dhe rrezikut për jetë:

-Të parët që marrin ndihmën janë ata që kanë ndalje të zemrës dhe frymëmarrjes, ata që kanë gjakderdhje të mëdha të cilat nuk pushojnë edhe pasi i kemi lidhur, ata me gjakderdhje të brendshme, ata me plagë të mëdha në kraharor dhe ata në gjendje shoku.

-Të dytët që marrin ndihmën janë ata që kanë gjakderdhje të cilat pushojnë pas lidhjes, ata me plagë të mëdha në bark, prerje të gjymtyrëve dhe shkatërrim të muskujve ose kockave.

-Në radhë të tretë për ndihmë janë rastet kur i aksidentuari ka traumalëndime kranio-cerebrale (lëndime në kokë), lëndime në shtyllën kurrizore ose komblik. ■

Detyra kryesore e personit i cili jep ndihmën e parë është ruajtja e jetës.

Shkëlqimi dhe rënia e Arie Haanit

Alban BILALLI

Të gjithë e njihni dhe i mbani mend golat e tij të shënuar në Kupën e Botës. Është një trajner shumë i kompletuar dhe një ish-futbollist mjaft i njohur dhe me mjaft arritje” - pati deklaruar drejtuesi i federatës shqiptare të futbollit Armand Duka, pas zyrtarizimit të emrit të Haanit, më 27 dhjetor 2007. Jo vetëm Duka por edhe skeptikët me të mëdhenj ishin të mendimit se Arie Haani do të krijonte një mini-Holandë. “Edhe Holanda para viteve 1970 ishte një vend i vogël në botën e futbollit, por ju, besoj se i njihni sukseset e saj. Ajo që ndodhi me Holandën mund të përsëritet edhe në Shqipëri. Unë kam bindjen se do të arrijmë të krijojmë një kombëtare të mirë” - ishte deklarata e parë publike e Haanit. Realitet tani prej asaj deklarate është krejt tjetër. Arie Haani nuk arriti ta mposhte as një ekip si Malta, e cila është ndër kombëtares më të dobëta në botë. Në fakt, Shqipëria në Tiranë e mposhti 3-0 Maltën, por në Maltë barazoi 0-0, për dallim nga shtet e tjera që e kanë mposhtur Maltën në Valletta. “Ju e dini se kush jam unë dhe besoj se më mjafton një kohë e shkurtër për të njohur ekipin” - ishte deklarata e bujshme e Haanit. Futbollistë të mëdhenj të përfaqësueses sonë e pritën me kënaqësi mbërritjen e Haanit, duke theksuar faktin se holandezi pëlqente stilin sulmues të lojës, por në fakt në shtatë ndeshjet zyrtare të kombëtares sonë, Arie ka dëshmuar se preferonte më shumë mbrojtjen, duke luajtur gjithmonë me një sulmues të mirëfilltë: vetëm 3 gola në 7 ndeshje, është statistika e tij. “Për mendimin tim, gabimi i parë i Haanit ka të bëjë me deklaratën e tij të kahershme për një Shqipëri sulmuese. Kjo deklaratë nuk rezultoi e vërtetë. Rasti më i mirë për ta parë Shqipërinë në sulm ishte ndeshja me Maltën, por Haani edhe në këtë ndeshje luajti me një sulmues. Haani nuk jeton në Shqipëri dhe vjen këtu sikurse Lala, Cana apo Skela, çka do të thotë se nuk i njeh lojtarët. Për mendimin tim, Haan ka gabuar në radhë të parë në seleksionim” - kishte thënë trajneri i Tiranës, Sylejman Starova.

Haani është kritikuar shpesh për strategjinë e tij të paqartë në thirrjen e mos-

thirrjen e kontestuar të lojtarëve titullarë e me prestigj ndërkombëtar, në mosnjohjen ose paknjohjen e kampionatit shqiptar, çka ka reflektuar edhe me ndryshimet e shpeshta të rreshtimeve e shpeshëtisë së titullarëve në të shtata ndeshjet zyrtare të drejtuara prej tij, ku bilanci i deritanishëm është 1 fitore, 3 barazime dhe 3 humbje. Ervin Skela, ditë më parë, e kishte akuzuar Haanin se ai ishte i paqartë në skemat e lojës, si dhe për mos grumbullimin e disa lojtarëve. Objektivi i Haanit ishte vendi i katërt në grup, më lart se Hungaria rivalja direkte e Shqipërisë, por ja që Hungaria doli më e aftë se Shqipëria duke e mposh-



tur 2 herë, në Hungari 2-0 dhe në Tiranë 0-1, dhe ajo është 7 pikë para nesh.

Batuta e tij e parë në hotel “Rogner”, gjatë prezantimit zyrtar (3 janar 2008), është e famshme botërisht: “Mos më kërkoni të dal kampion bote me Shqipërinë, pasi ndryshe do të largohem qysh tani”. Askush nuk i kërkoi Haanit të na bënte kampion bote, por të paktën të fitonim vendin e tretë, pse jo edhe të dytin. “Sukseset” e tij ishin barazimi me Portugalinë dhe me Suedinë.

Kontrata 300 mijë euro

300 mijë euro ishte kontrata e Haanit. Presidenti Armand Duka i ofroi një kontratë dyvjeçare (1 janar 2008 – 31 dhjetor 2009) dhe një shumë 300 mijë euro, plus një opsion për premi prej 7 mijë eurosh për çdo pikë të grumbulluar në këto ndeshje kualifikuese. Paga 300 mijë euro llogaritet shumë e lartë në Ballkan, ngase trajnerët që kanë shtetet ballkanike marrin gjysmën e saj. Prishja e

kontratës, të paktën sipas përlogaritjeve, mund të kushtonte diçka më pak se 100 mijë euro, pasi Haan me klauzolat që ka në kontratë do të paguhej pas prishjes së njëanshme të kontratës. Por FSHF-ja arriti një marrëveshje me holandezin dhe ai do të marrë si kompensim edhe tri rroga, e paga mujore e Haanit ishte 15 mijë euro. Arie Haan është shkarkuar nga posti i trajnerit të përfaqësueses së Shqipërisë dhe ai do të marrë edhe tri rroga me nga 15 mijë euro.

Kush është Arie Haan

Arie Haan fitoi thuajse gjithçka: tre tituj kampionë të Holandës, tri kupa të Holandës, tre trofe në Ligën e Kampioneve, një Kupë Interkontinentale dhe dy superkupa të Evropës. Bashkëlojtar me Johan Krujfin, ai zgjoi shpresën te tifozëria kuqezi se Shqipëria mund të shndërrohej në një “mini-Holandë”. Por ai fitoi vetëm një pikë me Shqipërinë. Arie Haan kishte drejtuar kombëtare si Kina apo Kameruni dhe njihej si një ish-futbollist i famshëm i Ajaksit dhe përfaqësueses holandeze.

Karriera si trajner: Antverp (Belgjikë), Anderlecht (Belgjikë), Shtutgard (Gjermani), Nuremberg (Gjermani), Standard Liezh (Belgjikë), PAOK (Greqi), Fejenord (Holandë), Anderlecht (Belgjikë), Omonia (Qipro), Austria Vjenë (Austri), Kombëtarja e Kinës, Persepolis (Iran), Kombëtarja e Kamerunit, dhe Kombëtarja e Shqipërisë. ■





























10 ndeshjet e Haanit me Shqipërinë

Zyrtare:

Shqipëri-Suedi 0-0
Shqipëri-Maltë 3-0
Hungari-Shqipëri 2-0
Portugali-Shqipëri 0-0
Maltë-Shqipëri 0-0
Shqipëri-Hungari 0-1
Danimarkë-Shqipëri 3-0
Bilanci: 7 ndeshje; 1 fitore, 3 barazime, 3 humbje

Miqësore:

Shqipëri-Poloni 0-1
Shqipëri-Lihtenshtejn 2-0
Azerbajxhan- Shqipëri 1-1
Bilanci: 3 ndeshje; 1 fitore, 1 barazim, 1 humbje

Autor: Gazmend Morina - BENI	BESIM I VERBËR TE FATI, FATALIZËM	FJALË TINGULLM- ITUESE (muz.)	SHTIM NATYRORE I POPULLËSISË	BASHKËT- INGËLLORE	ISH FUTBOLLISTI YNË TARE	MMOZA AHMETI	GAZ PA NGJYRË, ME ERE TE FORTE E TE PAKEND- SHME (shq.)	PESHA E MALLIT PA AMBALAZH	ENVIRONME. PROTECTION AGENCY	TROPOJA	DEGË E MJEKËSISË	RESHAT ARBANA	AUTORITETI QË KA OKUJSHI MBI DIKË	SHKRIMTARI MEHMETI		
INSTITUCIONI FINANCIAR NË FOTO (shqip.)																
KËNGËTARJA ME PREJARDHJE SHQIPTARE ... OKSA				MUNDIM I MADH, HALL I MADH (shq.) SKAJ, QOSHJA						ILUZIONISTI SHQIPTAR MURA FUTBOLLISTI FATMIR						
I PLOTË, I GJITHM- BARSHËM, TERËSOR						KRYEQYTETI I KANADASË						INDIUM, KALIJUM APOLOHIA				
KRYEQYTETI I JORDANISË						AZOT, OKSHJEN MODERATORI KRASTA			SULM FUTBOLLISTI TIERI (Barcelona)					ZERO QË U BËN BALLE ME DURIM E ME GJAKFTO- HTESI FATKEGËSIVE		
FUTBOLLISTI SHQIPTAR ALTIM LEQUENDE (shq.)					ARSEN IMAMI KËNGËTARJA FARA			PËRËMËR VETOR SHKRONJA TE NËJËTJA				INTENSITET, SAMARIUM				
				ELIZA DUSHKU PUNIMI I ARËS			EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN TON, RËNËM, SULFUR					MOUNTAIN TRES BIKE SHTËT NË AZI (shq.)				
AUTOKRATIK, ABSOLUT AI KËNDOR REP										ILAZ KODRA GJENDJE PLOGËSHTJE SHPIRTERO- RE			DY ZANORË METAL ME SHKËLQIM SI TE ARGJENDIT			
						RIZONI NJËRI I PABESË E TRADHTAR (fig. - kësq.)		INDIANA, ALASKA KORÇA			AKUZUES I SOKRATIT, TOKA E PUNUAR					
VITI I RI KINEZ					MONEDHA BAZË E SHQIPËRISË (peshq.) BASHKËT- INGËLLORE				MBATHËSE SPORTIVE DAFINË							
	DEMTIM I PARSJEVE PËR TE PËN- GUAR PUNËN NË NJË FABRIKË SABOTAZH (shq./shq.)	ZBËRTHIMI I NJË ÇËSHT- JE	PAS SHUMË I GJATE					QË ESHTË LARA-LARA NË TRUP BETIM (shqip.)						RISANI TITAN		
NJËRI NGA VELLEZËRIT FRASHËRI					ROTTERDAM LUMË NË SHQIPËRI		E SHTËNË ME DISA ARMË ZJARRI NJËHERËSH (shq./shq.) BASHKËT- INGËLLORE									RUANDA
AKTORJA AMËRIKANE FARIS					BOJAZHUR SHKRONJA XV							MUZIKANTI BAJRI				
MJET I THJESHTË LUNDORMI (shq.)						KAÇAKU (vjet.)										
UJË I YNI MINERAL				TINKA KURTI INSTITU- CIONET E LARTA ARSMORE												
HISTORIANI ROMAK LUKRECI (shq.)						OMANI ISLANDA										
VEÇIM																
MJET SHPËRTHYES						ZANORË ANITA TAKE										
EMNË (peshq.)				ALI TEPELENA ELBASAN												
PUBULLA																



REVISTË PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË

PAQJA



Milazim
KRASNIQI



Largësia metaforike

Ethet e kujtimeve (poezi)

Monedha e Gentit

Fotografitë e kujtimeve (prozë)

Studim letrar

Largësia metaforike

Kombinimi i fjalëve, përgjatë sistemit figurativ, shprehet me një mendim të thellë shpirtëror, që ndërtohet gjatë vetëportretizimit në të gjithë sistemin poetik të poezisë së Milazim Krasniqit, andaj diskursi semantik është në shkallën më të lartë, me një shumësi kuptimesh

Flamur MALOKU

Venerime hyrëse

Leximi i poezisë së Milazim Krasniqit është lexim i trefishtë: i shenjave-figurave-kuptimeve. Nëpër këtë lexim të trefishtë hetohet sistemi fikcional, përballë shtresave e nënshtresave të diskurseve-figurative. Kjo sa vjen e thellohet përgjatë shkrimit-interpretimit. Kënaqësia gjatë leximit e dyfishon mallin për tekstin-poezinë, malli për poezinë mposht gjithnjë kohën e lodhjes e të mundimit përgjatë interpretimit.

Lodhja e mundimi personal mposhtet kur ke përballë kategorinë estetike të poezisë, e cila si veçanti personale e diskurseve-figurative, artikullohet e identifikohet tani në poezinë e Milazim Krasniqit. Kjo ka bërë që venerimet të thellohen edhe më shumë, të cilat në përhershmëri të kërkimit e të aplikimit prekin sisteme/kode/ligjërime, me hapje të vazhdueshme kuptimore-semantike. Interpretimi semantik, njëherësh, shënjon idenë se diskursi i poezisë nuk i duron mbylljet. Poezia, prej se ekziston, si diskurs i përherëshëm universal, ka qëndruar larg evidencave, skemave, konteksteve të ndryshme sociale/ideologjike.

Poezia jeton në përhershmëri. Koha nuk ekziston për poezinë kur është në pyetje skema/evidenca. Poezia nuk njihet kohë, pra bëhet akohore, edhe pse diskursi i saj është personal. Kjo ka bërë që poezia të shkruhet me kënaqësi të shumëfishtë personale, e të lexohet me dashuri të madhe. Andaj, edhe poezia e Milazim Krasniqit, si tërësi poetike, rri larg skemave e evidencave sociale e ideologjike. Duke qëndruar përherë larg proformave, diskursi i poezisë së Milazim Krasniqit bëhet personal e universal, para së gjithash njerëzor. Kjo njëherësh e shton kënaqësinë gjatë leximit e shkrimit, që bëhet mall e identifikim-jetësor.

Kështu, gjithnjë duke qëndruar pranë diskursit të poezisë, interpretimi



Diskursi universal

këtu lë hapësirë të mundshme, pra, duke lënë njëherësh hapësirë për kuptime të mundshme, sepse diskursi i poezisë vazhdimisht konotohet përgjatë strukturës figurative. Vështirësitë dalin gjithnjë, sepse ke përballë figurën, e cila kur del në poezi konoton e shënjon ide. Për t'u lehtësuar kjo, gjatë interpretimit, kërkohet e aplikohet rrjeti i komunikimit mbi poezinë e Milazim Krasniqit në të gjitha variantet. Rrjeti i komunikimit tekstor/kuptimor, njëherësh e shtreson diskursin e poezisë në kohë të ndryshme. Kjo aventurë e kërkimit përjashton kushtëzimet arbitrare. Duke përjashtuar çdo kushtëzim, leximi-interpretimi i poezisë bëhet i ndryshëm, përgjatë sprovimit e modelimit teorik. Esencat e kuptimeve hetohen në varshmëri me diskursin/shenjën/figurën, të cilat në strukturën e poezive të Milazim Krasniqit shënjojnë përherë hapje gjatë një leximi/interpretimi. Për të parë, se si poezia rri e hapur gjatë strukturimit e interpretimit, do të marrim në tërësi poezinë e Milazim Krasniqit të botuar deri më sot. Tërësia, njëherësh, bëhet edhe për një lexim sa më të mundshëm strukturor e kuptimor.

Marrë në përhershmërinë e komunikimit e të kategorizimit tekstor, diskursi i poezisë së Milazim Krasniqit ndërtohet e rindërtohet nga figurshmëria me përplot emocione e me kontekste të ndryshme shpirtërore. Duke i kategorizuar shenjat në strukturën tematike e semantike, diskursi universalizohet. Derisa njihet universalen e shkrimit, diskursi i poezisë së Milazim Krasniqit bëhet jetësor. Pra, shenjat personale/kuptimore universalizohen, të cilat gjatë polisemisë dalin e shënjojnë në kohë dhe hapësirë. Kjo venerohet gjatë analizimit të përherëshëm të botës fikzionale. Duke qenë aq personal, aq edhe misionar në kuptimin njerëzor-individual, çdoherë ligjërime shkruhet në përhershmërinë e ndjeshme universale. Kështu, polisemia kuptimore në filozofinë e kërkimit, karshi botës së brendshme subjektive, çdoherë përmes dritës shpirtërore-universale, bëhet artikulum i tërë poezisë së Milazim Krasniqit. Shenjat bëhen shenja universale në strukturën e tekstit, duke rinjohur gjithnjë dritën shpirtërore. Kjo, njëherësh, bëhet për përcaktimin

e kategorisë tematike, të cilat dalin më shumë si kërkim, gjithmonë mbi parimet e një sistemi etik, në relacion me jetën e autorit. Jeta autoriale, herë nëpërmjet diskursit semiotik, e herë nëpërmjet kodit figurativ prek situatat, të cilat tani ristrukturohen përmes diskursit meditativ e universal. Duhet ditur se leximi i shenjave të tekstit bëhet për ta definuar njëkohësisht edhe statusin kategorial të vet tekstit, ndërtimin dhe kodin tematik-universal. Mirëpo, duke pasur parasysh se situatat e jashtme, kur i mbarshtrihen kodit tematik, reflektohen, gjithnjë për të krijuar sistemin universal. Mbi këtë universale, shenjat japin ide, çka edhe poezinë e definojnë sipas statusit të shkrimit. Kështu, plotësohet bota-jeta e poezisë, karshi universale fikzionale. Andaj, bota e poezisë duhet kuptuar përmes universale së përhershme që përmban ajo në jetën e njeriut. Nga kjo që u shënjuar, del se poezia e Milazim Krasniqit është e lidhur ngushtë me ndjenjën, me botën e njeriut. Ajo lexohet në universalen e përhershme.

Rikthimi në figurë

Shkrimi fikcional në botën e poezisë së Milazim Krasniqit bëhet shkrim i figurshëm, që në strukturën poetike është përherë përjetim shpirtëror në një sistemin të mundshëm figurativ. Ky përjetim është i shtresuar në formën e të shprehurit emocional. Kështu, poezia bëhet e vetmja formë, përballë dëshmisë jetësore, në secilën shenjë dhe figurë. Prandaj, ky përjetim i dëshmuar, e i rikthyer, që tani del çdoherë si mundësi e të shprehurit të kësaj shpirtërore, e bën subjektin të pozicionohet gjatë ligjërimit të përvojës, me probleme të ndryshme jetësore. Këtu, figura për Milazim Krasniqin bëhet e jetësuar, e shoqëruar me shkrimin gjatë reales jetësore. Kjo ndodh meqë shpirtërorja është bërë njësh me figurën, në gëzim dhe hidhërim. Kështu, diskursi shkrimor i poezive, bëhet më personal përherë e shumë, duke e shtresuar jetën reale, për ta bërë jetën-figurë, pra jeta bëhet jetë/figurë, për të kaluar kështu më vonë, në strukturën ligjërimore, si dhembje dhe përjetim në vetë figurën e tekstit. Figurat e shumta vihen në funksion, të shpirtërores, për të marrë epitete të shumta, meqë përbrenda ligjërimit emocional shënjojnë situata jetësore në

identifikim të mundshëm universal. Kjo njëherësh bëhet edhe shenjë e provuar në jetë. Pra, Milazim Krasniqi, në sistemin e figurës, e shpreh shpirtëroren-individualen, situatën e përhershme. Rikthimi nga figura, bëhet gjenezë në shpirtëroren individuale, madje edhe identifikohet më të, e cila shprehet me kuptimet e tjera, që tani në diskursin e poezisë, çdoherë dalin për të artikuluar emocionin dhe dramatikën jetësore. Kjo njëherësh bëhet edhe karakterizim i tërë përmbledhjeve poetike. Figura, estetifikisht funksion për poetikën e tekstit, për ta bërë kështu edhe më të fuqishëm konotacionin tekstor, në esencë dhe formë. Sepse aty e shpreh shpirtëroren/individualen e përhershme. Mirëpo, kjo shpirtërore, në vazhden e diskursit të poezive, shënjohej me një fortësi individuale, prandaj subjekti kërkon një jetë më ndryshe, jetë e cila në kohë dhe hapësirë është universale në shkrimin fikcional, por duke qenë përherë personale në diskursin poetik. Polisemia kryqëzon ide përgjatë strukturimit të



tekstit, gjithnjë duke skicuar tema e figura. Të gjitha këto ide, përballë jetës, konceptohen e shtjellohen nëpër figura të ligjërimit, për të dalë pjesë të domosdoshme jetësore. Kështu, duke e ndjekur gjithnjë skemën e diskurseve, në formë dhe strukturë, figurat tekstore në strukturën poetike-tematike do të thurin personalen. Personalja zbulohet në secilën formë të ligjërimit, gjithnjë duke e ruaj-

tur figurën dhe skemën figurative, sepse ideja del nga ky sistem. I tërë ky identifikim nënkupton njëherësh, se jetën reale subjekti e bënë emocion-figurë. Sistemi figurativ lexohet në kohë dhembje-përjetimi, çka edhe duhet të lexohen, por në universalen e përhershme për të thurur temën personale, mbi mungesën e *fatit/jetës*. Fati/jeta shtresohen në diskurs për të dhënë para së gjithash një skemë, skemë kjo përherë e rikthyer në dëshmi universale-personale, andaj përherë është një dhembje, që determinohet nga kohët e ndryshme empirike. Figura tanimë jeton me tekstin-subjektin, ajo kthehet e rikthehet në shkrim, për t'u bërë e tashme në përjetim dhe kujtim. Bota e brendshme ndërtohet mbi pikat themelore, nëpër të cilat shënjohej figura. E tërë kjo bëhet për të dhënë një jetë personale, që në këtë kontekst bëhet edhe me e ndeshme gjatë ligjërimit. Këtu shkrimi diskursiv ndërton autentiken, pothuajse figurative në të gjitha nivelet strukturore-tematike. Përplasjet shpirtërore, subjektin e shoqërojnë edhe në dashuri, pra duke prekur atë që është dhembje e përhershme në kohë. Duke u karakterizuar figura, subjekti fillon të bëhet edhe më i ndjeshëm, sepse pushtohet trupi në kujtim dhe mallëngjim.

Çastet e përshkrimit në kohën e tashme janë për subjektin figurë-jetë. Kombinimi i fjalëve përgjatë sistemit figurativ, shprehet me një mendim të thellë shpirtëror, që ndërtohet gjatë vetëportretizimit në të gjithë sistemin poetik të poezisë së Milazim Krasniqit. Andaj, diskursi semantik është në shkallën më të lartë, me një shumësi kuptimesh. Figurat, në nivelin përgjithësues të tekstit, vetëkuptohen nëse lexohen shenjat, shenja këto çka edhe e kërkojnë lexuesin e formuar në poezi, për të hyrë pastaj në botën e shënjuese të poezisë së Milazim Krasniqit.

Lexim i mundshëm strukturor

Poezia e Milazim Krasniqit mund të lexohet e të interpretohet në një rrjet të mundshëm strukturor e kohor. Kryqëzimi kohor e strukturor ka argumentin e veçantë dhe të mundshëm, që tani shtrihet në secilin kryqëzim të poezive, në paraqitje dhe në përshkrim, si dhe në vetë strukturën e tekstit. Kështu, ribartja kohore në shkrim bën që të preken tema të ndryshme. Prandaj, shkrimi subjektiv kryqëzon situatat kohore, të cilat tani ar-

tikulohen në figurë. Mirëpo, gjatë leximit, sistemi kohor në të gjithë poezinë e Milazim Krasniqit konceptohet në përjetim. Përjetimi i këtillë i ndërlidhur me figurë nuk e ngushton leximin-interpretimin, për t'i parë gjërat e theksuara përbrenda vetë diskursit të poezive. Kështu, pra, përjetimi kohor nuk e bën të vështirë komunikimin e lexuesit me vetë poezinë. Mirëpo, duke qëndruar përherë pranë shenjave dhe në vetë leximin e këtyre shenjave, e sidomos në strukturën kohore, leximi do të bëhet nëpërmjet kërkimit të situatave personale. E themi këtë sepse secila situatë e kryqëzuar bëhet kategori e mundshme në strukturën e poezive, për të definuar para se gjithash sprovimin personal-autorial. Një sprovim i këtillë, pse jo edhe i definuar në metaligjërimin, bëhet paraqitje shënjuese duke krijuar në tërë hapësirën e poezive një relacion njeri-kohë, përbrenda varianteve të shkrimit-ligjërimin. Relacionet e këtilla shtrihen në formë përjetimi. Kjo shtrirje reflektohet në gjendje. Emocionaliteti i shprehur hyn në ligjërim, që si i tillë kushtëzohet para se gjithash një hapje të subjektivitetit. Hapja e subjektivitetit nga njëra situatë në tjetrën bëhet domosdoshmëri autoriale. Në të shumtën e poezive situatat kthehen në përvojë aktuale. Arsyeja e rikthimit të këtyre situatave është nga pasoja. Prandaj që të jemi më të qartë, kjo bëhet para se gjithash edhe për një ritheksim të përjetimit në kohë të ndryshme. Situatat në kohët e ndryshme esencializohen, varësisht alternimit. Këtë esencializim Milazim Krasniqi mundohet ta argumentojë, duke të shpënë drejt njohjes së pasojës, tani të identifikuar me përvojën subjektive. Argumentimi brenda sprovave, qofshin ato personale apo kombëtare, si kërkim i vazhdueshëm në ekzistimin real, deklamohen nga variantet e sprovave, që në të shumtën dalin në fakte jetësore të përjetuara. Përshkrimi dhe kalimi i përshkrimit në argumentim, të ekzistuar në tragjiken personale dhe kolektive, përmban dëshminë e vetë kohës reale që përbrenda subjektivitetit përjetohet në përmasën e të ndodhurës. Dëshmia e ekzistuar jetësore dhe kolektive, karshi faktit, theksohen brenda poezive dhe idesë, përmes një përcaktimi figurativ, gjithnjë duke e sistematizuar përjetimin emocional. Andaj, një paraqitje e këtillë e shumëfishon dramaticitetin, duke u bërë reflektim për vetë kohët, që

në esencë shfaqet e rishfaqet mbi ndjenjën shpirtërore.

Mundësia e kuptimeve

Duke i parë këto shtresime, mund të themi se poezia e Milazim Krasniqit, në tërësinë poetike, ndërtohet përbrenda simbolikes. Simbolika vazhdon të artikullohet edhe më tutje, tashmë e pranishme edhe në konkretizim. Pra, jepen shtresime dhe nën shtresime të asaj që subjekti i rikthen në dhembje dhe në pësim personal dhe kombëtar, e artikuluar tani në poezi, duke simbolizuar çdoherë shkallën personale. Dihet se, nëpërmjet sistemit figurativ, Milazim Krasniqi thekson ide, duke shënjuar para se gjithash kuptim në paraqitje konkrete,



po edhe gjatë përfytyrimit. Kështu, edhe në poezi, figurat konkrete dhe përfytyrimi poetik e forcojnë semantikisht kuptimësinë, sidomos kur ato kanë të bëjnë me theksimin e gjendjes personale. Pra, janë këto figura të aktualizuara që shënjojnë personalen. Në sistemin kohor, Milazim Krasniqi thekson dukshëm realitetin, duke skicuar kohët e vështira. Shkallëzimi i kohëve dhe i situatave të tilla, në rrafshin individual, shënjon padyshim simbolikën e përjetimit, pra, përjetimi theksohet në domethënien e asaj që krijon dhembje, çdoherë në artikulum të figurës. Leximi i figurës në shtresën e poezive artikulon para se gjithash gjendje shpirtërore, nga faktet konkrete të argumentimit. Figurat përherë të skicu-

ara, do të artikulojnë, para se gjithash, edhe situata edhe kontekste të ndryshme, të kryqëzuara vazhdimisht në shprehje dhe në emocion. Kështu, niveli i situatave të shtrira në ndërvarshmëri njëra me tjetrën, shpërthejnë nëpër poezi. Ato sa vijnë e skicohen në paraqitje, për të dhënë vetë thurjen e veçantë shpirtërore, gjithnjë duke ruajtur vuajtjen-dhembjen, me të cilat subjekti identifikohet në diskursin e poezive. Të gjitha këto, në të përditshmen jetësore, marrin epitete të ndryshme gjatë shprehjes emocionale në konceptim dhe në strukturën e poezive në përgjithësi. Kështu, reflekset kohore të shtrira në të shumtën e poezive, në masë të madhe, janë theksim e ritheksim i situatave e të brendisë subjektive përballë jetës reale. Njohja reale gjithnjë është përshkruese në çastet më të vështira. Përshkrimi shkon deri atje, duke u shoqëruar vazhdimisht me shqetësim, nëpër situatat e shkaktuara. Mirëpo, uni subjektiv, varësisht sfidës jetësore, është në gjendje t'u bëjë ballë të papriturave dhe të priturave. Pra, shihet gatishmëria subjektive edhe atëherë kur i ndalet ëndrra jetësore. Shihet se jeta për Milazim Krasniqin është e perceptuar me plot baticë dhe zbaticë. Pra, tani realja jetësore ekzistuese shënjon edhe një filozofi të të jetuarit. Kjo filozofi jetësore ngrihet në nënshtresën figurative, gjegjësisht në figura të shumta që nga metafora, simboli, alegoria, krahasimi. Figurat e këtilla lejojnë mundësinë e kuptimeve të shumta, nga të cilat theksohen e përjetohen vetë kohët nga jeta e tanishme subjektive. Prandaj, niveli i ndjenjës së shprehur prek shumë gjëra personale, të cilat mbeten të përherëshme në poezi. Poezitë e Milazim Krasniqit duhet të lexohen përmes njohjes së vazhdueshme personale. Personalja, në secilin rrafsh të shprehjes, vetëpërkufizohet qoftë në shkrim, qoftë në emocion.


Semantika e kërkimit

Imazhi gri (1982) është vepra e parë e Milazim Krasniqit e sistemuar në tërësinë poetike e estetike. Sistemimi i përgjithshëm diskursiv bëhet argument i fuqishëm i temave të mëdha jetësore e metafizike. Jetësorja figurohet-universalizohet, përballë metafizikës shpirtërore. Pra, personalja bëhet shprehje, bëhet figurë emocionale-universale. Shenjat tekstore sa vijnë

e bëhen ideore dhe funksionalizohen nga diskursi i përgjithshëm semantik e strukturor. Semantika e kërkimit bëhet edhe kërkim universal. Temat jetësore-universale do të jenë një preokupim i vazhdueshëm i autorit, që çdo herë kanë si pikë referimi njeriun, që tanimë e ka humbur rrugën jetësore. E që kjo të njihet në thelb, nëse teksti lexohet nëpërmjet shenjave tekstore. E themi këtë sepse autori përmes shenjave artikulon idetë përballë jetës dhe kuptimësisë së saj. Përvoja personale shprehet përmes gjuhës simbolike, karshi situatës jetësore-universale. Krijimi i vështirësisë jetësore perceptohet, sipas idesë autoriale, nga mosnjohja e plotë e jetës. Pra, tema e jetës në diskursin e poezive bëhet temë personale/universale. Andaj, apogjeu i tërë kësaj është se pa njohje jetësore-universale, nuk ka rehati shpirtërore, se duke njohur universalen-absoluten, njeriu beson, e duke besuar ai nuk dyshon në rrugën e drejtë. Kështu strukturimi i tërë këtyre ideve funksionalizohet përmes shtresimeve shprehëse jetësore, çdo herë nga një përvojë autoriale. Përvoja personale semantikisht shpreh kuptimin simbolik të fatit nëpër vazhdimësinë e jetës. Prandaj, poezitë gërshetojnë përbrenda vetes kuptimshmerinë dhe arsyeshmërinë morale dhe psikologjike të njeriut përballë vështirësive shpirtërore. Në vizionin dhe skicimin jetësor-filozofik, duke shprehur konkretësinë dhe përsosmërinë gjatë identifikimit, autori shënjon mesazhin e njohjes së jetës. Një ekspozim i tillë i idesë poetike del mjaft domethënëse për jetën. Kështu, poezia ndërtohet nëpërmjet theksimit dhe përjetimit, duke aktivizuar poetikisht koncepte që kanë të bëjnë me gjendjen dhe me fatin e njeriut. Në një frymë të këtillë është ndërtuar esenca, ku mendimi i heshtur dhe brenga do të shoqërohen përmes një emocionaliteti të fortë shpirtëror. Brenga e paraqitur intensifikon më tutje mendimet e arsyeshme të autorit. Nga një gjendje e vështirë shpirtërore subjekti ndërton përfytyrimin për njeriun e shprishur në shpirt, apo siç thotë autori "Varfëria e shpirtit". Vijëzimi dhe reflekset e reagimeve autoriale ndërthurin në vete preokupimin mbi varfërinë e shpirtit të njeriut. Varfëria e shpirtit krijon tek autori një gjendje të vështirë emocionale:

*Lehtë ia bëjmë më këto të mira në sofër
Po si t'ia bëjmë
Me varfërinë e shpirtit*

Këto vargje gjithnjë e më shumë japin ide kuptimplote, çdoherë duke paraqitur një problematikë të ndjeshme jetësore në raport me moralin jetësor. Me një ndjeshmëri të fortë, ku kaosi shpirtëror i njeriut konceptohet përbrenda diskursit me një çrregullim total. Funksionalizimi i tillë gjuhësor zbulon një karakteristikë tejet të rëndësishme gjatë zërthimit të idesë kuptimore. Varfëria e shpirtit dhe theksimi i saj brenda qenies fizike shkakton humbjen e arsyes morale. Kur humb arsyeja morale, në kuptimin e plotë të fjalës, dramatika jetësore



është e madhe, andaj edhe jeta mbetet e pakuptimë, ndërsa fundi/vdekja përjetohet rëndë. Kjo do të thotë se autori drejtpeshimin e jetës e sheh si filozofi në vete dhe vetëdija etike e saj përkuftizohet nëpërmjet gjuhës figurative. Pra, përmes figurës rindërtohet ideja filozofike e jetës dhe e vdekjes, tema këto universale. Mbitheksimi i vetmisë me një shkallëzim dramatik, por që krijon një vullshmëri ndjenjash dhe mendimesh në kuptim të idesë, skicohet më së miri në poezinë *Njëqind vjet vetmi*.

Vetmia e artikulluar në strukturën e tekstit nxjerr në plan të parë situatën e dhimbjes kur njeriu tërhiqet në vetmi absurde. Vetmia nënkupton një mbyllje të vetë-flijueshme, që nganjëherë vjen si

shkas i mos komunikimit me ambientin. Mirëpo, sipas autorit, vetmia krijohet atëherë kur njeriu humb besimin tek vetja dhe tek Zoti. Shihet se këtu universalizohet tema, vetmia nuk është vetëm vetmi:

*Ah,
Vetmia qenka brenda vetes
Kur humbim lidhjen me shpërblyesin
Dhe unë qenkam vetë prodhuesi i saj
Si merimanga
Kur pa dashje kurthohet në rrjet.*

Krijimi i një vetmie të tillë plotësohet me figurën e merimangës. Vetmia e ndezur në shpirtin e njeriut prodhon në mendjen e tij situatën paradoksale të përvojës shpirtërore-universale. Pra, shpalimi gradual i njohjes së vetmisë në suaza të ligjërit, shenjzohet kuptimisht përmes një dëshmie jetësore-universale. Kësisoj autori e shemb vetminë si një pakuptimësi për njeriun. Në këtë situatë të idesë së subjektit shenjzohet përbrenda procesit edhe figura metaforike me një ndjenjë të fortë poetike. Një pikëshikim i tillë tërhiqet paralelisht edhe në poezinë *Vjeshta*, që dyzohet në kujtesën shpirtërore, por që në ide jep edhe vetminë subjektive. Kjo lirikë peizazhi shpalos një botë të brendshme personale. *Vjeshta*, në shtresën e tekstit, ndërthur mesazhin e vet kuptimor gjatë përshkrimit që i bën autori:

*Më në fund erdhi
E zymtë flokëprishur
Si një mërgimtare e shumëvuaajtur
Dhe po shkel arave, trotuareve
Rëndë duke derdhur vërin
Që i është lidhur në grykë.*

Pikërisht lidhjet e tilla shpirtërore gjakojnë para së gjithash mbitheksimin e situatës kohore. Mbitheksimi i situatës lidhet me kohën kur u shkrua teksti, që në brendësinë e vet bëhet shprehje kuptimësie e detajim jetësor i kësaj situatë. Përshkrimi i vjeshtës shqipton historinë e dhembjes personale, domethënë vetë vjeshta si figurë përafrohet me konceptin e idesë personale. Prandaj, poezia e Milazim Krasniqit shtron ide dhe dilema të shumta për njeriun dhe për jetën në përgjithësi.

Shenjat

Shenjat e tekstit, gjithnjë duke përfaqësuar ide, japin një metaligjërim të

theksuar personal. Metaligjërimit personal shkrihet në konotime të shumta. Konotimet estetike nëpër tekstin poetik *Imazhi gri*, shpërthejnë e bëhen ecje të mundshme shpirtërore. Shpirtërorja personale, përfaqëson rrafshet e ndryshme. Nëpër këto rrafshet ndërtohet edhe poezia-diskursi i saj në tërësi, më ç'rast hetojmë fuqishëm edhe simbolikën e poezive. Simbolika bëhet komunikim i dyfishtë më poezinë. Në këtë rast po flasim për një gjuhë të dyfishtë të poezive, për një kuptim të dyfishtë. Kuptimet e dyfishta e hapin tekstin si tërësi poetike. Këtu, sistemi figurativ e ai emocional bëhet edhe statusi shkriimit në të përgjithshmen tekstore të poezive, gjithnjë në funksion të estetikës letrare. Figurat e poezive kthehen e bëhen diskut i përgjithshëm kuptimor. Mbi këtë, jeta personale bëhet edhe jetë universale. Edhe vetmia personale është bërë vetmi universale, e cila në strukturën e tekstit hapet e mbyllet nga universalja e mundshme. Konotimet e tekstit, kur është në pyetje jeta-vetmia-vdekja, realizohen kryesisht nga një diskut i figurshëm e i konotushëm, që thuret e rithuret nga pozicionimi personal. Pozicionet e ligjërimit-subjektit janë pozicione të figurshme, e me diskut të figurshëm.

Vetmia universale

Vetmia në strukturën e poezisë *Njëqind vjet vetmi*, bëhet iniciuese e argumentuese në ligjërimit personal e universal. Një hapje e tillë në fillim e bën tekstin edhe më dramatik:

*Bota ka rënë në gjumë
Ora e murit bën grevë*

Dramatika personale thellohet edhe më tej, gjithnjë duke tentuar të realizohet e të shprehet, ajo që është përherë dhembje personale e universale. Bota ka rënë në gjumë, ora e murit bën grevë, ndërsa në trupin e subjektit fillon lodhja-dhembje shpirtërore, duke u munduar çdoherë që të mposhtë vetminë. Sprovimi subjektiv, pse jo edhe i definuar, bëhet paraqitje e identifikuar, duke krijuar kështu në tërë hapësirën e tekstit një relacion njeri-vetmi, përbrenda idesë universale. Relacioni i këtillë shtrihet në formë përjetimi dhe sprovimi. Përjetimi dhe sprovimi në theksim të plotë, bëhet nga vetmia individuale. Kështu, në të

shumtën e poezisë, situata dhe përshkrimi i vetmisë, kthehet në një përvojë aktuale të rëndë, që si e tillë është e pranishme të subjektit. Andaj, situata e vështirë në kohën e vetmisë së subjektit identifikohet e universalizohet, gjithnjë duke nxjerrë në pah përjetimin e subjektit, karshi vetmisë së rëndë në jetë.

Shtrirja e temës mitike

Në veprën poetike *Pirg vegimi*, figurat bëhen esencë ligjërimit përgjatë ndërlidhjeve të situatave-kohëve të ndryshme historike e mitike. Ndërlidhja historike e mitike jep shenjën e komunikimit të kohëve të ndryshme. Pra, kohët komunikojnë, të cilat tani në strukturën e përgjithshme bëhen të motivueshme në ligjërimit të subjektit. Nëpërmjet këtyre komunikimeve kohore ideore, që tani shtresohen në rrafshin e poezive, subjekti fillon dhe thur tema. Temat lexohen e interpretohen mbi shenjat e ndryshme strukturore e fiksonale. Shenjat e figurat shtresojnë konotime të shumta. Konotimet tekstore marrin gradacion të theksuar, në rrafshin e shprehjes e të imagjinatës. Kjo, njëherësh, bëhet edhe intencë personale përgjatë ndërtimit të diskutit. Mitet e ngjarjet historike bëhen mitema të shumta, që vijnë si rezultat i imagjinatës personale në kodin tematik e diskutiv të poezive. Temat e figurat antike bëhen motiv i shumë temave të tanishme personale, të cilat gjatë poezisë së figurshme, ndërtojnë e rindërtojnë ide të shumta personale. Duhet kuptuar se kjo bëhet për t'i dhënë një shtrirje temës-idesë. Shtrirja e temës mitike, tani në poezi bëhet status shkriimit e modelimi. Rrjeti i komunikimit ndërtohet mbi figurat, të cilat tani shihen në funksion të temave e mitemave. Kjo njëherësh bëhet edhe për të forcuar shenjën dhe figurën e tekstit. Statusi i shkriimit e i figurës, gjithnjë jetë i hapur në kohën e shkriimit. Pra, mitet e ndryshme hynë në trupin e ligjërimit, si ide e esencë. Një rikthim i këtillë drejt antikitetit në poezinë e Milazim Krasniqit bëhet edhe shenjë postmoderniste.

Kohë e ligë

Tema e tradhtisë, temë kjo edhe universale, argumentohet përgjatë tekstit *Kurthi*. Tradhtitë-kurthet identifikohen e preken që nga miti i antikitetit. Mitet/figurat bëhen shtresimi i pa



ndërgjegjes, që tani ndjekin një sistem të mundshëm asociativ. Tradhtia bëhet e mundshme nëse nuk ke formim të ndërgjegjes individuale. Pa normë etike individuale, tradhtia bëhet edhe më e madhe, më e pranishme. Nga personalja bëhet edhe universale. Kërkimi për një eliminim të këtij fenomeni të marrëzishëm njerëzor, ndërlidh në vete shumëfish idenë e refuzimit e të gjakimit shpirtëror-personal, përballë këtij fenomeni universal. Tradhtitë e kurthet e ndryshme njerëzore dalin në shkrim, duke reflektuar kontekste të ndryshme kohore. Tema e Trojës së tradhtuar e të rrënuar, bëhet hakmarrje për figurën mitike-Agamemnonin. Kurthi i bërë nga Klitemnestra, nuk del të poezia si hakmarrje ndaj flijimit të bijës Ifigenisë, por është Troja ajo që hakmerret ndaj Agamemnonit. Kjo njëherësh të shënjon idenë, e tmerrit personal ndaj tjetrit, ka edhe dënimin e shumëfish të në jetën reale, siç del në poezi:

*Po kurthit të ngrehur
S'i shpëtoi as Agamemnoni*

*Zgjidhte një zemërimi Klitemnestra
Jo
Merrte hak Ilioni*

Nëse poezinë e vendosim në kontekstin kohor, padyshim diskutit bëhet përjetim i një kohë të ligë. Koha e ligë lidhet e figurohet mbi shumë gjakime shpirtërore. Troja bëhet edhe Trojë e identifikueshme me atdheun e subjektit, ku tradhtia e kurthet ishin bërë formë e jetesës, të cilat aplikoheshin pabesisht deri në pikën e fundit nga i huaji (pushtuesi). Këto gjëra ishin bërë vdekjeskatërrim në të përhershmen jetësore.



Empiria personale

Duke theksuar përherë përjetimin shpirtëror në kohën e vështirë, Milazim Krasniqi shtreson në ligjërimin e poezive probleme të shumta psikologjike-jetësore nga përvoja empirike. “Në pjesën më të madhe të vjershave të këtij vëllimi është hetimi psikologjik dhe lëvizja dialektike shpirtërore e subjektivitetit në përmasat e jetës së përjetuar”. Problemet e shumta psikologjike-jetësore hetohen nga rrafshet e shumta personale, gjatë gjykitimit e vlerësimit në tërësinë e disurseve tematike. Kur flasim për këtë hetim në nivelin përgjithësues, arrihet mundësia e shtresimeve të shumta kuptimore. Kuptimet e shumta vetënjohëse, në kuadrin e strukturës tekstore, deklarohen nga empiria personale. Kryesisht dalin shenja të hidhërimit e të gjakimit shpirtëror, që në funksion të formësimit të poezive venerohen në vija të përgjithshme figurative. Imazhet poetike mbesin imazhe të trishta subjektive. Poeti hyn në diskurs të poezive me pamje të ngarkuar jetësore e psikologjike, të cilat sa vijnë e bëhen të rënda gjatë perceptimit. Një ngarkesë të tillë e jep edhe poezia Diqysh, e cila jep pamje të një ditë të zakonshme, me plotë ngarkime psikologjike. Edhe pse titulli shënjon figurën e rrugëdaljes, sado e dyshimtë qoftë ajo, përbrenda imagjinatës figura do të formohet nëpër shkrimin personal, gjithnjë mbi venerimet e vetmisë-brengës shpirtërore:

*Të gjithë kishin blerë gjithçka
Se mua më hante diqysh një brengë*

Brenga personale e dyfishon dramatikën e tekstit, që njëherësh bëhet esenciale për poetin, në kohën e vet-

misë së ngarkuar psikologjike. Me të tilla formime psikologjike, teksti bëhet më emocionalizues, çdoherë më shndërrime të shumta përbrenda jetesës personale.

Diskursi meditativ

Shkrimi personal i rikthyer kah çastet e sprovat e shumta përjetimi, bëhet pikëreferimi përgjatë ligjërimin të poezisë *Pirg vegimi*, që njëherësh është edhe titulli përfaqësues i veprës. Kjo poezi shkruhet emocionalisht, e figurohet emocionalisht. I tërë diskursi duhet të lexohet në këtë mënyrë:

*Shumë herë kur s'mund ta shkruash
Asnjë varg për be
Je poet i madh
Pirg vegimi je*

Kjo tezë e shtruar shënjon autorin përballë shkrimit e meditimit. Nganjëherë poeti nuk mund të shkruajë. Pamundësia e të shkruarit, bëhet molisje shpirtërore. Mirëpo, për poetin ekziston vetëm një çast i të shkruarit, i cili tani argumentohet me çastin e frymëzimit. Pra, çasti i frymëzimit është edhe çast i shkrimit e i meditimit për poetin. Njëherësh, këtu edhe formulohet ideja se subjekti nuk e dëshiron poezinë pa një frymëzim të mundshëm subjektiv, e pa një njohje të vetvetes. E gjithë ky diskurs meditativ, poezinë e bën më racionale, më aktive gjatë shkrimit e leximit, çka edhe duhet të jetë, sepse ajo shkruhet e lexohet që të jetojë përherë, duke të ofruar përherë një njohje të përgjithshme jetësore e njerëzore. Akti i frymëzimit e i njohjes se vetvetes është thelbësor për poezinë:

*I ke parë në sytë e tu të gjithë shumë herë
Pa e kuptuar s'e nga u vjen humbja
Atyre që harrojnë veten përherë*

Për të përforcuar këtë, poeti sjell në kujtesë në fillim të poezisë figurat e shumta të artit-poezisë si: D. Aligerin, Homerin, Seremben, të cilët figurohen në statusin e shkrimit e të meditimit. Nëpër këto shenja, Milazim Krasniqi thur diskursin filozofik të poezisë.

Largësia metaforike

Qeshje sardonike (1987) është vepër e metaforave poetike, gjithnjë duke njohur frymëzimin personal. Mbi meta-

forën e tekstit-poezisë, kërkohet edhe leximi i shumëfishtë. Leximi i shumëfishtë bëhet duke iu nënshtruar tekstit në nivelin simbolizues e ironik. Kjo bëhet për arsyeje ngase shenjat ngrihen në gjuhë të theksuar metaforike-ironike. Duke iu rikthyer diskursit metaforik, temat personale bëhen jetëshkrim, që determinohen çdoherë nga ndjeshmëria poetike-subjektive. Ndërsa ironia bëhet kërkim i esencave reale/ ekzistenciale. Jeta reale, me të gjitha mungesat, bëhet temë e pashmangshme. Subjekti jeton në realen, e identifikohet me realen. Distancë nuk ka, edhe atëherë kur arketipat kalojnë në diskurs të poezive. Këtu prodhohet emocioni empirik e metaforik, që njëherësh edhe përcakton dimensionin poetik të tekstit. Emocioni subjektiv rritet në shkallën e tekstit. Nga kjo, pozicioni personal bëhet emocionalizues i përhershëm përgjatë derivimit të temës. Dimensionin letrar-poetik hapet në përhershmeri të ligjërimin e të esencave tematike. Esencat tematike në metaforën e kërkimit e të artikulimit shfaqin realen. Teksti bëhet edhe alegorik në nivelin e komunikimit të shenjave.

“Ato e shfaqin realitetin simbolik të artikulesit deri edhe alegorinë me empirinë e autorit”. Në këtë kontekst përforcohet shkrimi krahas varianteve tekstore/tematike. Shumë poezi, përmes alegorisë, inkuadrojnë variante e nën-variante të leximeve, të cilat nuk qëndrojnë vetëm në një kuptim të vetëm, përgjatë ligjërimin të poezive. Pra, subjekti hyn në poezi me metaforën e alegorinë, figura mbi të cilat flitet e mendohet, ndërsa polisemia sa vjen e shtresohet. Varësisht kësaj, mendimet subjektive nuk janë të vrullshme, ato rrjedhin ashtu qetas në shkrim e meditim. Rendi i metaforave, bëhet rend i mendimeve/ideve/esencave, që njëherësh është edhe rend i dëshirueshëm i artikulesit-subjektit në poezi. Kjo edhe krijon në sistemin poetik një logjik të sistemit, që nis e realizohet në kuadrin e përjetimit.

Poezia e Milazim Krasniqit, duke qenë përherë shkrim autentik, bart në vete gjithnjë mendime të së njohurës e të së panjohurës. Shkallët nëpër të cilat thuren këto nocione, bëhen kërkim i vazhdueshëm në shkrimin e tekstit. E njohura dhe e panjohura hapin tema-diskurse, të cilat kur realizohen në poezi, përvetësohen argumentohen me një dashuri të madhe

subjektive. Duke qëndruar përherë larg kodeve, ajo jeton në përhershmëri autentike. "Poezia buron nga ndjenjat autentike, ndaj është aq autentike. Statusi i tillë bën që ajo të ndihet ngushtë në secilën formë të kodifikuar; ndaj poezia përherë do t'i shpërthejë kodet, të jetojë si esencë". Mbi këtë parim të shprehjes autentike, çdoherë duke mbetur e jetuar në esencialen, ndërtohet vepra poetike *Qeshje sardonike* e Milazim Krasniqit. Kështu identifikimet thuren e rishkruhen, mbi të njohurat e të panjohurat reale e fiksionale.

Përherë poezia jeton në mendime të thella, që reflektohen, padyshim, me domethënie të shumta. Imagjinata mbi këtë prizëm bëhet njohëse reflektuese në vargun-shkrimin e poezisë. Kufijtë gjithnjë hapen, arbitrariteti sa vjen e zhduket. ■

(Shkëputur nga një studim i gjatë)



Shënime biografike

Milazim Krasniqi u lind më 1955 në Breznicë, një lokalitet afër Prishtinës.

Shkollën fillore e ka kryer në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme të mjekësisë në Prishtinë. Studimet për letërsi shqipe i ka kryer në Universitetin e Prishtinës, ku edhe ka magjistruar në vitin 1988, ndërsa në vitin 2004 ka fituar gradën e doktorit të shkencave filologjike.

Është mësimdhënës i rregullt në Universitetin e Prishtinës, në Degën e Gazetarisë. Në vitin 1988-1999 ka qenë sekretar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Në vitet 1990-1995 ka qenë kryeredaktor i revistës për kulturë "Fjala", në vitet 1995-1999 ka qenë redaktor përgjegjës për Kosovë i gazetës ditore "Bota sot", ndërsa në vitet 2001-2002 kryeredaktor i revistës "Interesi nacional". Nga viti 2001 është anëtar i Bordit të Drejtorëve të Radiotelevizionit të Kosovës.

Poezitë e tij janë përfshirë në panorama dhe në antologji të ndryshme të poezisë shqipe, ndërsa disa nga dramat e tij janë luajtur në skenat e teatrove të Kosovës.

Jeton në Prishtinë.

Bibliografia Poezi

- Imazhi gri, Rilindja, 1982.
- Pirg vegimi, Rilindja, 1985.
- Qeshje sardonike, Rilindja, 1987.
- Formula e Katonit, Rilindja, 1990.
- Kursi për pantomimë, Rilindja, 1994.
- Dalja e atdheut nga ëndrrat, 1996.
- Lulja e shpëtimit, poezi e zgjedhur, Logos-A, Tetovë, 2004.
- Dritë në kujtime, Arbëria-Tiranë, 2007.

Romane

- Fijet e shpirtit, Dardania, Prishtinë, 1998.
- Fotografitë e kujtimeve, Logos-A, Tetovë, 2003.

Dramaturgjia

- Zbulimi, Mos më merrni në qafë, Punë Sizifi, 1990.
- Kur lindi partia, 1996.
- Kush i bie fyellit, 1997.
- Bryma e vdekjes, Kosovë në ndërgegje, 2001.
- Monedha e Gentit, 2003.
- Rulet ruse për Ali Pashën, 2004.
- 1999 Tragjedi shqiptare (trilogji), 2004.
- Bryma e vdekjes (botim i dytë)
- Një Antigonë e re
- Kësulkuqja e shekujve

Publicistikë

- Horrat në krye të detyrës, 1998.
- Kosova pas 22 janarit 1998, (2000)
- Meditime islame, 2005.
- E vërteta e Islamit ndër shqiptarë, 2006.
- Në çfarë Kosove do të jetojmë, 2008.
- Hyrje në gazetari, 2008.

Studime

- Soneti në poezinë shqipe, 2005.
- Dhuna dhe qytetërimi perëndimor: Islami si fillim i historisë, 2006.
- Islami i keqkuptuar dhe fatkeqësia botërore, 2007.

Poezi

Ethet e kujtimeve

Kronikë

Këto gërmime i bënë
Do arkeologë të egër

Të tyret janë shifrat
Mbishkrimet
Edhe ato që s'thuhën

Thonë kanë thënë të urtët
Thonë kanë thënë të marrët

Dikujt i duhet zënë besë
Me sytë mes rrënojash,
Kur harron besën e vërtetë

Kurthi

U nis në sa luftëra
Veten duke e bërë li

Nuk qe Helena e bukur si thonë
Po bota e shëmtuar ish

E ra dhe Ilioni së fundi
Pus i thellë në atë rrugë

Po kurthit të ngrehur
S'i shpëtoi Agamemnoni

Zgjidhte një zemërimi Klitemnestra
Jo
Merrte hak Ilioni

Gjumi i mesditës

Ta kesh zogun në dorë
E të marrësh botën në sy

Të ikësh larg më larg
Nga zëri yt
Që gjegj kur thërret

Thellë të fshihesh
Në zgavrat e vetmisë
Që t'i bësh ballë shkohëzimit

Të ëndërrosh pastaj
Derisa të verbohesh
Me kohën tënde në duar

E sheh si zgjat zgjimi
Më shumë nga jeta
Popull i mashtruar

Ethet e kujtimeve

Shëtitorja u kërrus
E mbahet si për bastun
Për trungjet tullace të brirëve

Gjethet me verdhëz
Ia mbulojnë kurrizin
Që therje reumatike ndien

Derisa bëj shëtitjen e mbrëmjes
Sa s'ia plas vajit
Për verën e dashurisë së vdekur

Ndalem në mes të shëtitorës
Si për t'i mbledhur kujtimet
Nëpër plasat e asfaltit

Më mirë po t'i varim si kartëmortale
Se kështu na i shpien në pah
Fshisaxhinjtë

Kënga e gjelit

Është avazi që paralajmëron vdekjen
E ëndrrave
Mundësinë e thikës në lafshë
Gjakun e zi në borë

Është fërgëllimë që tund mjegullat
E kujtimeve
Perdet e mistershme të gravitacionit
Hijen e përbaltur të kasnecit gjuhëprerë

Është vetëtimë që ndriçon greminën
Kozmike
Burimin e fshehtë të jetës
Ku luajmë fugimthi me veten

Shumëzimi i fytyrës

Për të mos u takuar me pasqyrën
Rris mjekër e mustaqe

Për të mos u takuar me pasqyrën
Nuk i laj sytë në mëngjes

Për të mos u takuar me pasqyrën
Mbaj syze të errëta

Nuk i shoh dot me sy as vitrinat
Dhe gjithçka tjetër pasqyruese e urrej

Por kjo ikje qyqare nga vetja
Nuk shërohet si një rrufë e lehtë

Për ta shikuar pa frikë veten drejt në sy
Duhet besuar Zotin e vërtetë

Pendim

Sa herë më kujtohet ai emër
Nga frika dridhem

Dhe përsëris fjalë pendese
Për të mos më zënë pesha
E atij trangu pa fruta

Atje do të doja të kthehesha
Për aq sa do të doja të bija
Në zjarr i gjallë

Poezi nga Milazim Krasniqi



Vështrim teatror

Monedha e Gentit - M

Muhamed ÇITAKU

Ligjërimi


Ligjërimi te drama *Monedha e Gentit* është në funksion të një-sive që i përfaqëson. Ai ka një rëndësi të veçantë për të shquar nivele të ndryshme të tekstit: nivelin zhanror të tij, rendin kohor e vendor të situatës, për të theksuar shkallët e ndryshme intelektuale të personazheve, shkallët shoqërore që iu përkasin, etj. Pra, ai është polifunksional, veçanërisht për kontekstin në të cilin vendoset, në anën tjetër, *polifunksionaliteti* tregon ngarkesën me të cilën ligjërimi funksionon në këtë dramë. Pak a shumë një njësi e ndërtuar mirë nga shumë anë që reflekton elementet e saj në fusha e funksione të shumta. Drama në nivel fabular, kohor, vendor e të problemeve ndahet në tre pjesë: pjesa e parë dhe e tretë që paraqet jetën e mbretit të fundit ilir, Gentit dhe pjesa e dytë që paraqet aktorët që luajnë shfaqjen për të. Fillimisht pjesa e Gentit është e shkruar në vargje, pra me një ligjërimit të zgjedhur, me ritëm tjetër krahas atij bisedor, fjalë e fraza të tjera e me figura më shumë. Në anën tjetër, kemi ligjërimit bisedor te aktorëve, po asnjë nga këto njësi nuk i kemi te aktorët, me ç'gjë automatikisht vihet theksi në dallimet e tyre. Pra M. Krasniqi përmes dallimeve ligjërimitore shënjon dallimet e përdoruesve të tij. Kjo realizohet me mendjemprehtësi pasi dallimet janë të shumta: kohore, kulturore, të shtresës njerëzore (mbret/i zakonshëm), dallime morale, etike, religjioze, etj. Genti mbret/atëherë me vargje, aktorëve/tash pa to. Kjo *atëherë* e *tash* zbulon se nuk është dallimi vetëm i njerëzve, por edhe i tipave të shkrimit në kohë të ndryshme, kështu ligjërimit bëhet problem më i thellë. Vargjet i patëm për atëherë dhe për mbretin, atëherë duke na ndërlidhur afërsisht me kohën e tragjediive antike (Genti, shek. II p.e.r.), e për mbretin, pra, edhe me tipin e protagonistit të tragjediive, mbinjeriun. Vargjet me komunikim të dyfishtë me antikën: me komunikim formal/afërsia kohore, e esencjal/vargjet

Milazim Krasniqi, përveç të tjerash, nga ligjërimit i vjetër shfrytëzon edhe ligjërimit oratorike. Në situatat e Gentit ka ligjërimit të mjaftueshme me retorikë të pasur, që del më hapur veçanërisht po të vihet përballë bisedave të aktorëve.

dhe protagonistit - mbinjeriu. Në këtë rend rikontekstualizimi i tyre te *koha e kultura* e Gentit me një përzgjedhje jo të rastësishme. Aktorët në pjesën e dytë kanë ligjërimit të natyrshëm, tash njëjtë edhe si dramat e tashme. Dramatikë e vjetër e dramatikë e re, ja ideja esenciale e ligjërimit. Madje në kombinim, duke e treguar karakterin përmbledhës të dramës. Njëherë se dy kohët (e njerëzit e tyre) kanë ligjërimit të ndryshëm e tash se ai ligjërimit mban brenda edhe kohën, kulturën e ideologjinë që ata përfaqësojnë. *Monedha e Gentit* është e shkruar më 2003. Kjo tregon absurditetin e shkrimit të dramës në vargje që M. Krasniqi arrin ta shfrytëzojë e konvertojë në vlerë. Ajo tash bëhet mjeshtri për ta rritur objektivitetin e një konteksti kohor, vendor, kulturor të mëhershëm, kontekstin e një atmosfere të caktuar me një kategori të caktuar shoqërie, aksioni e komunikimi të zgjedhur mes tyre. Me këtë M. Krasniqi sikur na thotë se nuk ka shkrim që është mbyllur, që është përfunduar për letërsinë. Letërsia është jashtë një kohe,

andaj edhe me fuqi shtrirjeje hapësirave të ndryshme, rikontekstualizimi të shkrimeve, teknikave, temave, figurave, e shenjave të ndryshme estetike. Konkretisht po rimerret shkrimi në vargje për të shenjuar kohën e kulturën e mëhershme. Në të mirë të kësaj, edhe shkrimi i vargjeve pa rimë e pa rrokje të caktuar, apo vargje me sistemin e vjetër që mbështeten në sistemin ritmik, në këmbë, në rrokje të theksuar e të pathek-suar, sistemin e të gjitha vargjeve greke e latine. Pra, edhe jo shkrim në çfarëdo vargu, në varg të vjetër. Njëjtë si De Rada që shkruante *Milosaon* pa rimë e rrokje të barabartë, duke e dhënë si krijim të vjetër popullor, që sipas tij ishte i ngjashëm me atë homerik. Kjo pak a shumë kur autorët e shpjegojnë njëri-tjetrin. Vetëm po shohim një kërkesë të njëjtë të mëhershme, veçse M. Krasniqi më arsyeshëm, pasi ndërlidhet jo me motin e madh por me atë të njëkohshëm me shkrimet e tragjediive antike. Thamë se shkrimi i tillë ndërton objektin e kohës së caktuar, andaj edhe bartja e vargjeve të tilla në kohë të tjera më me pak efekt. Ta kujtojmë vetëm se De Rada e bartte atë shkrim te moti i madh, por i duhej edhe një parathënie për ta arsyetuar atë, gjë që tash për shkak të afërsisë kohore të ngjarjeve do të ishte e tepërt.

Ligjërimit i pjesës së parë edhe të tretë është i zgjedhur, me fjalë të pasura e të larta. Kjo tregon se autori përmes fjalëve shënjon atmosferën aristokrate në të cilën zhvillohet ngjarja. Me ligjërimit e lartë e atmosferën aristokrate sikur tregon një përpjekje edhe më serioze për ndërtimin e kontekstin antik, madje duke u ndërlidhur vetëm me tragjedinë e saj, pasi nuk ka ligjërimit të ultë, pra tash përmes ligjërimit tregon kohën kur dallimet zhanrore obligonin edhe ligjërimit krejt të ndryshme, të kohës ku kundërvënia tragjedi - komedi, ligjërimit i ultë – ligjërimit i lartë, mbinjeri – njëri i ultë, ishte i madh. Pra, në njërin anë,



Ilazim Krasniqi

ndërton një ligjërimit të zgjedhur e në anën tjetër nënkupton një kohë të hershme kur ndasia mes zhanreve dramatike ishte e madhe. Këtë ligjërimit të lartë M. Krasniqi e fillon dhe e mban me mjeshtri deri në fund. Pra, me mjeshtri, pasi ky ligjërimit respektohet edhe në të gjitha gjendjet e krizat e protagonistit, gjendje në të cilat zakonisht ka shpërthime emocionale, e me të edhe shprishje të fjalës. Këto raste kalohen me tensione të mëdha, me thirrje emocionale, zhurmë e mallkime, por prapë me ligjërimit të lartë. Pra, ruhet karakteri i mbretit në të gjitha rastet. Përveç kësaj, ligjërimit i lartë ka bërë që shpesh edhe shqyrtimet e temave, problemeve, kërkesave, etj. të bëhen në një formë më të përgjithshme, të abstraguar. Kjo veçanërisht te frazat përmbyllëse, rezymuese, përmbledhëse, etj:

*Pritja nuk do të thotë kurrësi disfatë, o mbret
Por kërkim i rrugëve për të ruajtur nderin*

Kjo prodhon ligjërimit që nderin, shpresën, ndihmën, pritjen, etj. i trajton si të përgjithshme. M. Krasniqi e shfrytëzon mirë një gjë të tillë. Kjo i jep mundësi të ngritjes së problemeve prej të veçantave në të përgjithshmen. Kjo tregon se M. Krasniqi jo vetëm që e njeh dhe e shfrytëzon atë kohë por bën edhe lojë me të. Ai arrin ta shfrytëzojë edhe për qëllime të modernitetit, për konotacione e kombinime kohësh. Ai, në sistem letrar me këtë, na zbulon një fenomen të rëndësishëm: letërsia e kohëve moderne sikur thotë se ka shfrytëzuar në gjitha nivelet, shenjat antike, vetëm duke i rikontekstualizuar në sistem të ri. Shkrimi me figura, miti/mbinjeriu, ritmi i situatave, tragjikja e komikja, etj. janë vetëm disa prej atyre që argumentojnë këtë ide, pasi janë njësi që kurrë nuk i kanë ndarë shkrimin letrar.

M. Krasniqi bashkë me ligjërimit ndërton strikt edhe zhanrin (në pjesën e parë dhe të tretë), tragjedinë, njëjtë si në antikë. Bile aq strikt sa nuk fut asnjë gjë të vetme që do ta vinte në rrezik atë strukturë. Ai shkruan edhe

më kodifikueshëm se tragjeditë e tipit të Shekspirin. Se gjithë kjo ndërtohet qëllimisht tregon edhe fakti se në pjesën e dytë kemi kombinime të tilla; kombinime të ligjërimit të lartë e të ultë, serioz e banal, kombinime të zhanreve tragjike e komike, etj., tash njëjtë si në modernistët. Zhanri serioz herën e parë e i kombinueshëm herën e dytë tregojnë se, edhe në strukturë më të thellë, shkrimi është i ndërlidhur me idenë e dallimeve të mëdha të dy kulturave. Tash mesazhi prej zhanrit, prej strukturës së thellë, të padukshme, sikur më parë nga ligjërimit i lartë e mbinjeriu, në esencë tregon për dramën e menduar mirë, ku të gjitha strukturat e dukshme dhe të padukshme, formale e esenciale të çojnë nga e njëjta ide, nga dallimet kulturore.

M. Krasniqi, përveç të tjerash, nga ligjërimit i vjetër shfrytëzon edhe ligjëratat oratorike. Në situatat e Gentit ka ligjërime të mjaftueshme me retorikë të pasur që del më hapur veçanërisht po të vihet përballë bisedave të aktorëve:

*Pa na u trembur syri, ne përpara do të sulemi
Dhe e përjetësojmë me lavdi emrin tënd*

Tash retorika është e përafërt me atë të tragjeditë greke, apo edhe me ato të shek. të XVII-të, me ato të klasicizmit. Veçse po ecim nëpër pika të ndryshme që, me rend, përforcojnë nga anë të ndryshme ide e rende kulturore të caktuara. Ligjëratat oratorike në pjesën e parë dhe të tretë shpesh nuk i lënë problemet të shënjojnë drejtpërdrejt, duke kërkuar edhe një lexues model, pasi ato shoqërohen me fraza bombastike, me çka rritet hapësira e shkrimit për ta theksuar një ide.

Ligjërimit për karakteret është një njësi fundamentale në ndërtimin e tyre. Ata, këtu, ndërtohen edhe me veprime e edhe nga loja e imazheve të didaskalive. Tragjedia e Gentit luhet vetëm në tri vende (brenda kështjellës, para kështjellës dhe në sheshin para Senatit romak). Në këtë kuadër, edhe veprimet janë shumë të vogla, kurse didaskalitet edhe prej natyre janë të pakta. Gjithë

këto veçse po tregojnë për shtrirjen dhe fuqinë më të madhe të ligjërimit për karakteret në këtë vepër. Çdo shprishje e ekuilibrit i jep funksion njërit element më shumë që tash te *Monedha e Gentit* mungesa e veprimeve po zgjeron shtrirjen e ligjërimit. Përmes tij, M. Krasniqi arrin të bëjë personazhe të ndryshme duke dhënë shkallë inteligjence të ndryshme, dallimet gjinore (përmes emocioneve, mendimeve, mendjelehtësisë, etj), dallimet mes trimit e frikacakut (Polemokreti-Pantauhu), dallimet mes besnikut e dyfytërshmit, duke dhënë ligjërimitin e veçantë të barbarëve, brishtësinë e fëmijëve, etj. Që të gjithë, M. Krasniqi i bën të flasin me zërat e tyre të veçantë, andaj edhe si të ndryshëm, që prej fjalëve, ideve, emocioneve, reagueshme (të menjëhershme apo të mëvonshme), etj. deri te ndërtimi i tërësishëm i ligjërimit të secilit: tjetër mbreti, tjetër mbretëresha, tjetër Platori, tjetër barbari, etj. Më lart e pamë se nga mungesa e veprimeve ligjërimit me mjeshtri largonte boshësinë dhe i ndërtonte, ndërsa tash me veçanti edhe po i dallon njëri nga tjetri. Edhe në relacion me situatën, ligjërimit merr një funksion të rëndësishëm. Kjo pasi çdo lëvizje në dramë shoqërohet, përforcohet e mbështetet me të, duke dhënë shenjat varësisht prej karakterit të situatës:

ETLEVA

*Lamtumirë O Skodra jonë e dashur
Se nuk e di a do të shihemi më për të gjallë,
Dhe ti o Barbanë e kaltër si syvashe, lamtumirë
Dhe qaje fatin tonë me lotët e tu të kthjellët
Derisa të shteron gjiri i Rozafës*

Kjo kur internohen në Romë, por i njëjti shoqërim ndodh edhe kur tradhohen nga romakët, kur iu vdesin fëmijët (Skerdilaidi, Pleurati), vëllai (Karavanti), etj. Thamë mbështeten nga ligjërimit, pra vetëm mbështeten, pasi në esencë ligjërimit i personazheve në këto raste nuk shkon asgjë në të mirë të lëvizjes së ngjarjes, të çuarjes të saj përpara. Me to nuk vihet diçka në shqyrtim, nuk vendoset asgjë për to, etj. Ligjërimit i tyre vjen pas rrjedhës së situatës. Në këtë rend, ligjërimitet e tilla veçse tregojnë efektin e madh a të vogël të ngjarjeve, duke mos i lënë që lëvizjet, ngjarjet, kthesat e mëdha të duken mekanike e të pamotivuar. Përveç kësaj, ligjërimitet të tilla thamë se

ka edhe kur Genti i vdesin fëmijët, ose edhe vëllai. Tash edhe me dy funksione, përforcohet karakteri i babait e vëllait dhe rëndësia e situatës. Në raste të tilla, situatat tregojnë për karakterin dhe pozicionin e tij, njëjtë sikur karakteri për situata.

Didaskalia

M. Krasniqi në dramën *Monedha e Gentit* i shfrytëzon estetishtë të gjitha shenjat e tekstit. Me këtë vetëm po tregojmë se ai i relativizon edhe ato që më parë shiheshin si të jashtëme, si tash didaskalia që esencialisht luan rolin e njëjtë me shenjat e tjera të tekstit. Didaskalia, sikurse teksti tjetër i dramës, përveç funksionit të shpjegimit e përshkrimit, këtu ka edhe rol estetik, fabular, artistik, etj. Ai zakonisht ka funksionin e shpjegimeve, rrëfimeve e përshkrimeve estetike, duke bërë përpjekje për komunikim mes arteve të ndryshme: përshkrimi me artet figurative – të imazheve, kurse rrëfimi e përshkrimi me artet narrative (në prozë me romanin e novelën, ndërsa në vargje me epikën e poemën). Drama ka mjaft raste të cilat tregojnë se M. Krasniqi në didaskali luan me imazhe. Në fillim, përmes lojës së tyre, autori tregon ndryshimin e ditëve, kalimin e tyre, madje duke i shtënë në lojë edhe personazhet, pasi moslëvizja e tyre shenjon kalimin e shpejtë të kohës gjatë krizave, problemet e njëjta me të cilat mbetet, gjendjet e njëjta dramatike, tensionet, preokupimet, dilemat dhe moslëvizjen e tyre në ndonjë drejtim, etj:

(Errësimi në skenë tregon ndryshimin e ditës dhe natës. Kjo përsëritet dy herë, ndërsa personazhet që janë në skenë mbetën të palëvizshme. Pastaj skena mbetet e ndriçuar.)

Përveç lojës me imazhe, në nivel të njësive dramatike ndërrimet e tilla janë të reja, të modernitetit. Kjo tregon se çdo gjë në dramë nuk është antike. Teksti i tillë jep idenë përmes simbolikës së ndërrimit dritë/terr, apo përmes shenjave moderne. Me të M. Krasniqi dëshiron t'i shfrytëzojë mirë elementet e teatrit bashkëkohor: dritat, rekuizitat, mizanskenën, etj., çka dëshmon se përkundër elementeve antike, drama është shkruar të luhet në teatrin modern, prandaj edhe shenjat antike vetëm me vlerë estetike, ta krijojnë rendin estetik, ta krijojnë kontekstin e iluzionin e të

kaluarës. Kjo për didaskalitë me shenja simbolike të kohës, ndërrimit të shpejtë në kriza. M. Krasniqi në didaskali vë në lojë edhe shenja simbolike që ndërlidhen me historinë tragjike të mbretërisë së Gentit. Ndër to më e rëndësishmja është loja me statujën argjile, që jep edhe tri fazat nëpër të cilat ka kaluar Genti. Madje, për ta përfurcuar përdorimin e qëllimshëm, bën që Genti të komunikojë me statujën jo një herë, por tri herë:

GENTI

(E përplas një statujë të vogël për tokë)

.....

GENTI

(Gërmuqet dhe përpiqet të mbledhë copëra të statujës së thyer)

.....

GENTI

Le të hyjnë (Anici me ushtarë - M.Ç.) se koha tash për ne është ndalur!

(Lëshon copat e statujës nga duart...)

Shihet jo një komunikim i pakontrolluar, lëvizjet e vazhdojnë njëra tjetrën të vëna në sistem. Madje, se është gjë serioze dhe e ndërlidhur me situatat e atmosferën e ngjarjeve, e tregon edhe kjo thënie e Karavantit pas thyerjes së statujës:

O do të vdesim si na ka hije në beteja

O do të thyhemi si kjo statujë argjile

Këto imazhe simbolikisht japin rrjedhën e vërtetë të historisë shqiptare, veçanërisht atë të sundimit të Gentit, për fatkeqësinë e thyerjes me romakët dhe të mbylljes në kështjellë. Karavanti veçse haptë problemin e ndërlidhjes së statujës me popullin shqiptar. Këtë e ndihmon edhe hyrja e Anicit, duke ia lënë gjysmë mbledhjen e statujës që korrespondon me vitet e ndërhyrjes së armikut, kur Genti kishte mbledhur veten pas gabimeve dhe ishte duke bashkuar popullin afër vetës. Në këtë, statuja simbolikisht thotë se Genti njëherë e theu popullin shqiptar, më pastaj ai po bën përpjekje për t'i mbledhur afër vetës, përpjekje që i mbeti përgjysmë, për shkak të ndërhyrjes së armikut, për shkak të pushtimit të huaj. Se kjo simbolikë është e vërtetë, na tregon edhe rendi deklarativ që më hapur e më drejtpërdrejt del në një vend tjetër. Ne vetëm kujtuam lojën simbolike

të imazheve që jep ide të ndërlidhura me Gentin:

PLATORI

Fillove të zdërhallesh në ndeja të turpshme Me verë të vjetër e me gra të përdala Duke e shkruar motin pa e vrarë mendjen Si e si të forcohej Mbretëria Iliriane, Për të dëbuar armiqtë e shumë nga kufijtë Ku prisnin me dhëmbë përjashtë si ujë të uritur

Pra, didaskalitë edhe me lojën e imazheve historike. M. Krasniqi tregon se shfrytëzon të gjitha mundësitë e dramës edhe të tekstit, edhe të shpjegimeve, të imazheve e veprimeve, etj. Gjithçka në didaskali përdoret vetëdijshëm, jo më me pak estetikë sesa ligjërimet e personazheve, sesa qëndrimet a veprimet e tyre, ajo bëhet pjesë e estetikës së dramës, pjesë e ideve të saj, herë plotësuese e vazhduese e tyre, herë pjesë e dramës antike e krijimit të atmosferës dhe iluzionit të atëhershëm, krijimit të kontekstit, andaj edhe jo rastësisht si në tekstin zyrtar të dramës, si në ligjërimet e personazheve, po ashtu edhe në didaskali, Shkodrën e kemi njëjtë me emrin Skodra, çka nuk do të duhej të ishte po të mos ishte me funksion të njëjtë didaskalia me bisedat e personazheve: **(Në prapavijë fillon të duket zjarri, që përpin qytetin e Skodrës...)**

Simbolika vendore në dramë

Pozicionet vendore në shkrimet letrare kanë qenë përherë hapësira të cilat janë shfrytëzuar për t'i vendosur shenjat me funksione të ndryshme simbolike. Simbolika vendore në tekstet e tilla ka fuqi të madhe për përcaktimin e simbolikës së shkrimit, për estetikën dhe përgjithësimin e ideve të tij, ka funksion të madh për dhe në kronologjinë e ngjarjeve, etj. *Monedha e Gentit* përmbledh një rend të rëndësishëm simbolikash vendore, të shpërndara nëpër vende të ndryshme të tekstit, për ta vënë theksin ku më shumë e ku më pak, varësisht prej kërkesës së kontekstit të shkrimit. Pra, jo vetëm vendosje e vendeve me simbolikë, por edhe përpunim i atyre shenjave, pasi ato përzgjidhen në relacion me kontekstin e shkrimit, duke thënë se ato komunikojnë ndryshe në një situatë të qetë e ndryshe në një dramatike, ndryshe në pritje e ndryshe kur protagonistit është në pranga, pra, në relacion me situatat, fabulën, personazhet, problemet

e dilemat e ndryshme. Prandaj, jo rastësisht kur është në pritje, më shumë e vret indiferenca e fqinjët tokësor (Maqedonisë), prandaj tash më shumë përmendet, më shumë diskutohet, më tmerruese e me dhembje mosndihma e saj, përmendet kur ende ka mundësi për të shpëtuar pa rënë te romakët. Ajo kurrë s' do të përmendet kur prangohet Genti, kur çdo gjë ka përfunduar. Pra zgjidhet vendi, përmendja e tij ku ka më shumë funksion fabular, ku më shumë rrit tensione, rrit emocione e dhimbje, etj. M. Krasniqi e shfrytëzon simbolikën hapësinore pasi e vendos Gentin në mes të armiqve me dredhi të ndryshme. Sipas tij, fqinjët tokësorë janë të pabesë, ndërsa nga Deti është armiku. Mes maqedonasve, Perseut dhe romakëve. Madje me këto shenja, duke shfrytëzuar edhe gjithë historinë shqiptare, gjithëherë fqinji tokësor ka qenë i pabesë, me vrasje të ngadalshme e tinëzare, e nga deti armiku i madh, pushtuesi. Nga kjo figura vendore bëhen edhe me ngarkesë intelektuale. Mbi këtë simbolikë ndërtohet gjithë drama. Jo rastësisht e kemi *detin* më shumë si të përgjithshëm:


Dhe e dëbojmë Anicin deri në det

Pra, që të dy fqinjët janë armiq, por secili në formën e vet, në kriza njëri i premtion ndihmë e nuk i sjell (Perseu), ndërsa tjetri vjen dhe e pushton krejt (Roma). Njëri mundohet ta pushtojë me dredhi e tjetri me forcë, edhe nga asnjëri nuk ka siguri:

O do të na shqyenin bishat e Perset O do të na gëlltitnin peshkaqenët e Romës

Pra pushtuesi vjen nga deti, apo nga i njëjtë vend nga vjen Bajlozi i zi te Gjergj Elez Alia i letërsisë popullore. Më lart pamë referencën e figurës së pushtuesit të historia, ndërsa tash edhe te letërsia popullore. Veçse po vërejmë përpjekjen e suksesshme të M. Krasniqit, që me mprehtësi arrin t' i gjejë shenjat e përbashkëta historike e mitike, të forta e tejkohore për shqiptarët. Rëndësia e shenjave vendore rritet gjersa kemi të bëjnë me një temë historike të luftës, ku tërë kohën është problemi i pushtimit, i dëshirës dhe kërkesës për ndihmë, për largimin e pushtuesit, strategjitë për shpëtim, etj. Pra zgjidhet simbolika

pushtuese për vendin në dramën historike, kjo pasi vendi mund të ketë edhe simbolika të tjera, të vdekjes së jetës e ngjalljes së saj, të lirikës e epikës, të varfërisë e pasurisë, etj. Drama te Genti nuk ka dinamikë në nivelin e lëvizjes së vendeve. Përmendëm se ngjarja zhvillohet në vetëm tri vende (në kështjellë, para kështjellës dhe në sheshin para Senatit romak). Pra tri vende, saktësisht sa numri mitik, as më shumë, as më pak. Sikur theksohet rëndësia më e madhe e saj për historinë shqiptare sesa e të tjerave, karakteri sipëror krahas të tjerave. Prandaj si e tillë, me të do të bie mbretëria ilire njëherë e përgjithmonë. Përveç kësaj, me lëvizjet e pakta, vetëm të të triave, Krasniqi veçse dëshiron simbolikisht të japë mbylljen e një mbretërie, kufizimet strikte të saj, kufizimet në lëvizje, mostolerancën e moskomunikimin si pasojë e të cilës do t' i vijë edhe fundi. Me këtë po vazhdon idenë për fatkeqësitë e ndryshme që kanë ndikuar në shkatërrimin e mbretërisë, veçse tash idenë përmes simbolikes vendore për moskomunikimin e mostolerancën që kanë mbështetur përfundimin tragjik të mbretërisë ilire. Madje patëm tri vende, prej tyre dy në pjesën e parë e një në të dytën. Pra, teksti po krijon një trekëndësh:



Pra, pak a shumë, simbolikisht prej situatës më të qetë drejt asaj me dramatikë, drejt kulminacionit. Kështu struktura e numrit të vendeve, në pjesën e parë dhe të tretë, po tregon simbolikisht vijën e lëvizjes së ngjarjeve, prej më të qetave drejt atyre me tensione më të mëdha, më dramatike e tragjike. Për këtë edhe të gjitha vdekjet e të afërmve i kemi në pjesën e dytë: të dy djemve, të vëllait, etj. e jo në pjesën e parë, atje ku vendet shenjojnë më shumë qetësi. Pra, edhe tash zgjedhja e vendeve bëhet me vetëdije dhe te qetësia, edhe te tensioni e dramaciteti. Më parë e patëm simbolikën vendore në relacionet me fqinjët, i pabesë/dyfytyrësh a armik/pushtues, simbolikën me mbylljen e mbretërisë, identifikimin e numrit të vendeve me

treshin mitik, ndërsa tash simbolika vendore në relacion me shkallët e ndryshme të tensioneve në dramë. Veçse po shohim se figura vendore te kjo dramë e përcjell shkrimin në vazhdimësi duke shenjuar në kontinuitet me ngjarjen ide, struktura, emocione, etj. varësisht prej kërkesave të shkrimit. Përveç se janë shenja që në vete kanë ngarkesë simbolike, ato përcjellin rendin e situatave me përpikëri dhe vendosin relacione që lidhen drejtpërdrejt me to.

Zhanri dhe strukturimi

Në modernitet shkrimet bëhen vend eksperimentesh duke kombinuar dhe duke kërkuar forma të reja, tema, ide e probleme të ndryshme, kombinime të ndryshme të zhanreve, fabulave, kohëve, kulturave, etj. *Monedha e Gentit* është njëra prej rasteve që kombinon mjeshtërisht zhanre të ndryshme, ide, kohë e probleme, shenja nacionale e internacionale, të identitetit të përkohshëm e të përhershëm, duke krijuar një simbiozë me sinjale denotuese e konotuese për probleme që kanë shoqëruar shqiptarët gjatë tërë historisë. Fillimisht kjo dramë ka në epiqendër jo një dramë të mirëfilltë, por ushtrimin e një drame historike nga disa aktorë, gjë që automatikisht tregon dallimet mes kohës së situatës dhe asaj të aktorëve që e ushtrjnë atë. Njerëzit e njëjtë, me kohë të ndryshme, duke zbuluar karakteristikat e secilës kohë, varësisht prej kërkesës së tekstit. Kjo zbulon personazhet simbolike me ngarkesa të ndryshme, duke thyer unitetin kohor në të mirë të artistikes e simbolikes së tekstit dhe, në anën tjetër, tekstin me ndërlihdje të fortë të të gjitha njësive ku secila ka vendin, kohën e funksionin e caktuar dhe me ndryshimin e vendit ndërron edhe koha edhe funksioni i njësive. Situata është historike për aktorët e largët për ta, prandaj edhe bëhet kombinim i dy kohëve të largëta. Dallimet mes tyre bëhen esenciale, gjersa secila prej këtyre dy kohëve tërheq pas rinde të veta kulturore, morale, emocionale, probleme të ndryshme ekzistenciale, shoqërore, të realitetit, imagjinatës, etj., apo që secila kohë është krijuar me një tërësi ligjesh komplekse që kujtojnë dallimet qenësore mes tyre, me mundësi bartjeje vetëm të atyre që janë tejkohore për shqiptarët. Ndërsa me vendosjen në epiqendër të provave të një drame, si-

kur përjashton dramën tradicionale me elementin fundamental të saj, siç është shprishja e rendit linear të fabulës. Pra, qëllimisht iket prej dramës që ka fillimin e mbarimin e një rrjedhe fabulare me njerëz të caktuar, me kohë të caktuar, vend, probleme, kërkesa, etj. tek provat e saj. Kjo prodhon dy anë të ndryshme estetike. Në relacion me ngjarjen shumë serioze të Gentit, tragjedinë tipike të tij, provat krijojnë thyerjen e diapazonit të pritjes; paralajmërojnë lojën për një situatë shumë serioze. Por, prapë, përkundër provave, tragjedia (në pjesën e parë dhe të tretë) realizohet me të gjitha kapacitetet zhanrore të tragjedisë, me ç' gjë M. Krasniqi, sikurse karakteri i shkrimit, nuk varret nga paralajmërimet si lojë, komikë a tragjikë, por nga natyra e cilësia e tij, nga realizimi i shkrimit, i proporcioneve

zhanrit (të nënlojeve të dramës), pjesa e parë dhe e tretë janë tragjedi, ndërsa pjesa e dytë dramë tipike. Pra edhe në nivelin zhanror kemi kombinimin tragjedi-dramë. Madje shtrirja e tragjedisë, me gjitha kërkesat e saj, nga një pjesë e tekstit dhe e dramës me kërkesat e tjera të saj në pjesën tjetër të tij, tregojnë se ai kolazh është ndërtuar me përpikëri prej pjesëve proporcionalisht të rregulluara mirë aq saktësisht sa ndërtojnë njëkohësisht dy zhanret në një shkrim, porse i ndarë secili në pjesën e vet. Kjo tregon se nuk është thyerje e ikje e thjeshtë. Struktura e saj është e menduar dhe e ndërtuar mirë, është e renditur dhe e kombinuar me saktësinë më të madhe. Ndërhryret e aktorëve M. Krasniqi i shfrytëzon edhe për rikontekstualizimin e një problemi tjetër. Ata diskutojnë për veprën, e vlerësojnë,

e freskim me tërësinë e përgjithshme të rrjedhës fabulare. Ndërsa në nivel kulturor problemet kulturore të dy kohëve, konceptet e ndryshme në këtë rend edhe ndërhyrja sjell komunikimin mes tyre me shqyrtim e rivlerësim, komunikim për ndryshimet e mbetjet kulturore, etj. Rivlerësimet e tyre edhe tash me tensione që indirekt zbulojnë kompleksitetin e tyre, shenjat e dyshimta, etj. që jo vetëm në kohën e ndodhjes janë përcjellë me tensione, por edhe në kohët e tjera më pas sa herë që janë rishqyrtuar. Dy tensione atëherë e tash, ndërron koha, por jo dramaciteti e artistikja. Kështu ndërrimet kohore, të problemeve e situatave janë më shumë strategji të shkrimit për të arritur që sa më mirë të jepen shenjat karakteristike të popullit shqiptar e jo më shumë. Parim drejtues në fakt është artistikja. Ajo prek çdo njësi duke e konvertuar herë në figurë, herë në komik, herë në tragjik, etj. Prandaj bëhet edhe ndërhyrja e së tashmes, jo thjesht për komunikim kohësh, por edhe për funksione të tjera estetike, që indirekt zbulojnë problemet e kohëve, tensionet, kompleksitetet, krimet, etj. Kështu vërehet komunikimi formal e esencial, ndërhyrja e së tashmes si formale e pasojat e saj për të treguar natyrën komplekse të ngjarjeve nga nënteksti edhe si esenciale, çka zbulon në njëherë anë ngarkesën e shenjave, e në anën tjetër funksionimin njëkohësisht të nivelit të parë formal-denotues të tekstit dhe të nivelit të dytë indirekt-konotues.

Thamë se kjo dramë ka për objekt provat e një drame historike, ndërsa tash vetëm po kujtojmë se identifikimi se janë prova vërehet vetëm në fillim të pjesës së dytë, më saktësisht kur përfundon 1/3 e shkrimit. Me të veçse po vërejmë se autori në këtë dramë arrin që për fenomene të ndryshme të zgjatë perceptimin, të mbajë probleme në tension, të mbajë enigma, etj. duke thënë se duhet lexuar/shikuar i gjithë teksti për të nxjerrë një përfundim, për të arritur për ta parë problemin në tërësi, idenë, enigmën, etj. Kjo tregon se esencialisht M. Krasniqi problemet e këtij shkrimit i kalon nëpër rënie e ngritje, në batica e zbatice të ndryshme, fshehje të përkohshme, në largime, zbulime, deklarime, etj., një normë kjo që vlen për të gjitha çështjet e shkrimit, prandaj edhe me kërkesë të patjetërsueshme për leximin/shikimin e tërësishëm të saj. Madje, zgjatje e perceptimit pasi në



të pjesëve dhe komunikimit të tyre me tërësinë, nga fuqia e shenjave në kontekste të ndryshme, etj. Në anën tjetër, me ikjen prej dramës tradicionale, tregon se kjo dramë e zgjeron shtrirjen e strukturës dramatike edhe jashtë disa normave të mëparshme, tash me provën e saj. Përveç kësaj, ikja te provat e dramës e zbritja herë te Genti e herë te aktorët që e luajnë atë prodhon një dramë-kolazh, dramë-mozaik, e bërë prej pjesëve të ndryshme që secila plotëson në një mënyrë vendin e vet. Ikja më parë thyente diapazonin e pritjes, ndërsa tash po krijon dramë kolazh. Në të dy herët vërehet një mjeshtri e modernitetit, e thyerjeve tradicionale, veçse herën e parë pasi vihet drama në relacion me marrësin/lexuesin, ndërsa herën e dytë pasi ajo vihet në relacion me dramën tradicionale. Në relacion të

e komentojnë, vënë në dyshim pjesë të caktuara, etj., pra janë edhe në rolin e receptuesit. Në këtë kontekst drama inkuadron edhe receptuesit në shkrim. Dalja prej tradicionales e fabulës tërheq pas edhe probleme tjera mbështetëse. Madje patëm aktorin me funksionin e receptuesit, apo tash kombinim aktor e receptues bashkë. Veçse po shohim për shfrytëzimin e anëve të ndryshme të tyre, gjë që i bën të duken edhe si personazhe figura, që varësisht prej vendit e nevojës të zbulojnë shenja të ndryshme të përshtatshme me kontekstin e shkrimit. Në nivel të kohës kemi gërshetim të të dyja kohëve, të kaluarës (pjesa e parë dhe e tretë - Genti) me të tashmen (pjesa e dytë - aktorët). Në nivelin ritmik ndërhyrja e së tashmes në mes dy pjesëve historike sjell freskim në temë, ide, probleme

tekst mungojnë shpjegimi, informacioni plotësues, komentimi, etj. konkretisht se është provë e jo dramë. Tash vlera nga mungesa e shenjave. Kjo tregon se M. Krasniqi di t'i shfrytëzojë me mjeshtri edhe shenjat, edhe mungesën e tyre, kjo pasi për to zgjedh kontekste të ndryshme. Kur ka shenja ato i ngarkon me konotime të ndryshme e kur nuk ka i rregullon zbrazësitë, vakumet e hapësirat, ashtu që të arrijë zgjatjen e enigmave.

Idetë - formësimi material dhe kulturor i kohës së Gentit

a) Komunikimi me tragjeditë antike

Më lart, në nivelin e ligjërimit pamë komunikimin e shumanshëm të dramës me ligjërimin e vjetër të tragjedive greke. M. Krasniqi shkruan në vargje me bazë ritmike, me këmbë, me gjuhë të zgjedhur e fraza të larta të mbinjeriut dhe me karakteristika oratorike, njëlloj sikurse tragjeditë e vjetra. Por autori komunikimin me antikën, veçanërisht me tragjedinë e saj, e shtyn edhe më tej në nivele të tjera. M. Krasniqi shfrytëzon shumë probleme letrare për të dhënë atmosferën sa më tipike të kontekstit antik/parabiblik, në të cilin zhvillohet ngjarja. Madje identifikimi i shumanshëm i kulturës së Gentit me atë greke, që tash ndodh edhe pavetëdijshëm, jep idenë e përforcuar për një ngjashmëri kulturore të ilirëve me fqinjët (grekët), apo edhe idenë problematike se esencialisht e ashtuquajtura kulturë greke nuk është vetëm e një populli, por e më shumë, me pjesëmarrje të posaçme veçanërisht të popujve të Ballkanit. Sikur thotë se atëherë s'ka pasur kufij nacionalë (etnikë), të shtrirjes së sundimit, kritere të komunikimit, ndasi kulturore, prandaj edhe pa mundësi ndarjeje bardh-zi, të dijshëm-barbar, si interpretohet zakonisht. M. Krasniqi nuk i bart gjitha karakteristikat e dramaturgjisë antike. Në fakt ai përzgjedh vetëm ato më fundamentale, të forta dhe qenësore të tragjedisë antike. Duket e thjeshtë, por kjo i mundëson ndërtimin e dramës së re me strukturë të vjetër, pasi parimet e tjera dytësore i ka personale. Pak a shumë, duke u fshehur pas deklarimit të shkrimit të vjetër (tragjedisë), ai shtrin shkrimin e shpërthimeve personale. T'i kthehemi shenjave të tjera komunikuese. Genti në një rast thotë:

**Tash ne fati na ka ngarkuar barrë të rëndë
Dhe dëmin e disfatave të kaluara romake
Edhe hakmarrjen e tyre të mbetur
përgjysmë**

Duhet ta paguajmë ne me jetët tona

Kjo na dërgon te komunikimi me një element, ndër më të rëndësishmit të tragjikes greke, me mëkatin trashëgues që atje është promotori kryesor i tragjikes. Lufta e të shtatëve kundër Tebës, vdekja e Eteoklit dhe Poliniklit, më pas edhe e motrës së tyre Antigonës, bëhen pasi janë të kushtëzuar nga mëkati trashëgues i tyre, nga mëkati i prindërve, i Edipit dhe Jokastrës, apo nga mëkati i martesës së birit me të ëmën. Prandaj mëkati trashëgues te tragjeditë antike, i cili kontrollon rrjedhën e ngjarjes drejt fatkeqësive duke krijuar ndeshje, mospajtime, dramatik e tensione, gjithnjë duke paracaktuar fundin me luftë e vdekje, pra me tragjik. Sipas kësaj logjike funksionon edhe jeta e Gentit në këtë tragjedi. Thëniet e lartshënuara vetëm deklarorin atë që qëndron në nëntekst të situatave deri në fund. Përveç kësaj, Genti jo nga mëkati i bashkimit të prindërve, por nga lufta e tyre me romakët. Pra komunikim po, por jo komunikim i verbët por me përshtatje. M. Krasniqi sikur tregon se komunikimi e rikontekstualizimi nuk duhet të jetë ndërrim mekanik (i pamotivuar), por i përcjellë me elementet e përshtatshme për atë rend kohor, vendor, kulturor, shoqëror, etj. ku vendoset. Kjo aq më bindëse kur dihet se mbretërit/ilirët para Gentit ishin më shumë luftëtarë se çdo gjë, në këtë nivel edhe përshtatja është më me bazë, më me vlerë, shumë më funksionale për kontekstin shqiptar. Ky ndërrim po tregon edhe se në letërsi ka tema të përgjithshme, por që estetishtë kanë funksione të ndryshme, varësisht prej vendit, kohës e kulturës së tij. E patëm në njërin anë mëkatin trashëgues, e në tjetrën kohën e Gentit. Mëkatin trashëgues do ta marrë krishterimi në sistemin e tij kishtar, duke e bërë edhe të shenjtë si mëkatin e Ad- amit. Edhe vendosja para krishterimit bëhet rivlerësim tash pas sa shekujsh me kërkesën e zbulimit të një problemi shenjtor që rrjedh nga mitikja greke. Veçse po tregon se shkrimi i tillë me rendin e tillë të shenjave, para e pas, po ofron informacione të rëndësishme shtesë, me rivlerësim edhe dramacitet. Gjersa mer-

ret nga krishterimi, mëkati trashëgues bëhet me simbolik, i rëndësishëm edhe i ndjeshëm. Kjo jo e rastësishme, pasi më parë gjente shenjën e përbashkët të armikut nga deti edhe në histori, edhe folklor. Teksti i tillë bëhet njëkohësisht edhe mbulues (me mitin e Edipit), edhe zbulues (zbulon historinë e mitit katolik te grekët). E pamë edhe më lart, se M. Krasniqi merrte probleme të ndjeshme e problematike "greke a jogreke", sikur tash "krishtere a jokrishtere", për të përgjithësuar se problemet e ndjeshme janë qenësi e këtij shkrimi. Ai, në këtë dramë, përherë rivlerëson historinë e kulturën, rishqyrton, problematizon, vë në dyshim, etj.

Njësia tjetër fundamentale e tragjedisë antike, e cila bartet, është fati e fataliteti. Në nivel sasie ajo përdoret shumë shpesh, madje është mjaft e vështirë për të gjetur ndonjë ligjërim të personazheve pa të. Në këtë rend, sasia po bëhet tregues i rëndësisë së fenomenit. Ja fati në shtatë fjalët e para të personazheve:

- Orën e fundit të humbjes *fatale* e pres
- Sepse *fati* i mbretërisë është në fuqinë e arsyes
- Edhe *fati* juaj edhe fati ynë, o mbretër
- Se *fati* i mbretërive është i pandarë
- *Fati* na ka vu në sprova të rënda
- Tash ne *fati* na ka ngarkuar barrë të rëndë

Fati është prej koncepteve bazore në tragjeditë greke, madje atje ai është i paracaktuar më parë. Sasinë e pamë më lart, e në nivel funksioni a është i paracaktuar a jo, e tregon kjo:

**Por fati ynë është vendosur tashmë
Dhe nuk ka fuqi që mund ta ndryshojë**

Pra, edhe si fjalë (fati), edhe si funksion po tregon komunikimin me grekët. Se nuk është e rastësishme kjo sasi kaq e madhe, tregon fakti se te aktorët nuk përdorën bile asnjë herë të vetme fatin, fataliteti, paracaktimi i fatit apo edhe mëkati trashëgues. Pra, fati vetëm për variantin e vjetër, apo e hershmja njëjtë si shkrimi i vjetër/tragjedia e tashmja si shkrimi i ri/modern. Pra, tekstet ndryshojnë për ta vënë më shumë theksin në karakteristikat e tyre, konkretisht te fati, fataliteti e mëkati trashëgues. Përveç kësaj kjo po tregon edhe atë se gjersa nuk gërshtohen ato, drama ruan karakteristikat e se-

cilës pjesë veç e veç. Më parë u barteshin vetëdijshëm në shkrimin e vjetër, ndërsa tash edhe se ato vendosen vetëdijshëm në vendin më të përshtatshëm estetik.

M. Krasniqi, më parë, përmes kulturës greke shenjonte edhe probleme krishtere a jokrishtere. Se ai fuqishëm në nëntekst e ndesh kulturën greke e krishtere tregon edhe treshi mitik. Tash treshi mitik, gjersa më parë kishim mëkatin trashëgues çka na jep idenë se ai krijon jo ndeshje të gjitha botëve të tyre, por të shenjave kryesore. Më parë kishim tri vende, përveç kësaj edhe Pretor Anici ia jep 3 ditë Gentit për të menduar. Kjo shënjon jo vetëm tekstin simbolik, por M. Krasniqi thotë edhe se treshi mitik i krishterimit edhe më parë ka pasur një status hyjnor, një status mitik. Jo rastësisht Paridi zgjodhi në mes të tri hyjneshave të bukura (Afërditës, Herës dhe Atenës), ose jo edhe rastësisht në sistemin e lartë të miteve greke sundimin e gjithë botës e kishin *tre* vëllezër: Zeusi, Poseidoni dhe Hadi, duke e ndarë sundimin njëri në qiell e tokë (Zeusi), tjetri në det (Poseidoni) dhe i fundit në tokë (Hadi), dhe çdo gjë jashtë tyre ishte e dorës së dytë. Përveç rendit hyjnor, edhe rendi filozofik grek e ngrinte treshin në fuqi ndërtuese të botës. Timeu, në dialogun *Timeo* të Platonit, shpjegon formimin e gjithçkasë në gjithësi prej trekëndëshave. Sipas tij trekëndësha të ndryshëm u kombinuan në mënyra të ndryshme dhe dhanë katër elementet: tokën, ajrin, zjarrin dhe ujin. Pra, njëherë, trekëndëshat që prodhojnë njësitë fundamentale të krijimit, që sipas tij ishin toka, ajri, zjarri dhe uji. Gjithë kjo histori kulturore sikur e bën M. Krasniqin dhe tekstin e tij *problematik* të inkuadrojë probleme trashëguese, ta zgjojë problemin e komunikimeve kulturore, shkëmbimeve, bartjeve dhe ndërrimit të statuseve në kontekstet e reja, ndërrimin e funksionit, efektit, etj.; treshi merret, shenjtërohet (ndërrim statusi), bartet edhe te qenia e Zotit (edhe rifunksionalizohet me vend e funksion të ri). ai vetëm shenjon treshin disa herë te *koha e kultura* e Gentit, çka do të thotë se M. Krasniqi vetëm inicion problemet dhe mëkatin trashëgues edhe treshin, duke ia lënë ndërrimin e mëtutjeshëm lexuesve. Thamë se M. Krasniqi i shfrytëzon mirë të gjitha shenjat e tekstit duke i kristalizuar nga këndvështrime të ndryshme: të personazheve, të kulturës, të metafizikes, të tensioneve, të artistikes,

të figurave, ligjëritimit, receptuesit, etj. P.sh. ja shfrytëzimi i treshit: e pamë treshin për “krishtere a jokrishtere”, por edhe tri vendet, tri ditët, treshin si *iniciues* për receptuesin, por treshin e kemi edhe për *dramacitet* të situatës, pasi ngjarja vendoset në tri ditët e fundit të mbretërimit të Gentit. Ajo tensionon ligjëratat e personazheve, ngre emocionet, kërkon zgjidhje të shpejtë, meditime dramatike, krijon ndeshje mendimesh, konflikte, krizën e kohës së afërt, në të cilën do të vendoset fati i tij, etj. Madje, më me tension, kur dihet se merr fund jo vetëm një mbret, por gjithë mbretërit ilirë. Përveç kësaj, në këto tri ditë, dita e parë shkon me një monolog e dy-tri biseda të shkurtra pa diskutim, pa shqyrtim, pa ndeshje, etj. Dita e dytë s’ka asgjë dhe dita e tretë ku mblidhet gjithçka me interes estetik; biseda, kërkesa të ndryshme, supozime, mendime, ndeshje e tensione. Nga kjo del se, funksionalisht, në dramë kemi jetën e një dite prej atyre të triave, por deklarativisht jepen tri, jo për shkak të gjatësisë së ngjarjeve të shumta, ngjarjeve të rëndësishme që ndodhin, por vetëm se i nevojitet tre ditshi, ngritja e situatës në treshin simbolik. Dita e parë është më shumë si një hyrje në problem, sesa si pjesë e pavarur ideore e estetike.

b) Identiteti nacional e universal/internacional

M. Krasniqi shfrytëzon elemente të ndryshme, por të përhershme, nacionale e internacionale në ndërrimin e kësaj drame. Madje edhe i kombinon, gjë përmes së cilës sikur thotë se nga fatkeqësitë e tragjikja ka elemente për vende të ndryshme. Ato janë elemente përçuese të kulturave e vendeve të ndryshme, shoqërive e klasave të ndryshme. Në tërë dramën lëviz herë më hapur e herë më fshehtë një element i rëndësishëm dhe i përhershëm i historisë shqiptare, të cilin ia atribuon Gentit. Çka do të thotë se ai Gentin e shqyrton përmes pikave të përhershme që kanë përcjellë historinë e politikës shqiptare deri më sot. Kjo do të thotë se Genti i dramës është shumë funksional edhe për kohët e tjera shqiptare. Genti i M. Krasniqit, në paqe, është dhënë pas të mirave materiale, kënaqësive e dëfrimeve, duke mos u kujdesur për popullin i cili nuk do t’i përgjigjet në kriza, njëlloji si Ali Pashë Tepelena dhe qindra të tjerë më vonë në historinë shqiptare, prandaj edhe shërben si shenjë e përgjithshme nacionale:

GENTI

**Po diçka tjetër është, ndoshta pendimi
Për gjithë atë që nuk kam bërë për
mbretërinë**

**Dhe tash po më hakmerret me pabesi
ose**

PLATORI

**Fillove të zdërhallesh në ndeja të turpshme
Me verë të vjetër e me gra të përdala
Duke e shkuar motin pa e vrarë mendjen
Si e si të forcohej Mbretëria Iliriane,
Për të dëbuar armiqtë e shumë nga
kufijtë**

**Ku prisnin me dhëmbë përjashtë si ujq
të uritur**

Prandaj po aq sa jeta e Gentit, aq është edhe gjithë jeta e udhëheqësve shqiptarë. Kjo tregon për funksionin determinues të simbolit në gjithë shkrimin. Kjo në suaza nacionale. Por M. Krasniqi inkuadron edhe tema e probleme të tjera universale, në këtë rend edhe me kombinime nacionale e internacionale. Përgjithësimet tash edhe jashtë nacionit shqiptar. Tash Genti me fytyrë tjetër, si te Hamleti, vret vëllain për pushtet dhe i merr gruan. Me të, përveç përgjithësimit, M. Krasniqi edhe sikur jep idenë se dredhitë për pushtet janë shumë të hershme, egoja për pushtet vetëm sa i bën që njerëzit e kohëve të ndryshme pavetëdijshëm t’iu ngjajnë modeleve të mëparshme. Pra, teksti i tillë po aq sa flet me simbolika nacionale në një kontekst, ai flet edhe me simbolika internacionale në kontekste të tjera kur funksioni është më i madh. Përveç Hamletit, te idetë universale kemi edhe mëkatin trashëgues, edhe treshin mitik. Komunikimi me letërsi (Hamleti, mëkati trashëgues, treshi) dhe me religion (mëkati trashëgues, treshi). Pra, bartje e kombinime të ndryshme, për të treguar se ky tekst, në fakt, është thurje e teksteve të ndryshme, e problemeve të ndryshme nacionale e internacionale, gojore e të shkruara, të përkohshme e të përgjithshme, etj. M. Krasniqi i gërsheton shenjat, të cilat nuk kanë rëndësi për të se nga vijnë, por çfarë fuqie estetike e simbolike kanë. Kjo vetëm po zbulon kompleksitetin e shenjave të ndryshme, por që në këtë dramë i bashkon vetëm një parim: parimi estetik e artistik.

C) Identiteti material, kulturor e shpirtëror i kontekstit

M. Krasniqi me mjeshtri e ndërton kontekstin me të gjitha karakteristikat materiale, kulturore e shpirtërore në të cilin vendos ngjarjen. Shenjat materiale e

kulturore bëhen të rëndësishme pasi me mjeshtri i inkuadron në situata të ndryshme duke prodhuar shenja estetike, varësisht edhe prej natyrës së situatave ku qarkullojnë, p.sh.: tragjikja e vdekjes së fëmijëve të Gentit shoqërohet edhe me kulturën antike të hedhjes së tyre luanëve. Vdekje, mandej hedhje luanëve, pra, tragjikja në rritje, shfrytëzohet nga konteksti (hedhja luanëve) për të rritur tragjiken, edhe estetikën:

GENTI

Ku po ma shpie djalin, hej a ke pikë mëshire

Ai është djalë mbreti, merr vesh!

ROJA

Djalë breti, ha ha ha! Djalë mbreti!

Luanët do të kenë kënaqësi të madhe Meqë ushqimi i tyre është një djalë mbreti

Ha ha ha! Një djalë mbreti!

Thamë se ndërtimi i kontekstit është i ndërlidhur me situatën. Ky është njëri prej rasteve të këtij kombinimi. Më parë vazoja *pagane* tregonte simbolikisht, përmes imazheve, veprimet e Gentit ndaj popullatës, ndërsa tash paganizmi është i ndërlidhur me vdekjen. Thamë edhe se përdoren me funksione të ndryshme, veçse po shohim vazën me simbolikën për sjelljen, ndërsa hedhja luanëve me rritjen tragjike. Të dyja me estetikë, por përmes efekteve të ndryshme: e para përmes simbolikës, e dyta përmes tragjikes. Për të krijuar dinamikë më të madhe në dramë, Krasniqi kontekstin e krijon gjithmonë duke ndërruar format e paraqitjes, çka zbulon shkrimin e përpunuar. P.sh. historia e Rozafës del përmes krahasimit:

Si ta kisha barrën e moshës së Rozafës

Emrat e maleve, vendit dhe lumit përmes dhimbjes së ndarjes prej tyre:

ETLEVA

Lamtumirë o Skodra jonë e dashur

Se nuk e di a do të shihemi më për të gjallë,

Dhe ti o Barbanë e kaltër si sy vashe, lamtumirë

Dhe qaje fatin tonë me lotët e tu të kthjellët

Derisa sa të shterojë gjiri i Rozafës.

Ose edhe përmes pyetjeve retorike:

ETLEVA

...

Kujt po ia lë kaltrin e Liqenit Labeat

Kujt po ia lë bukurinë e Barbanës.

Vendimet e Senatit përmes efekteve tragjike të tij në urinë dhe etjen e personazheve:

GENTI

Roje, një pikë ujë na e sillni për djalin, Kini mëshirë për fëmijët e mi, roje, hej!

ETLEVA

Na e përvëluan shpirtin.

Na e përvëluan shpirtin.

ROJA

(Afrohet me heshtë në drejtim të tyre.

Është gjithë nerva.)

Urdhri është të mos u japim asgjë

Deri sa Senati vendos me urti për jetët tuaja!

Të kësaj natyre dhe me këtë tip shkrimi janë edhe pija-vera, edhe veshja, edhe armatimi (shpatat, shigjetat), edhe vendi i strehuar (kështjella) edhe emrat e fqinjëve (Romë dhe Maqedoni), edhe emrat e mbretërve (Perseu dhe Anici), edhe emërtimet e njerëzve, titujt e nderit, gradat ushtarake, etj. M. Krasniqi na del si ndërtues i mirë material e kulturor i kontekstit, por edhe si fanatik i madh i ruajtjes e përpunimit të tekstit, që për asnjë rast të vetëm nuk e përsërit të njëjtën teknikë të shfaqjes së problemeve e elementeve të ndryshme.

Zhurma

Teoria e informacionit njuh mesazhin, por edhe dërguesin edhe marrësin e tij. Sipas saj ekziston edhe kanali që përçon informacionin prej dërguesit te marrësi, prej koduesit të mesazhit te dekoruesi i tij. Duke i faktorizuar këto njësi të komunikimit tregohet se për t'u arritur një komunikim, mesazhi jo vetëm duhet të jetë i koduar mirë, por edhe gjatë bartjes në kanal prej dërguesit te marrësi të mos ketë sinjale, indice, vakume e elemente të tjera që turbullojnë mesazhin, duke e shtuar probabilitetin e paqartësinë e tij. Të gjitha këto elemente turbulluese (sinjale, indice, vakume, etj.), në kanal për teorinë e informacionit, janë zhurma. M. Krasniqi, në dramën Monedha e Gentit, e përdor me mjeshtri të jashtëzakonshme zhurmën e informacionit të tekstit, duke e rritur turbullirën e mesazhit, duke e rritur probabilitetin e tij dhe duke e zgjatur enigmën deri në fund të dramës. Zhurma, në fakt, atij i jep mundësi që t'i përgjithësojë idetë e problemet duke ofruar mundësi të ndryshme të receptimit të informacioneve të tyre, gjë nëpërmjet së cilës iu jep mundësi komunikimi atyre me njerëz të kohëve e vendeve të ndryshme. Pra, shton zhurmën në të mirë të shkrimit, të estetikës së tij e të funksionimit më të madh në kohë, vende e njerëz të ndry-

shëm. Për aq sa jemi te zhurma e informacionit duhet vetëm të shtojmë se ndryshon statusi në komunikimin e përditshëm dhe në shkrimin letrar. Dallimi qëndron në faktin se, në komunikimin e përditshëm të njerëzve, zhurma përqipet që të mënjanohet maksimalisht, pasi në këtë komunikim dëshirohet të largohen edhe keqkuptimet e shumëkuptimet, gjë që në të kundërtën shkrimi letrar e pamë se i shtonte vlerën. Pra çka është vlerë për njërin, nuk është për tjetrin dhe anasjelltas. Përveç kësaj, edhe shkrimi është mesazh komunikimi, prandaj veç po e plotësojmë duke thënë se çka është vlerë për një lloj komunikimi, për tjetrin nuk është. Komunikimi i përditshëm i njerëzve kërkon funksionin e mesazhit këtu dhe tash andaj edhe me rol të përkohshëm, social e mediokër, komunikimi me shkrim (veçanërisht me atë letrar) kërkon që mesazhi të ketë funksionim tejkohor e tejkohor, andaj edhe më i lartë, më madhor e më ideal. Ndërojnë kërkesat, ndërojnë edhe funksionet, ndëron tipi i komunikimit, ndëron edhe lloji i informacionit e vlera e tij. Me shtimin e zhurmës te kjo dramë, Milazim Krasniqi sikur thotë se letërsia gjithmonë ka jetuar me çrëndomtësimin duke përjashtuar norma, duke përjashtuar përditshmërinë, funksionin e përkohshëm e të angazhuar, ajo ikën tej realitetit te hapësirat e pamenduara e aventurat e pashkelura. Në kuadër të mesazhit/fjalës ajo ikën edhe tej informacionit të parë të saj, te njësitë e fshehta, prandaj edhe nuk është e rastësishme thënia se vetëm shkrimtarët e ngjallin gjuhën.

Teoria e informacionit për t'i larguar zhurmat e çfarëdoshme gjatë bartjes së informacionit te marrësi përdor përsëritjen e tij. Pra, përsëritet mesazhi/ideja për herë të dytë për t'i larguar deformimet e mundshme të tij/saj kur është marrë herën e parë, për t'i larguar shumëkuptimet, atje ku ai nuk është marrë i plotë. Përsëritjen e përdor edhe M. Krasniqi, por jo për të saktësuar por për të shtuar zhurmën, për të rritur probabilitetin e koncepteve të ndryshme, shumëkuptimësinë e ideve tash historike, të Gentit. Pra, historike, që në rend përgjithësimi nga zhurma vetëm po tregon se ato tash hapen dhe me mundësi funksionimi edhe në kohë të tjera. Kështu M. Krasniqi, përmes përsëritjes, rrit zhurmën, duke e bërë përsëritjen karakteristike të shkrimit/zhurmes së tij. Zhurma shtohet pasi M. Krasniqi i përsërit rastet,

idetë, kontekstet dhe konceptet e njëjta, por herën e dytë gjithmonë i sjell duke ndryshuar diçka, duke modifikuar, duke i plotësuar e përpunuar. Në këtë rend, gjithë pjesa e dytë e dramës është pjesë e zhurmës, pjesë ku idetë kalojnë në të përgjithshmen, pjesë që jep problemet e trashëguara, pjesë e figurave, e komunikimeve kohore e kulturore, vendore e njerëzore nga më të ndryshmet. Nëse pjesa e parë dhe e tretë paraqesin jetën e Gentit, pjesa e dytë as nuk e vazhdon atë, as nuk e plotëson, as nuk tregon parahistorinë e saj, as pashistorinë se çka do të ndodhë pas. Pra, përjashtohet nga funksioni fabular, të paktën nga fabula lineare. Në pjesën e dytë jepen aktorët e kohës dhe kulturës sonë. Aktorët iu ngajnë karaktereve të mirë e të këqij, duke shtuar zhurmën gjë me të cilën autori edhe i relativizon karakteret e dhëna më parë të Gentit e tjerëve, pasi hap mundësinë tash që aktorët t'ia kenë atribuuar ato karakteristika personazheve historike, Gentit e të tjerëve. Kështu, veçse po e shohim përsëritjen dhe zhurmën që po jep ajo tash. Përveç kësaj, përmes ngjashmërisë së aktorëve me njerëzit historike, jo vetëm që hap mundësinë që njerëz të kohëve të ndryshme mund të jenë të njëjtë, por edhe se në kohët moderne fatkeqësia dhe rreziku, kriza e përmbytjet njerëzore janë më të mëdha. Kjo pasi, më parë, dallohej hapur armiku nga miku, trimi nga i ligu, besniku nga dyfytërsi, etj. duke qenë secili në pozicionet e veta. Tash është e kundërta, tash ata janë brenda të njëjtës shoqëri, të mbuluar me petka të ndryshme. Pra zhurma është me funksione të ndryshme, njëherë të ndërlikohjes së historisë me të tashmen, e tash duke shenjuar rrezikun e madh të së tashmes. Po rritet probabiliteti, po zgjerohen e abstragohen personazhet, pas tyre edhe konceptet, kohët, vendet, tragjikja, komikja e situatat e ndryshme. Pjesa e dytë, më së shumti, shton zhurmë për shkak të vendit në mes të dramës ku ajo ndërhyr, kur shumë gjëra janë të papërfunduara, kur ka shumë dilema për gjitha rendet formale e ideore, dilema për fabulën, situatat, personazhet dhe fatin e tyre, etj. Krahas përgjithësimave të lartshënuara, aktorët në këtë pjesë efektivisht dhanë edhe shumë mendime për dramën: fajësinë a pafajësinë e Gentit, idetë e përgjithshme në dramë, relacionin mes tekstit dhe autorit, komunikimin me temën hamletiane, etj. Gjithë kjo tregon se

me to autori shton papërcaktueshmërinë e pasaktësinë (zhurmën) e personazhit, duke inkuadruar brenda tyre edhe një dozë të receptuesit Komedia moderne e inkuadronte receptuesin me të qeshura. M. Krasniqi te ky shkrim, edhe më tej, e jep receptuesin jo vetëm si zë, por jep edhe botën e receptuesit, idetë, mendimet, dilemat, emocionet, etj. Gjithë kjo, tash, përmes aktorëve, pra, nga njësitë e brendshme të dramës e jo nga të jashtmet, si e qeshura në komedi. Pra, nëse komedisë për ta realizuar idenë e receptuesit i duhen *infuzione* të jashtme, M. Krasniqi këtë e arrin përmes shfrytëzimit të elementeve të brendshme. Njëherë inkuadrimi i receptuesit me ide, mendime e emocione si më komplet, e herën tjetër inkuadrimi nga brenda, herën e parë mjeshtëri të rendit ideor, herën e dytë të atij formal. Me këtë Krasniqi arrin ta mjegullojë edhe fabulën duke lënë hapësirë të padefinuar se a është dramë historike a bashkëkohore, e mëparshme a e tashme, a atje (në kështjellë) a këtu (në skenë), a trajtohen problemet historike-Gentit a të artit, a të jetës a të skenës, etj. madje a duhet të pranohet njëri prej këtyre anëve apo të



dyja. Në fakt, me zhurmën M. Krasniqi veç e përgjithëson shkrimin duke thënë se ajo është dramë edhe historike edhe bashkëkohore, edhe me njerëz historikë edhe me ata aktualë, edhe me probleme historike edhe të artit, edhe probleme të atëhershme edhe të tashme, etj. Ai, me të, arrin ta kapë jetën në përgjithësi me të gjitha ngarkesat e kompleksitetet e saj. Sipas tij, njeriut nuk i ndahen problemet, ato në jetë janë bashkë probleme historike e aktuale, shkencore e artistike, të vetes e të botës, vendore e kohore, etj. Përveç kësaj në disa vende trajtohet edhe problemi i shkatërrimit të mbretërisë. Kjo është ideja e gjithë dramës, në këtë rend duket të jetë unike. Por ajo ndërron pse-në e shkatërrimit, prej shkatërrimit nga armiku, pra shkatërrimi nga fuqia e jashtme që gjendet në pjesën e parë, në shkatërrimin për shkak të problemeve personale e familjare në pjesën e tretë. Pra, ideja e shkatërrimit

po përsëritet, por zhurmshëm, duke ndërruar e përgjithësuar. Mosprecizimi sikur thotë se shkatërrimet mund të jenë herë për shkaqe të jashtme, e herë për të brendshme. Në anën tjetër, në fillim jepet edhe fatkeqësia prej mëkatit trashëgues:

Tash ne fati na ka ngarkuar barrë të rëndë Dhe dëmin e disfatave të kaluara romake Edhe hakmarrjen e tyre të mbetur përgjysmë

Duhet ta paguajmë ne me jetët tona

Pra mëkati trashëgues, sikurse në tragjeditë antike, p.sh. fundi i djemve të Edipit (Eteoklit e Politniklit) rreth Tebës, apo edhe i vajzës (Antigonës) pas varrosjes së vëllait, vjen për shkak të mëkatit të trashëguar nga prindërit, konkretisht mëkatit të martesës së djalit me nënën e vet. Në këtë kuadër po identifikohet me tragjeditë antike njëloj, pasi edhe si kohë nuk janë larg (shek V-II p.e.r.). Pra kemi identifikim kohor e kulturor, formal/kohor e esencial/zhanror. Por krahas këtij opsioni, në fund, Platori del edhe me një ide se fatkeqësia e Gentit vjen nga mëkati i vet, pasi ai kishte vrarë vëllain e vet për t'i marrë fronin dhe gruan. Pra, tash, relativizon versionin antik me versionin hamletian - vrasja e vëllait për fron dhe grua, madje jo relativizim, por funksionim i të dyjave së bashku. Pra, po përsëritet ideja se shkatërrimi vjen prej mëkatit, por herën e parë vjen prej mëkatit të trashëguar nga paraardhësit, e më vonë prej mëkatit të vet drejtuesit të mbretërisë. Gjithë kjo tregon se këtu zhurma përdoret me funksion estetik. Ajo përgjithëson të gjithë rendin e ideve të dramës, sikurse edhe vë në lojë edhe rendin formal të saj. Ajo është e sistemuar në vende e kohë të ndryshme në dramë, duke shfaqur e fshehur rrjedhat e situatave, duke zhvilluar relacion herë varësie e herë autonomie me kohë të tjera, çka e bën edhe në mënyrë të pavetëdijshme prodhuese të ritmeve të ndryshme: një vend e shumë vende, një kohë e shumë kohë, një mëkat e shumë mëkate, një problem e shumë probleme, etj. Ajo më shumë vjen për të iniciuar probleme të mundshme jashtë atyre që duken, për të parë variantet, për të hapur botën, e jo për të mbyllur. Ajo i thërret njësoj lexuesit, duke thënë se bota është e gjerë aq sa ka mendime e emocione të njerëzve, është më e madhe se që shihet. Dhimbshëm, por edhe bindshëm, thotë se është edhe më e madhe se nacioni i Gentit. ■

Prozë

Fotografitë e kujtimeve

Në oborrin e një shtëpie të djegur, së cilës i kishin mbetur vertikalisht tri oxhaqe të larta, të nxira nga flakët, rrinte një plak rreth shtatëdhjetë vjeç i kërrusur e thatimë, i pa rruar e me rroba të zhubravitura si mos më keq. Kur na pa ne që po hynim në oborr, duket se u tremb në fillim, po mendoja sikur e mori veten dhe filloi të na afrohet, duke u mbajtur për një kërrute. Ishte fillikat në atë oborr. Na tregoi se tërë luftën e kishte kaluar duke u endur nëpër shtëpitë-gërmadha të fshatit të tij, krejt i vetëm, ngase familja e tij dhe mbarë banorët ishin dëbuar nga fshati me dhunë dhe ai nuk e dinte se nga i kishin çuar. Dikur ikën edhe qentë nga fshati dhe unë mbeta krejt vetëm. Shumë çudi me vjen se si ikën edhe qentë nga fshati. Ishte shumë vështirë ta kaloja natën pa dëgjuar asnjë lehje qeni. Jam rritur e jam plakur në këtë fshat dhe ne gjithmonë kemi mbajtur qen që ruanin shtëpitë tona. Po të mos ishin zhurmat e avionëve dhe eksplozimet e raketave, nuk e di se a do të shpëtoja me mend a jo. Familjen ma dëbuan nga shtëpia ushtarët me maska e me automatikë në duar. Shanin e bërtitnin si të çmendur. Po unë nuk luajta nga vendi. U thashë, në gjuhën e tyre, po deshët vritmëni, po deshët mbytmëni, unë nuk e lëshoj shtëpinë i gjallë. Dhe, ata nuk më thanë kurrëgjë tjetër, po m'i dhanë flakën shtëpisë, u zgërdhinë e morën shpatit teposhtë në lagjet e tjera, të cilat i bënë shkumb e hi. Shikoja flakët se si e përthekonin shtëpinë si bisha të egra dhe as një kovë

ujë nuk e nxora nga pusi. Thashë me vete si është shkruar, ashtu do të bëhet dhe s'ka tjetër. Zoti na jep e na merr. Vetëm robt' e shtëpisë të më shpëtonin, se sa për shtëpi do t'ia bëjmë hallin. Po thonë se janë në Shqipëri e se janë nisur për këndeje. Po nuk e di ku do të flemë o mik, se jemi njëzetë anëtarë të familjes, me djem e me nipa. Po shyqyr që u çliruam, se flemë edhe në oborr. Mjafton se nuk na nguc kush.

Plaku foli e foli, pa na shikuar asnjërin dhe më shumë bënte një monolog me veten, sesa një bisedë me ne.


Mezi i dilte zëri.

Kur pushoi një grimë, Hasani me tha ta pyesja se a mos dinte në kishin vendosur mina serbët dhe në mos kishin hedhur kufoma në pusët e fshatit. Mu desh ta kapja për mënge plakun që t'i ndihmoja të kuptonte se çfarë po e pyesnim. Më shikoi hutueshëm dhe tërhoqi krahum si me hidhërim.

-E kemi pasur në fshat një bashkëpunëtor të serbëve. E kemi ditur që është qen, po jo në atë derexhe. Ai ka bërë me gisht se kush duhej të pushkatohej, cila shtëpi të digjej, cila shtëpi të plaçketej.

- Ku është ai njeri?- pyeti Hasani dhe unë ia përktheva.

- Kush e di ku është. Me siguri diku në Serbi. Farë e keqe ishte, o mixhë. Mina nuk kanë vendosur, sepse këtu nuk mbetën as qentë, e lërë më njerëzit. Ata kanë menduar se do të mbeten këtu gjatë, prandaj nuk kanë vendosur mina. Plakut i lamë dy batanije, dy konserva dhe një bukë e një liter qumësht, edhe



pse ai mezi i pranoi ato ndihma. Jam mësuar të bëj hall, mos u mërzitni për mua. Ndoshta dikujt tjetër i duhen më shumë- ngulmonte plaku ndërsa ne largoheshim. Mbjat fletoren në dorë dhe mendohej: çfarë paralajmërimi paskësh qenë ky dorëshkrim?! Ai personazhi, Beria, ishte një njeri real, i cili u kishte prirë krimeve ndaj bashkëkombësve të vet në këtë fshat, sigurisht duke ua prishur edhe ëndrrat. Por, jam i sigurt se, edhe po të ishte botuar ky dorëshkrim para kësaj katastrofe, askush nuk do t'ia vinte veshin këtij paralajmërimi. ■

(Shkëputur nga romani Fotografitë e kujtimeve të Milazim Krasniqit)



Qasje

Një studim që afirmon konceptin e pajtimit të qytetërimeve

Fitim VELIU

Libri studimor i Milazim Krasniqit, Dhuna dhe qytetërimi perëndimor – Islami si fillim i historisë, botuar nga shtëpia botuese Logos-A, në vitin 2006, shtron brenda vetes ide të reja rreth konceptit të pajtimit të qytetërimeve. Këtë pajtim autori e shtron mbi konceptin e drejtë të Islamit si projekt universal për të gjithë njerëzit. Për ta argumentuar këtë, M. Krasniqi analizon/heton historinë dhe defektet e saj nëpër kohë, gjithnjë duke synuar të pasqyrojë pasigurinë e kohës së sotme, ku vlerat morale janë deformuar duke shkaktuar rrezikun e skajshëm të zhbërjes së gjithë njerëzimit. Milazim Krasniqi e hap librin me një kapitull që shtron një dilemë retorike: A ka gjasa rifillimi paqësor i historisë? Sipas studiuesit M. Krasniqi: Historia duhet të shihet mbi bazën e argumenteve racionale, e jo duke identifikuar Islamit me nacionalizmin, ideologjinë dhe terrorizmin, sepse Islami nuk i njeh këto kategori dhe as që është identifikuar ndonjë herë me to. Mbi këtë pikë esenciale shtrohet çështja se edhe ndryshimet kulturore të shteteve duhet të ndodhin nga brenda, pra nga populli, ndërsa ideja e përhapjes së demokracisë me anën e agresionit, në emër të emancipimit dhe lirisë së njerëzve, vetëm sa do ta shtonte pezmin ndërmjet qytetërimeve. Evropa, në këta shekujt e fundit, njeh një zhvillim të paparë ekonomik e industrial, por sa mjafton kjo për një qytetërim, ku vlerat etike janë në zgrip të thellë?! Vërtet në qytetërimin e botës islame mungon industrializimi, por nga aspekti i moralshmërisë bota islame qëndron më lart se perëndimi. Duke u nisur nga kjo, studiuesi M. Krasniqi ofron një platformë shpëtimi për të dy qytetërimet duke theksuar se: Po të bashkohej qytetërimi perëndimor me Islamit, duke e përqaftuar Islamit si botëkuptim për botën dhe duke u transformuar brenda vlerave

universale të tij, atëherë ky qytetërim do të udhëhiqte njerëzimin në drejtim të vlerave universale dhe drejt një unifikimi mbi vlera të përbashkëta.

Studiuesi M. Krasniqi analizon komunikimin kulturor të shtratit perëndimor, i cili është ndërtuar mbi vlerat e artit të antikitetit grek, duke filluar me esencën e artit grek, poemat 'Iliada' dhe 'Odisea', të cilat brenda strukturës së tyre artistike kanë luftën e gjatë të akteve kundër Trojës, për shkak të shkak të



rrëmbimit të Helenës së bukur, gruas së Menelaut. Këto dy poema, sidomos 'Iliada', skicojnë krime ndërmjet njerëzve, rrëmbime, shkatërrime, tradhti dhe këto poema ruajnë ende ndikimin e tyre mbi subkulturën e shtratit perëndimor. Kurse në poemën 'Odiseja', kthimi i Odisesë në atdhe zgjat me vite të tëra për shkak se ai e kishte flijuar vajzën e tij për erërat. Vrasja është krim kundër vullnetit hyjnor. Në këto dy vepra hasim deformimin e botëkuptimit mbi Zotin. Në to shfaqen shumë zota, por habia më e madhe është, se si në këto vepra, Zoti është njeri i cili ha ushqim, bën marrëdhënie me shumë dashnore, dhe ky botëkuptim mbi Zotin është bartur nëpër kohë deri në ditët

tona. Ajo çka skicon studiuesi M. Krasniqi në këtë studim është fakti se ai ndjek një linjë komunikimi të artit grek nëpër të gjitha periudhat kohore, duke nxjerrë në skenë se edhe në veprat e tjera, siç janë ato të Eskilit, hasim krimin familjar ndërmjet anëtarëve të saj. Përrjashtimi i konceptit të monoteizmit në antikitet prodhoi dhunë dhe krim të paparë, sepse ky ishte një ndëshkim për politeizmin ekstrem të tyre. Edhe veprat e Dostojevskit, skicon studiuesi M. Krasniqi, kanë në brendinë e tyre krimin si vlerë. Në veprën e Dostojevskit 'Krim dhe ndëshkim' personazhi kryesor vret e plakën e pasur e të shtyrë në moshë, duke u bazuar mbi idenë se marrja e pasurisë së saj dhe shpërndarja për të varfrit përbën humanizmin njerëzor.

Në këtë kapitull, si esencë e gjithë librit, studiuesi M. Krasniqi analizon dhe kundër argumenton pohimet e shoqatës gjermane të psikanalizës, Psikosomatikes dhe Psikologjisë (GDTP), të cilët në vitin 2001 kishin organizuar një konferencë me temën Dhuna dhe qytetërimi. Konkluzionet e këtyre analistëve ishin shumë shqetësuese. Sipas kësaj konference del se dhuna nuk është dukuri e jashtme, por pjesë e brendshme e qytetërimin tonë perëndimor e orientuar drejt progresit. Kjo tezë buron nga koncepti se njeriu lind me faj dhe ai është i dhunshëm, sepse udhëhiqet nga pjesa e pavetëdijshme e qenies së tij. Këtij mendimi i kanë shërbyer studimet e psikanalizës freudiane, darviniste, staliniste etj. Studiuesi i përgjigjet me kundërgument se e keqja është nga jashtë, nga veprimet djallëzore dhe veprimet e individit, sepse Zoti njeriun e ka lënë të lirë në veprimet e tij. Veprimi i të keqes pason me ndëshkim në këtë botë dhe në botën tjetër, kurse e mira pason me shpërblim. Një konkluzion tjetër nga kjo konferencë del se: Dhuna është pjesë e kulturës perëndimore. Sipas studiuesit M. Krasniqi: Dhuna si mjet pushtimi, e kombinuar me dhunën si art, u bë jo-selektive deri në atë masë sa provuan ta viktimizonin edhe të dërguarin e Zotit, Jezusin, (Isain a. s). ■